ZBULUESIT

Viti 1 - Tremujori 1

Zbulimi i thesareve të përjetshme **në librin e Zanafillës, përfshirë krijimin përmes lindjes së Isakut**



Programi Bazë

Zbuluesit është një shërbesë e Discovery Land Global.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Një mesazh nga drejtoresha ekzekutive

Të dashur drejtues,

Jemi të entuziazmuar që këtë tremujor kemi mundësinë të shohim Perëndinë i cili zbulon planin e Tij të mrekullueshëm e shpengues në librin e Zanafillës. Gjatë gjithë aventurës sonë në këtë libër të mrekullueshëm, plot me të vërteta të jashtëzakonshme, ne ju inkurajojmë të përgatiteni çdo javë dhe të drejtoni përmes lentes së një botëkuptimi biblik:

Kupto si duhet: Një pasazh nga Shkrimi për të studiuar.
Mendo si duhet: Një varg nga Shkrimi për të medituar gjatë javës.
Vepro si duhet: Sfida për ta vënë në zbatim Fjalën e Perëndisë.

Ndihu si duhet: Rezultatit i zbatimit të mësimit dhe të pasurit e një botëkuptimi biblik. Kur ne dishepullojmë përmes 4 pikave 'si duhet', ne i trajnojmë nxënësit që të përpunojnë si duhet me të vërtetën periudhat e mira dhe të vështira të jetës, gjë që i ndihmon të veprojnë dhe të ndihen si duhet përpara Perëndisë së tyre.

Do të doja të inkurajoja ata që janë të rinj në mësimdhënie që të lidhen me mësues me eksperiencë; të kërkojnë ndihmën dhe udhëheqjen e tyre. Nëse ke eksperiencë, kupto që je bekim i madh për skuadrën; merr kohë për të inkurajuar dhe trajnuar anëtarët e skuadrës tënde. Njohuria jote, aftësitë dhe dhuntitë e tua, shumëfishohen kur investon te të tjerët.

Ne sinqerisht presim me padurim të shohim se si Perëndia do të transformojë jetët e fëmijëve teksa i inkurajojmë të zbulojnë të vërtetën në Fjalën e Perëndisë dhe ta zbatojnë në jetët e tyre, në periudhat që do të vijnë.

Kris Smoll
Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Tabela e Përmbajtjes
Viti 1 – Tremujori 1

Të kuptojmë kurikulën 4
Përmbledhja e tremujorit 9
Mësimi 1: Perëndia krijon botën. 12
Mësimi 2: Perëndia krijoi Adamin dhe Evën. 21
Mësimi 3: Mëkati hyn në botë 30
Mësimi 4: Kaini mëkatoi kundër Abelit. 40
Mësimi 5: Noeu ndërton një arkë. 49
Mësimi 6: Perëndia përmbyt botën 57
Mësimi 7: Ndërtohet kulla e Babelit. 66
Mësimi 8: Abrami dhe Loti ndajnë tokën. 75
Mësimi 9: Perëndia bën një besëlidhje me Abramin. 84
Mësimi 10: Abrahami dhe Agari lindin Ismaelin. 93
Mësimi 11: Abrahami dhe Sara lindin Isakun. 102
Mësimi 12: Dita e përsëritjes 109
Shtojca
Mësim tematik: Njëri-tjetrin 112
Lojërat e fundit të përsëritjes 120
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin 123
Falënderimet dhe lejet 125

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

TË KUPTOJMË KURIKULËN

Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbulesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

Kupto si duhet:	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
Mendo si duhet:	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
Vepro si duhet:	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
Ndihu si duhet:	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

Mësuesi kryesor: Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Drejtuesi i kohës së zbulimit: Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

Bariu: Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

Këshilla për drejtuesin

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

Pasqyra bazë e programit

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektiv të Hartës së gjurmuesit.

Program i sugjeruar

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë
-: 15 Loja e përsëritjes
: 00 Adhurimi
: 15 Koha e zbulimit
: 30 Mësimi nga Bibla
: 60 Loja e fundit e përsëritjes
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

Loja e përsëritjes

Këshilla për drejtuesin

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiqu t'i bashkosh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Adhurimi

Këshilla për drejtuesin
Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

Këshilla për drejtuesin
Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimit:

Kreu i seksionit: Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).
Lexo: Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.
Përmbledhje: Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.
Parafrazim: Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën "Vepro si duhet" te mësimi.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që "t'i jepni jetë Biblës", duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t'i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t'i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin "Gjejeni" në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

Loja e fundit e përsëritjes

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

Këshilla për drejtuesin

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t'i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posteri *Ndihu si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimit dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

Kursi i këmbimit:

3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
2 Pjesëmarrja aktive në klasë
1 Shfaqja e frytit të Frymës
1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

Thesaret i gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhja e Tremujorit

Viti 1 – Tremujori 1

Mirë se vini! Këtë tremujor, udhëtimi ynë entuziazmues gjatë gjithë Biblës, nis me librin e Zanafillës. Ndërsa studiojmë këtë periudhë të jashtëzakonshme historike, do të shohim se si zbulohet plani i Perëndisë. Nga krijimi i botës e deri te lindja e birit të premtuar të Abrahamit, Isakut, ky studim shqyrton natyrën tonë mëkatare, që mund të pastrohet vetëm nga Shpëtimtari që Perëndia do të dërgonte. Lutja jonë është që përmes këtij studimi, nxënësit tuaj do të besojnë në Krishtin dhe do të rriten në hirin dhe njohjen e Tij.

Mësimi i parë na çon pikërisht te fillimi i javës së krijimit. Perëndia na ka treguar rendin në të cilin ka krijuar gjithçka. Në ditën e parë, Ai krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira; në ditën e dytë, qiellin; ditën e tretë, tokën, detet dhe bimësinë; ditën e katërt, diellin, hënën dhe yjet; ditën e pestë, krijesat e detit dhe zogjtë; ditën e gjashtë, kafshët e tokës, dhe në mënyrë unike njeriun sipas shëmbëlltyrës së Vet; dhe në fund, në ditën e shtatë, Ai pushoi. Rezultatet e krijimit të Perëndisë janë një dëshmi e fuqishme që Ai ekziston dhe se Ai na do; dhe nisur prej kësaj, ne duhet të besojmë gjithmonë se Perëndia e krijoi botën.

Pastaj do të shohim më nga afër ditën e gjashtë të krijimit për të mësuar se si Perëndia e formoi njeriun e parë. Perëndia na thotë se Ai mori pluhurin nga toka, i dha formën e një njeriu dhe hukati frymë jete tek Adami, kështu ai u bë qenia e parë njerëzore. Ai i dha Adamit një shtëpi të jashtëzakonshme në Kopshtin e Edenit, një punë për të bërë dhe ushqim për të ngrënë. Pastaj Perëndia bëri një grua si ndihmësen e tij – direkt nga brinja e Adamit. Perëndia e bashkoi Adamin dhe Evën në një tjetër nga krijimet e Tij të veçanta – martesë – dhe u tha të kishin fëmijë, që toka të mbushej me njerëz. Nga ky plan i saktë dhe i qëllimshëm, kuptojmë se Perëndia na krijoi.

Pasi Perëndia krijoi Adamin dhe e vendosi në kopshtin e Edenit për të punuar dhe për t'u kujdesur për të, Ai i dha një urdhërim. Perëndia i tha Adamit të mos hante nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Perëndia i tha që, nëse Adami do të hante nga ajo pemë, do të vdiste. Megjithatë, në vend që ta dëgjonte Perëndinë dhe t'i bindej, Adami dëgjoi gruan e tij, Evën, e cila ishte mashtruar nga gjarpri i quajtur Satan. Kështu, edhe Adami edhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, dhe kryen mëkatin e parë, që solli vdekje dhe vuajtje në botë. Por mëkati i njeriut nuk përfundoi aty. Siç na tregon edhe Bibla, gjithsecili prej nesh, lindur nga Adami dhe Eva, kemi treguar mosbindje të marrë ndaj Perëndisë. Për këtë arsye, tani mund të kuptojmë se kemi mëkatuar!

Pasi Adami dhe Eva mëkatuan dhe u dëbuan nga kopshti i Edenit, Perëndia u dha një familje. Fatkeqësisht, të gjithë fëmijët lindën me natyrën mëkatare të prindërve të tyre.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Djali i tyre, Kaini, u bë punues toke dhe djali tjetër, Abeli, u bë bari. Mënyra si e jetonin jetën shfaqte dallime të mëdha. Oferta e çmuar e Abelit me të parëlindurit e kopesë dhe yndyrën e tyre, tregonte se ai jetonte siç i pëlqente Perëndisë, përmes besimit. Oferta jo e çmuar e Kainit ishin frutat e tokës dhe tregonte mënyrën si ai jetonte, pra, pa besim. Për shkak se Abeli jetonte siç i pëlqente Perëndisë, me besim, ai u deklarua i drejtë dhe u bë pjesë e heronjve të besimit. Për shkak se Kaini jetoi pa besim, u ndëshkua për mëkatin e tij dhe duhej të endej nëpër tokë, në vend që të ishte punues i saj. Për shkak të kësaj, ne mund ta dimë me siguri se Perëndia e urren mëkatin.

Familja e Adamit dhe Evës vazhdoi të rritej, dhe kështu patën një pasardhës të quajtur Noe. Në kohën e Noeut, Perëndia pa botën dhe lëngoi për shkak të ligësisë së madhe që pa. Fatmirësisht, Ai pa gjithashtu që Noeu besonte në Të, prandaj Ai ia shfaqi planin e Tij atij – një plan për të shkatërruar botën përmes një përmbytjeje. Perëndia i tha Noeut të ndërtonte një arkë që do të shpëtonte familjen e tij dhe dy nga çdo krijesë e gjallë. Noeu u bind dhe ndërtoi arkën – që ishte e vetmja mënyrë shpëtimi për të dhe familjen e tij. Arka është një shembull i mënyrës se si Jezusi mund të na shpëtojë nga ndëshkimi për mëkatin tonë.

Rreth 100 vite pasi Perëndia ia shfaqi planin e Tij Noeut, Ai dërgoi përmbytjen. Çifte nga të gjitha llojet e zogjve dhe kafshëve të tokës, si dhe Noeu e familja e tij, hipën në arkë. Pastaj Perëndia mbylli derën dhe ata ishin të sigurt dhe të mbrojtur nga përmbytja. Rreth një vit më vonë, Noeu, familja e tij dhe zogjtë e kafshët që kishin qenë në arkë, zbritën në tokë të thatë. Perëndia i bëri një premtim Noeut: Ai nuk do ta shkatërronte kurrë më tokën me përmbytje. Shenja e premtimit të Perëndisë ishte ylberi. Perëndia ishte besnik. Ai i shpëtoi ata që ishin në arkë nga përmbytja. Ashtu si ata, ne që kemi besuar në Jezusin jemi të sigurt dhe të shpëtuar nga shkatërrimi i mëkatit. Ngjarja e Noeut dhe e përmbytjes na mëson secilit prej nesh premtimin se Jezusi mund të na shpëtojë nga mëkati ynë.

Noeu dhe familja e tij iu bindën Perëndisë duke bërë fëmijë që të mbushnin tokën. Megjithatë, shumë vite më vonë, pasardhësit e tyre vendosën ta jetonin jetën siç u pëlqente atyre dhe jo siç i pëlqente Perëndisë. Ata ndërtuan një qytet, sepse donin të bënin emër dhe nuk donin të shpërndaheshin nëpër botë. Kështu ndërtuan një kullë të lartë në qytet, sepse donin të arrinin qiejt. Zgjidhja e Perëndisë për këtë mosbindje ishte ngatërrimi i gjuhëve të tyre dhe shpërndarja nëpër të gjithë botën. Nga ngjarja e kullës së Babelit mësojmë se duhet t'i bëjmë gjërat gjithmonë siç i pëlqen Perëndisë dhe jo siç na pëlqen neve.

Plani i Perëndisë vazhdoi me një njeri të quajtur Abram. Perëndia i tha Abramit të linte vendin e tij, popullin e tij dhe shtëpinë e babait të tij, e të shkonte në një vend që Perëndia do t'i tregonte. Perëndia i premtoi gjithashtu Abramit se do të ishte një bekim dhe se do të merrte bekime. Meqenëse Abrami kishte besim te Perëndia, ai iu bind

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dhe shkoi. Mori edhe gruan e tij, Sarain e nipin e tij, Lotin. Kur arritën në këtë vend të ri, të quajtur Kanaan, ndodhën telashe. Si Abrami, ashtu edhe Loti kishin tufa dhe kope të mëdha, të cilat shkaktuan konflikt midis barinjve të tyre. Toka nuk do t'i mbante të dy nëse do të jetonin së bashku, kështu që Abrami i dha Lotit të zgjidhte se cilën tokë të merrte. Loti zgjodhi me egoizëm atë që dukej si toka më e mirë dhe Abrami mori pa egoizëm atë që kishte mbetur. Altruizmi i Abramit tregoi dashurinë e tij për Perëndinë dhe për Lotin. Perëndia e bekoi Abramin duke i dhënë të gjithë vendin atij dhe familjes së tij përgjithmonë. Kjo tokë një ditë do të quhej Izrael. Shembulli i Abramit dhe besnikëria e Perëndisë na inkurajojnë ta duam Perëndinë dhe të tjerët.

Pasi Abrami arriti në Kanaan, Perëndia i foli përmes një vizioni dhe i shpjegoi më tepër rreth premtimit të Tij të veçantë, të quajtur besëlidhje. Edhe pse Abrami ishte i vjetër dhe nuk kishte fëmijë, Perëndia i premtoi se një bir do të vinte nga vetë trupi i tij. Ai i tha gjithashtu Abramit se do të kishte po aq pasardhës sa ka yje në qiell. Këtyre pasardhësve do t'u jepej toka e Kanaanit për të jetuar në të. Por, para kësaj, ata do të skllavëroheshin në një vend të huaj dhe do të keqtrajtoheshin për katërqind vite. Pas kësaj, ata do të largoheshin nga ai vend me të mira të shumta. Ashtu si Perëndia ia premtoi të gjitha këto Abramit, Ai u premton jetë të përjetshme edhe atyre që besojnë në Birin e Tij, Jezusin, për të na shpëtuar nga mëkati. Abrami besoi në atë që Perëndia i kishte premtuar. Besofshim edhe ne gjithmonë në premtimet e Perëndisë!

Abrami ishte 85 vjeç dhe ende nuk kishte fëmijë. Në vend që të priste me durim Perëndinë që të mbante premtimin e Tij, Sarai e bindi Abramin të kishte një djalë me shërbëtoren e saj egjiptase, Agarin. Agari lindi djalin e Abramit; ai u quajt Ismael. Sapo Agari mbeti shtatzënë, lindi konflikti mes saj dhe Sarait. Ky konflikt ishte pasojë e mungesës së durimit të Abramit dhe Sarait për t'u mbështetur te Perëndia. Perëndia i tha Abramit se Ismaeli nuk ishte biri i premtuar. Për shkak të kësaj, ne mësojmë të mbështetemi me durim te Perëndia për gjithçka.

Perëndia ua ndryshoi emrat në Abraham dhe Sara, dhe kur Abrahami ishte 100 vjeç dhe Sara 90, ajo lindi një djalë të quajtur Isak. Konflikti mes Agarit dhe Sarës u shtua, dhe Abrahamit iu desh të largonte Agarin dhe birin e tij të dashur Ismael – një tjetër pasojë tragjike e të mos priturit me durim në Perëndinë. Pavarësisht padurimit të Abrahamit dhe Sarës, Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe vazhdoi planin për të sjellë Jezusin që të na shpëtonte nga mëkati ynë. Saga e larmishme e familjes së Abrahamit fillon me ne, duke u mbështetur me durim te Perëndia për gjithçka.

Ndërsa i afrohemi fundit të tremujorit, marrim një ditë për të kujtuar dhe festuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Tremujorin e ardhshëm do të rikthehemi te Dhiata e Re për të mësuar se si u bë realitet premtimi i Perëndisë për një Shpëtimtar. Perëndia të bekoftë për shërbesën e përulur ndaj Tij!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 1
Zanafilla 1:1 - 2:3

Kupto si duhet:	Perëndia krijon botën.
Mendo si duhet:	"Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe token." Zanafilla 1:1
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se Perëndia krijoi botën.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i gëzuar për shkak se Perëndia krijoi botën.

PËRGATITU!

Krijimi i Perëndisë është një dëshmi e fuqishme, që tregon se Ai ekziston dhe se Ai na do. Puna e duarve të Perëndisë na kujton padyshim se Ai e krijoi botën. Kjo e vërtetë thelbësore na inkurajon t'i ndërtojmë me besim jetët tona mbi Të dhe mbi Fjalën e Tij. Këtë javë, le të kalojmë kohë duke adhuruar Perëndinë për madhështinë e Tij! Pastaj, kur t'i kemi zemrat me këtë qëndrim adhurimi, le të përgatitemi për të shërbyer dhe për t'ua dhënë këtë të vërtetë nxënësve tanë.

Lutu: Lutu për secilin nxënës në klasën tënde. Lutu që Perëndia t'u lejojë të kërkojnë e kuptojnë madhështinë e Perëndisë sonë këtë javë, ndërsa mësojnë se Perëndia krijoi botën. Lutu gjithashtu që do ta kujtojnë këtë mësim ndërsa rriten, që të mund të kenë biseda me bazë biblike për sa i përket krijimit.

Lexo: Zanafilla 1:1 – 2:3

Kupto si duhet: Perëndia krijon botën
Mësimi i parë na çon pikërisht te fillimi i javës së krijimit. Perëndia na ka treguar rendin në të cilin ka krijuar gjithçka. Në ditën e parë, Ai krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira; në ditën e dytë, qiellin; ditën e tretë, tokën, detet dhe bimësinë; ditën e katërt, diellin, hënën dhe yjet; ditën e pestë, krijesat e detit dhe zogjtë; ditën e gjashtë, kafshët e tokës, dhe në mënyrë unike njeriun sipas shëmbëlltyrës së Vet; dhe në fund, në ditën e shtatë, Ai pushoi. Rezultatet e krijimit të Perëndisë janë një dëshmi e fuqishme që Ai ekziston dhe se Ai na do; dhe nisur prej kësaj, ne duhet të besojmë gjithmonë se Perëndia e krijoi botën.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Nxënësit pyesin shpesh: "Kush e krijoi Perëndinë dhe si e di ti që Ai është i vërtetë?" Ky mësim është një përgjigje shumë e bukur e këtyre pyetjeve. Vetëm një Perëndi i fuqishëm e i gjithëdijshëm mund të krijojë një univers që punon në mënyrë të përsosur!
- Ju lutem, kujtoni se ne u mësojmë nxënësve ditët e krijimit nga një pikëpamje bazike, fjalë për fjalë. Çështja kryesore që duam t'u japim atyre me vete është që Perëndia krijoi botën.
- Dy faqe të mira interneti për krijimin janë: www.answeringenesis.org dhe www.icr.org

Shënim i veçantë për këtë mësim: Shumica e nxënësve janë mësuar ose do të mësojnë se bota u zhvillua rastësisht përmes evolucionit, kështu që ju lutem mos hezitoni ta përdorni fjalën "evolucion" në këtë mësim. Është thelbësore për të krishterët të njohin rrëfimin e krijimit të Perëndisë dhe mëkatit fillestar te Zanafilla, për të dalluar dhe kuptuar ndryshimet mes teorisë së evolucionit dhe ngjarjes së vërtetë të universit të krijuar. Qëllimi ynë gjatë këtyre tre mësimeve të para është që t'i ndihmojmë nxënësit:

- të kuptojnë atë që thotë Perëndia për mënyrën se si u formua bota;
- të shohin se teoria e evolucionit kundërshton Biblën;
- të besojnë me siguri se Perëndia e krijoi botën;
- të kuptojnë se si mëkati hyri në botë, dhe të kuptojnë nevojën tonë për Shpëtimtarin.

Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Merr me vete nga një objekt që tregon për secilën nga ditët e krijimit dhe vendosi në shtatë çanta të ndryshme. Kërkoju nxënësve t'i shohin dhe t'i prekin objektet që t'i ndihmojnë të kujtojnë mësimin. Ja disa ide: syze dielli për të treguar diellin, ujë në një shishe të tejdukshme, pambuk ose re e prerë nga një letër e bardhë, rërë për të treguar për tokën e thatë, një gjethe për pemët, një pendë për zogjtë, një peshk plastik për krijesat e detit, kafshë plastike, një kukull e vogël dhe një jastëk i vogël për të përfaqësuar pushimin.
2. Vizato në pjata plastike diçka që përfaqëson secilën ditë të krijimit (mos e shkruaj ditën). Ndërsa jep mësimin, vendosi pjatat me radhë. Pas mësimit, hiqi vizatimet. Ndaje klasën në skuadra dhe jepi secilës skuadër një set me pjata. Le të garojnë për të parë se cila skuadër i vendos ditët e krijimit sipas radhës më shpejt. Nëse keni kohë, përsëriteni garën.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Zbukuroje derën e klasës dhe vëri një letër ku shkruhet “Makinë kohe”. Lejoji nxënësit që imagjinata t’i kthejë pas në kohë ndërsa hyjnë në klasë.
4. Krijo versionin miniaturë të “Kopshtit Eden” në një akuarium. Përdore akuariumin këtë javë dhe gjatë dy javëve të ardhshme.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: E planifikuar me hollësi!

Qëllimi: T’i ndihmojmë nxënësit të shohin dhe kuptojnë **hollësirat** e krijimit të Perëndisë.

Alternativa 1 (për të gjithë nxënësit)

Krijo një kopsht zoologjik brenda ose jashtë. Cakto vullnetarë që të bëhen kafshë specifike, duke dhënë fakte argëtuese për mënyrën se si këto kafshë u krijuan në mënyrë unike nga Perëndia. Kërkoju nxënësve t’i vizitojnë kafshët gjatë *Kohës së zbulimit*, duke u përqendruar në **hollësirat** unike të kafshëve.

Alternativa 2 (për grupe specifike)

Aktiviteti 1: Trotuari jashtë ose hapësirë e madhe brenda

Mjetet:

- Shkumës
- Etiketa shpërblyese
- Tabak (nëse po e zhvillojnë aktivitetin brenda)

Udhëzime për ambientin: Ndaje trotuarin ose letrën e madhe (tabakun) në zona të caktuara për secilin grup. Në secilën prej zonave të caktuara, shkruaj fjalët: “Shiko çfarë bëri Perëndia!”

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe ose në skuadra të vogla.
2. Sfidoji skuadrat të vizatojnë sa më shumë kafshë përreth frazës “Shiko çfarë bëri Perëndia!”
3. Skuadra që ka vizatuar kafshët me më shumë **imtësi,** do të fitojë nga tri etiketa shpërblyese për secilin nxënës.
4. Pasi të ketë përfunduar sfida, kërkoju nxënësve të shohin kafshët e ndryshme që ka bërë Perëndia.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 2: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Kafshë të vogla prej lodre që fëmijët të mund t'i shohin si: zogj, qen, mace, peshq, hardhuca etj.
- Lupë zmadhuese
- Lapsa dhe letra
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe.
2. Sfidoji partnerët të garojnë për të parë se cila dyshe mund të japë më shumë hollësira të secilës kafshë. Sfidoji t'i përdorin të gjitha shqisat.
3. Kur të përfundojë sfida, diskutoni hollësirat e krijimit të Perëndisë me nxënësit.
4. Shpërble skuadrën fituese me tri etiketa shpërblyese.

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit - *Mësimi i misionit gjendet në dosjen e kurikulës së vitit të 1-rë, tremujori i 1-rë.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Gjatë aktivitetit të KZ-së, ju u sfiduat të mendonit për disa nga kafshët në botë. A e keni menduar ndonjëherë se si e krijoi Perëndia secilën prej kafshëve në një mënyrë të veçantë, me kaq shumë **imtësi**? Perëndia jo vetëm që krijoi të gjitha kafshët (dhe bimët), por Ai krijoi të gjithë botën tonë. Ai është i mrekullueshëm! Sot do të udhëtojmë te fillimi i Biblës për të zbuluar se si Perëndia e krijoi botën.

***Shënim**: Nëse në KZ keni zhvilluar mësimin e misionit, ju lutem theksoni se misionarët shpesh udhëtojnë në pjesë të tjera të botës, ku shohin shumë krijesa të mrekullueshme që Perëndia ka krijuar, siç janë kafshët, bimët apo peizazhet e ndryshme.*

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të luten kur ka njerëz dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre drejtuese frymërore. Nëse nxënësit në klasën tënde nuk duan të luten, shpjegoju se është nder të drejtosh klasën në lutje, dhe pastaj jepu shembullin duke bërë një lutje të shkurtër.*

Zbuloje: Ku do të mund të gjeni më shumë informacion të hollësishëm në Bibël për mënyrën se si Perëndia krijoi botën? (Te Zanafilla). A është Zanafilla në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re (DH.V.)? Le t'i hapim Biblat në faqen e parë, libri i Zanafillës, kapitulli një. *Nxënësit më të vegjël dhe vizitorët mund të kenë nevojë për*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

ndihmë. Kjo mund të jetë hera e parë që disa prej tyre hapin Biblën. Nxënësit më të rritur mund të përdorin metodën "Stërvitja me shpata".
Çfarë është "Stërvitja me shpata?" Si mësues, ti thua: "Biblat lart!". Krahët e nxënësve duhet të ngrihen lart me Biblat drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet të përsërisin pas teje. Pasi të gjithë nxënësit të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: "Nisu!". Nxënësi i parë që gjen referencën, fiton një etiketë shpërblyese.

Kronologjia: *Përdor kronologjinë e Biblës për të treguar periudhat kohore ndërsa prezanton mësimin.* Do të shkojmë në fillim fare këtë tremujor. Fjala "zanafillë" do të thotë "fillim" dhe libri i Zanafillës na tregon për fillimin, atëherë kur Perëndia krijoi botën.

Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla: Si e di ti që Bibla është e vërtetë? Para se të nisim këtë mësim, duhet të kujtojmë se mund t'i besojmë asaj që Bibla na thotë për Perëndinë, për ne dhe për botën rreth nesh. Mund të jemi të sigurt se ajo është e vërtetë, për shkak se ka prova historike, për shkak se Bibla është e mbushur me profeci dhe për shkak se Perëndia thotë që ajo është e vërtetë.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 1:1 – 2:3

Perëndia fillon

Lexo: Zanafilla 1:1

Përmbledhje: Bibla na thotë se Perëndia krijoi botën, por a e ke pyetur ndonjëherë veten: "Kush e krijoi Perëndinë?". Kjo është një pyetje shumë e mirë dhe Bibla na e jep përgjigjen. Bibla thotë se Perëndia është i përjetshëm – përjetësi do të thotë *përgjithmonë*. Është një lloj rrethi; nuk ka as fillim as fund. Perëndia nuk u krijua dhe Ai nuk ka as fillim as fund. Ai ka qenë gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë. A nuk është kjo diçka fantastike? Le të shohim se çfarë ndodhi ditën e parë.

Dita e parë

Lexo: Zanafilla 1:2-5

Përmbledhje: Çfarë krijoi Perëndia në ditën e parë? (Dritën.) Dhe si e quajti atë dritë? (Ditë.) Dhe si e quajti errësirën? (Natë.) Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar dritën? (Ai tha se ishte mirë.) Cilat ishin dy pjesët që përbënin një ditë? (Një mbrëmje dhe një mëngjes.) Le të shkojmë te dita e dytë.

Dita e dytë

Lexo: Zanafilla 1:6-8

Përmbledhje: Çfarë krijoi Perëndia në ditën e dytë? (Qiellin.) Si e krijoi Perëndia qiellin? Ai ndau ujërat. Ujërat e lëngshëm u formuan në Tokë, ujërat

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

e avulluar formuan retë dhe hapësira mes tyre u quajt "qiell". A nuk është e mrekullueshme sa i fuqishëm është Perëndia? Le të lexojmë për ditën e tretë.

Dita e tretë

Lexo: Zanafilla 1:9-13

Përmbledhje: Cila ishte gjëja e parë që Perëndia krijoi në ditën e tretë? (Ai krijoi tokën dhe detet.) Cilën fjalë përdori Perëndia për të përshkruar tokën dhe detet? (Mirë.) Çfarë krijoi Perëndia në ditën e tretë pas tokës dhe deteve? (Bimësinë.) "Bimësia" u referohet të gjitha bimëve, përfshirë edhe pemët. A krijoi Perëndia lloje specifike bimësh? (Po.)

Kur mendon për të gjitha llojet unike të bimëve që ka në botë, a nuk të bën të mendosh se sa krijues është Perëndia ynë? Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar bimësinë? (Mirë.) Tani le të shohim ditën e katërt.

Dita e katërt

Lexo: Zanafilla 1:14-19

Përmbledhje: Çfarë krijoi Perëndia në ditën e katërt? (Diellin, hënën dhe yjet.) Ku e vendosi Perëndia diellin, hënën dhe yjet? (Në qiell.) A mendon ndonjëherë sa i madh duhet të jetë Perëndia për ta vendosur diellin, hënën dhe yjet në qiell? A e kupton se dielli, hëna dhe yjet ndajnë ditën nga nata? Ato janë shenja që masin periudhat e kohës: stinët, ditët dhe vitet. Ato sjellin dritë në tokë. Cilën fjalë përdori Perëndia për të përshkruar diellin, hënën dhe yjet? (Mirë.)

Nxënësit më të rritur: A kishte dritë para se Perëndia të krijonte diellin, hënën dhe yjet? (Po.) Shih Zanafilla 1:3. A kishte ditë dhe natë para diellit, hënës dhe yjeve? (Po.) Shih Zanafilla 1:5. A e di se Zbulesa 22:5 na tregon se si do të jetë qielli? Thuhet: "Dhe natë nuk do të ketë atje; edhe nuk kanë nevojë për llambë, as për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon; dhe do të mbretërojnë në jetë të jetëve." Perëndia do të jetë drita jonë në qiell!

Të gjithë nxënësit: Le të kalojmë në ditën e pestë.

Dita e pestë

Lexo: Zanafilla 1:20-23

Përmbledhje: Çfarë krijoi Perëndia në ditën e pestë? (Krijesat e detit dhe zogjtë.) Kur mendon për të gjitha llojet e ndryshme të krijesave të detit dhe për zogjtë, a nuk është e mrekullueshme se me sa imtësi veproi Perëndia kur i krijoi të gjitha këto krijesa? Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar krijesat e detit dhe zogjtë? (Mirë.) Çfarë donte Perëndia që të bënin krijesat e

detit dhe zogjtë? (Të rriteshin në numër për të mbushur detet dhe tokën.) Tani erdhi koha për ditën e gjashtë.

Dita e gjashtë

Lexo: Zanafilla 1:24-25

Përmbledhje: Cila ishte gjëja e parë që krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Krijesat e tokës – siç pamë sot gjatë KZ-së.) A bëri Perëndia lloje specifike të krijesave të tokës? (Po.) Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar krijesat e tokës? (Mirë.)

Lexo: Zanafilla 1:26-27

Përmbledhje: Cila ishte gjëja e dytë që krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Njerëzit; mashkull dhe femër). Çfarë ishte kaq e veçantë në mënyrën si Perëndia krijoi njeriun? (Ai e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij.)

Nxënësit më të mëdhenj: Përse mendoni se Perëndia tha: "Le ta bëjmë sipas shëmbëlltyrës sonë?" (Triniteti: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë – të tre ishin në krijim!)

Të gjithë nxënësit: Perëndia i dha njeriut një punë, të sundonte mbi krijesat e detit, mbi zogjtë dhe krijesat e tokës. Kjo do të thotë se ne nuk jemi të barabartë me kafshët. Ne jemi ndryshe – ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

Lexo: Zanafilla 1:28-31

Përmbledhje: Çfarë donte Perëndia që të bënin njerëzit? (Të shtoheshin dhe të mbushnin tokën.) Perëndia gjithashtu na deshi mjaftueshëm, sa na dha ushqim përmes pemëve frytmbajtëse dhe bimësisë. Perëndia i kishte planifikuar hollësirat, përfshirë se çfarë do të hanin kafshët dhe zogjtë. Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar gjithçka kishte bërë? (Shumë mirë.)

Uau! A nuk është Perëndia aq i dashur, që krijoi një vend të jashtëzakonshëm ku ne të jetonim? Le të shohim çfarë bëri Perëndia më pas.

Dita e shtatë

Lexo: Zanafilla 2:1-3

Përmbledhje: Çfarë krijoi Perëndia në ditën e shtatë? (Asgjë.) Perëndia bëri diçka shumë të veçantë: Ditën e shtatë, Ai pushoi.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Nxënësit më të mëdhenj: A kishte nevojë Perëndia të pushonte për shkak se ishte i lodhur? (Jo.) Atëherë çfarë kuptimi ka fakti që Ai pushoi? (Do të thotë se Ai u ndal së krijuari gjëra të reja.) Si e bëri Perëndia ditën e shtatë të veçantë? (Ai e bekoi dhe e bëri të shenjtë.) Çfarë do të thotë "e shenjtë"? (E shenjtë do të thotë "e ndarë veçmas për Perëndinë".)

Përfundimi

Mendo për çfarë ka krijuar Perëndia: diellin, hënën dhe yjet në qiell, tokën, oqeanet, lulet e bukura, pemët madhështore, kafshët dhe ne! Mund të shohim të gjitha hollësirat e gjithçkaje në botën tonë të mrekullueshme dhe të kuptojmë se ka një Krijues, dhe se Krijuesi është Perëndia. Ne mund të shohim çfarë ka bërë Ai dhe të besojmë në Të. Krijimi vërteton se Perëndia ekziston dhe se Ai na do!

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Nxënësit më të rritur: *Bëni aktivitetin "Stërvitja me shpata" për të gjetur Hebrenjve 11:3. Kërkoji dikujt ta lexojë me zë të lartë para klasës.*

Të gjithë nxënësit: A është e rëndësishme të dimë se Perëndia e krijoi botën siç thuhet te Zanafilla? (Po!) Edhe nëse nuk i dimë të gjitha hollësirat e mënyrës se si Perëndia i plotfuqishëm e bëri botën, mund të zgjedhim të besojmë se Ai e bëri. Bibla na thotë se është e pamundur t'i pëlqejmë Perëndisë nëse nuk kemi besim (Hebrenjve 11:6). Ndoshta mësuesit e tu në shkollë ose miqtë e tu duan që ti të besosh diçka tërësisht ndryshe, si për shembull që bota u krijua aksidentalisht. Por tani që ti e di të vërtetën nga Bibla, mund të zgjedhësh të besosh që Perëndia e krijoi botën, siç thotë Ai thotë te Zanafilla. Le ta themi Zanafillën 1:1 si klasë. *Recitojeni vargun bashkë.* Tani, le t'i mbyllim sytë dhe ta themi sërish, dhe pastaj të ndalemi për ta falënderuar personalisht Perëndinë që është një Krijues i mrekullueshëm.

E di cila është një nga arsyet për t'u gëzuar që Perëndia e krijoi botën? Fakti që do të thotë se Ai të do shumë. Ai e bëri këtë botë që ti ta shijosh dhe të mund të jetosh për Të. Ne pamë disa nga hollësirat e Perëndisë sot. A e di që Ai ka një plan të hollësishëm për jetën tënde tani deri në përjetësi (faqja e artë në Librin pa fjalë)? Perëndia ynë që krijoi gjithë universin, të do shumë. Ai dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdiste si ndëshkim për mëkatin tënd (faqja e zezë) në kryq (faqja e kuqe). Por Perëndia të do aq shumë, saqë të jep ty zgjedhjen për të besuar ose jo në Të. Nëse beson në Jezusin që të të falë mëkatin dhe e bën udhëheqësin e jetës sate, Ai mund ta pastrojë mëkatin tënd dhe ti mund të jesh i shpëtuar e të bëhesh pjesë e familjes së Perëndisë (faqja e bardhë). A të kujtohet çfarë do të thotë përjetësi? Do të thotë *përgjithmonë*. Edhe pse

trupi yt nuk do të funksionojë më një ditë, do të jetosh në qiell përgjithmonë me Perëndinë. A je lutur e i ke thënë Perëndisë se beson që Jezusi do të marrë mëkatin tënd dhe se e ke bërë Udhëheqësin e jetës sate? Nëse jo, mund ta bësh tani.

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën

Shënim: Çdo javë shtohet nga një lëvizje e re. Është e rëndësishme ta rishikojmë çdo javë, që në fund të tremujorit studentët të mund "të flasin për Zanafillën" me siguri.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e parë dhe të dytë? (Dritën dhe qiellin.)
2. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e tretë? (Tokën, detet dhe bimësinë.)
3. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e katërt? (Diellin, hënën dhe yjet.)
4. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e pestë? (Krijesat e detit dhe zogjtë.)
5. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Krijesat e tokës dhe njerëzit.)
6. Çfarë bëri Perëndia në ditën e shtatë? (Ai pushoi së punuari, bekoi ditën dhe e bëri të shenjtë.)
7. A e beson se Perëndia e krijoi tokën, ashtu si tha te Zanafilla, pavarësisht gjithçkaje? Përse po ose jo?
8. Si ndikon te mënyra si ti e shikon veten dhe të tjerët të diturit se Perëndia i krijoi njerëzit?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 2
Zanafilla 2:4-25

Kupto si duhet:	Perëndia krijoi Adamin dhe Evën.
Mendo si duhet:	"Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to." Efesianëve 2:10
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se Perëndia më krijoi.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i dashur, për shkak se Perëndia më krijoi.

PËRGATITU!

Ashtu si Adami dhe Eva u krijuan nga Perëndia për të punuar si një skuadër, secili prej nesh ka një rol unik dhe të rëndësishëm si drejtues në shërbesën e fëmijëve. Ndalu dhe mendo se sa e mrekullueshme është që Perëndia të krijoi dhe të dha dhunti e talente unike! Ndërsa studion mësimin, falënderoje Perëndinë që të krijoi ty dhe secilin nga nxënësit e tu, dhe bëhu gati t'i shërbesh Atij me të vetmen mënyrë që mundesh!

Lutu: Lutu që nxënësit ta kuptojnë plotësisht se janë krijuar si një kryevepër e Perëndisë.

Lexo: Zanafilla 2:4-25

Kupto si duhet: Perëndia krijon Adamin dhe Evën.
Pastaj do të shohim më nga afër ditën e gjashtë të krijimit për të mësuar se si Perëndia e formoi njeriun e parë. Perëndia na thotë se Ai mori pluhurin nga toka, i dha formën e një njeriu dhe hukati frymë jete tek Adami, kështu ai u bë qenia e parë njerëzore. Ai i dha Adamit një shtëpi të jashtëzakonshme në Kopshtin e Edenit, një punë për të bërë dhe ushqim për të ngrënë. Pastaj Perëndia bëri një grua si ndihmësen e tij – direkt nga brinja e Adamit. Perëndia e bashkoi Adamin dhe Evën në një tjetër nga krijimet e Tij të veçanta – martesë – dhe u tha të kishin fëmijë, që toka të mbushej me njerëz. Nga ky plan i saktë dhe i qëllimshëm, kuptojmë se Perëndia na krijoi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor: Një pikëpamje e shëndetshme për veten është shpeshherë sfidë për shumë nxënës. Kjo është një javë e shkëlqyer për t'u kujtuar nxënësve se janë një kryevepër apo mjeshtëri e Perëndisë (vargu i *Mendo si duhet* – Efesianëve 2:10). Ata mund të gjejnë paqe kur të kuptojnë se u krijuan nga një Perëndi i dashur, me qëllim dhe me vlerë. Ai është i afërt dhe i dashur. Të kuptuarit e kësaj ndikon te mënyra si adhurojmë, jetojmë dhe i shërbejmë Perëndisë; edhe në kohët e mira, edhe në kohët e vështira të jetës.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Jepe mësimin duke përdorur plastelinë. Krijoni Adamin dhe Evën, një lumë etj., sipas mësimit. Disa gjëra mund t'i bësh para mësimit, ose t'i kërkosh Bariut apo drejtuesit të KZ-së të punojë me plastelinën si një "artist i heshtur", ndërkohë që ti shpjegon mësimin.
2. Kërkoji drejtuesit të KZ-së ose Bariut të lexojë pjesën nga Shkrimi dhe ti, mësuesi, bëj pjesën e "përmbledhjes".
3. Përdor versionin miniaturë të "Kopshtit të Edenit" (në akuarium) nga java e kaluar, dhe përdore përsëri edhe javën e ardhshme.
4. Krijoje skenën në klasë. Bëj dy lumenj me letër blu (tabak blu) dhe merr kafshë pelushi dhe objekte kopshti. Vizato një pemë me fruta në tabelë. Përdor globin për t'u treguar nxënësve se ku ndodhej ky vend.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Detajet janë shumë të rëndësishme!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë se si u krijuam **në mënyrë të hollësishme**, unike dhe të veçantë.

Aktiviteti 1: Stacioni i rërës

Mjetet:

- Metër (Nga dy për çdo skuadër)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për ambientin: Ndajeni rërën në katër ose më shumë seksione dhe sigurohuni që të jetë mjaft e lagur për të marrë formë.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaje klasën në katër ose më shumë skuadra.
2. Sfidoje çdo skuadër të krijojë një njeri me rërë, dikë që përfaqëson një anëtar të skuadrës.
3. Nxënësit duhet t'i japin rërës formën e personit, duke u siguruar të përdorin përmasa të sakta.
4. Inkurajoji skuadrat ta bëjnë personin prej rëre sa më real dhe të **hollësishëm** të munden, duke i kushtuar rëndësi stilit të flokëve, llojit të rrobave që personi ka veshur etj.
5. Thekso sa e vështirë është ta krijosh dikë me **hollësi**.
6. Shpërble me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës fituese në bazë të figurës më të arritur dhe **më me hollësi**.

Aktiviteti 2: Stacioni i dërrasës së zezë ose trotuarit jashtë (Nëse moti është i mirë.)

Mjetet:

- Shkumës
- Etiketa shpërblyese
- Me zgjedhje: Përdor tabak në vend të tabelës së zezë apo një trotuari

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe.
2. Së bashku partnerët duhet të vizatojnë një person dhe pastaj ta ngjyrosin me sa më shumë **hollësi** të munden.
3. Përgjatë aktivitetit, thekso tiparet unike që Perëndia krijoi tek ata.
4. Shpërbleji partnerët që kanë vizatuar personin me më shumë **hollësi**, me nga pesë etiketa shpërblyese.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Pjata plastike të ndara në katër seksione (nga një për çdo nxënës) ose tasa të vegjël (nga katër për çdo nxënës)
- Katër produkte ushqimore me shije të ndryshme që t'i provojnë fëmijët. Pjatat e ndara në seksione apo tasat, duhet të përgatiten më përpara dhe të kenë nga një provëz të secilit ushqim që nxënësit t'i provojnë, duke u siguruar që secila pjatë të ketë vendosje identike të ushqimit. Përpiqu të zgjedhësh tre ushqime që disa fëmijë i pëlqejnë dhe disa që nuk i pëlqejnë, për shembull, turshi, ullinj, karamele të athëta, "marshmellou" etj. Përfundoje me një ushqim të katërt që zakonisht pëlqehet nga të gjithë fëmijët, në mënyrë që KZ-ja të përfundojë në nota pozitive
- Tabelë e bardhë dhe lapustilë (vizato katër kolona dhe etiketoji me secilin prej katër ushqimeve)
- Me zgjedhje: Lidhëse për sytë (nga një për çdo nxënës të vendosura nëpër karrige para se të vijnë nxënësit) që ta bësh pak më befasuese. Nëse përdorin lidhëset e syve, nxënësit nuk duhet t'i shohin më parë ushqimet

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Thuaj: "Perëndia e krijoi secilin prej jush me shumë hollësi, që të jeni unikë. Disa nga hollësirat më të jashtëzakonshme që të ka dhënë Perëndia janë puprri të vogla shijeje. A e kupton se një person ka mesatarisht 10.000 puprri shijeje, dhe ato zëvendësohen çdo dy javë? Dhe se puprritë e çdo personi janë ndryshe nga njëri person në tjetri? Kjo nuk është diçka e rastësishme; vetëm Perëndia ynë i jashtëzakonshëm mund të krijonte diçka të tillë. Sot do të mbyllim sytë (duke përdorur lidhëset), dhe do të shohim se sa të efektshme janë puprritë e tua të shijimit!"
2. Mbyllua sytë fëmijëve (me lidhësen e syve) dhe sillu përpara tabakanë me pjatat/tasat të mbushura me ushqimet që do të provojnë. Të gjithë nxënësit duhet të provojnë të njëjtat ushqime.
3. Pasi të kenë provuar ushqimin, pyeti për të parë nëse e kanë pëlqyer ushqimin, nëse iu duk i mirë apo nëse nuk ishte i preferuari i tyre. Kërkoju ta tregojnë këtë duke ngritur gishtin e madh në formë pohimi, ose duke e kthyer poshtë në formë mohimi; ose anash nëse iu duk thjesht e mirë. Kujtoju që të mos flasin me zë, në mënyrë që të mos ndikojnë te nxënësit e tjerë të cilët i kanë sytë e mbyllur.
4. Shëno rezultatet në tabelë.
5. Vazhdo me pjesën tjetër të ushqimeve.
6. Në fund, kërkoju nxënësve të heqin lidhëset e syve dhe tregoju rezultatet.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

7. Kujtojua nxënësve se Perëndia e krijoi secilin prej nesh me hollësira të jashtëzakonshme, përfshirë këtu edhe puprritë e shijes!

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit gjendet në dosjen e kurikulës së vitit të 1-rë, të tremujorit të 1-rë.*

Aktiviteti 4: Stacioni i ujit ose ambient i hapur

Mjetet:

- Tabak
- Lapustila
- Bojëra dhjami
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me tre deri në pesë anëtarë.
2. Kërkoju skuadrave të vizatojnë një person në një tabak duke përdorur një ngjyrë dhjami.
3. Pastaj kërkoju skuadrave ta plotësojnë vizatimin me sa më shumë **hollësira** të munden, p.sh., hunda, qukat, qerpikët, duart, flokët etj.
4. Vazhdo të theksosh tiparet unike që Perëndia ka krijuar: thonjtë, veshët, bërrylat etj.
5. Kur të përfundojë koha, shpërble skuadrën që vizatoi në mënyrën më të **hollësishme** me pesë etiketa shpërblyese.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Perëndia të krijoi në mënyrë unike! Është e mrekullueshme të mendosh për miliona e miliona njerëz në këtë botë dhe të kuptosh se asnjëri prej tyre nuk është si ti. Shiko duart e tua. *Kërkoju nxënësve të tregojnë duart.* Perëndia të krijoi në mënyrë kaq unike, saqë je i vetmi person me ato shenja gishtash. Vetëm një Perëndi i vërtetë mund të të krijonte me aq shumë hollësi unike. Çfarë mendimi! Ai me të vërtetë duhet të të dojë shumë! Le të zhytemi në Bibël dhe të zbulojmë diçka të re për Perëndinë tonë.

***Shënim**: Nëse KZ-në e keni bërë në stacionin e misionit, ju lutem shpjegoni se misionarët udhëtojnë në pjesë të ndryshme të botës për t'u treguar të tjerëve rreth Jezusit, për shkak se e dinë që Perëndia krijoi dhe do miliona e miliona njerëz që nuk e njohin Atë.*

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit e tu të drejtojë klasën në lutje. Kujtojua nxënësve se kur luteni së bashku, të gjithë duhet të dëgjojnë dhe të luten në heshtje me personin*

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

që ka ngritur zërin. Kur thua "Amen" në fund, do të thotë se po bie dakord me çfarë po thuhet.

Zbuloje: A është Zanafilla në Dh.V. apo në Dh.R.? (Dh.V.) Le të hapim Biblat te libri i Zanafillës, kapitulli i 2-të.

Kronologjia: A mund ta gjeni Zanafillën te Kronologjia? Pas një numërimi deri në tre, të gjithë duhet të drejtojnë gishtin te Zanafilla. Zanafilla është një libër emocionues, ku zbulojmë se si Perëndia e krijoi botën.

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të shohim se çfarë kujtoni nga java e mëparshme. *Përdor objekte ose foto nga java e mëparshme ndërsa bën pyetjet e mëposhtme, ose ngatërroji objektet dhe kërkoju nxënësve t'i vendosin në rendin e duhur. Thuaj ditën dhe sfidoji nxënësit të tregojnë se çfarë krijoi Perëndia në atë ditë specifike, ose thuaj emrin e objektit që Perëndia krijoi dhe kërkoju atyre të thonë se në cilën ditë u krijua.*

Çfarë u krijua në:

- Ditën e parë? (Drita.)
- Ditën e dytë? (Qielli.)
- Ditën e tretë? (Toka, ujërat dhe bimësia.)
- Ditën e katërt? (Dielli, hëna dhe yjet.)
- Ditën e pestë? (Krijesat e detit dhe zogjtë.)
- Ditën e gjashtë? (Krijesat e tokës dhe njerëzit.)

Dhe çfarë ndodhi në ditën e shtatë? (Perëndia pushoi, bekoi ditën e shtatë dhe e bëri atë të shenjtë.)

Sot do të përqendrohemi në ditën e gjashtë, për të zbuluar më shumë për mënyrën se si Perëndia krijoi qeniet njerëzore. A je gati?

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 2:4-25

Perëndia krijon Adamin, njeriun e parë.

Lexo: Zanafilla 2:4-7

Nxënësit më të rritur: Kur e krijoi Perëndia Adamin? (Para se bimët dhe shkurret e fushës të kishin çelur dhe para se të dërgonte shiun.) *Shënimi i mësuesit kryesor: Te Zanafilla 1:11-12, bimësia u rrit vetë. Te Zanafilla 2:5, bimët dhe shkurret e fushës kërkonin kultivim.*

Të gjithë nxënësit: Nga çfarë e formoi Perëndia Adamin? (Nga pluhuri i tokës.) Çfarë hukati Perëndia në flegrat e hundës së Adamit? (Frymën e jetës.)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Çfarë u bë njeriu? (Qenie e gjallë.) Le të zbulojmë se çfarë bëri Perëndia me Adamin pasi e krijoi.

Perëndia i jep Adamit një shtëpi.

Lexo: Zanafilla 2:8-14

Përmbledhje: Si quhej shtëpia e re e Adamit? (Kopshti i Edenit.) Përshkruaj pemët që Perëndia rriti në kopsht. (Pemë që ishin të këndshme për syrin dhe të mira për t'u ushqyer.) Cilat ishin dy pemët e veçanta në Kopshtin e Edenit? (Pema e jetës dhe pema e njohjes të së mirës dhe së keqes.) Sa lumenj kishte në Kopsht? (Një.) Në sa lumenj ndahej lumi kryesor? (Katër.)

Nxënësit më të rritur: Cilët ishin emrat e katër lumenjve? (Pishon, Gihon, Tigri dhe Eufrati.) Nuk e dimë ekzaktësisht se ku gjendeshin Pishon dhe Gihon, por Tigri dhe Eufrati gjenden në shtetin e sotëm të Irakut. Tregoje këtë në hartën e kohës biblike.

Të gjithë nxënësit: Një nga gjërat më të bukura të Kopshtit ishte se nuk kishte mëkat apo trishtim. Gjithçka ishte e përsosur! A e imagjinon dot si do të ishte bota sot po të mos kishte mëkat? Çfarë mendon se duhet të bënte Adami në Kopshtin e Edenit? Le të shohim.

Perëndia i jep Adamit një punë dhe një urdhërim.

Lexo: Zanafilla 2:15-17

Përmbledhje: Adami kishte një punë të mrekullueshme. Ai ishte në gjendje të punonte në një kopsht të përsosur, mbushur me fruta dhe lule. As nuk e imagjinoj dot ç'kopsht i bukur duhet të ketë qenë! Në Kopshtin e Edenit, Adami duhej t'i bindej thjesht një rregulli: mos ha nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Duke qenë se kishte plot pemë të mbushura me të mira, jam i sigurt që ky s'duhet të ketë qenë një problem, apo jo? Madje Perëndia ishte aq i mirë, saqë i tregoi Adamit ç'do të ndodhte po të hante nga ajo pemë – ai me siguri do të vdiste.

Adami ishte burri i parë. Po gruaja e parë? Le të vazhdojmë të lexojmë.

Perëndia krijon Evën, gruan e parë.

Lexo: Zanafilla 2:18-23

Përmbledhje: Uau! A e imagjinon dot të të duhet t'u japësh emër kafshëve? Një punë vërtet argëtuese!

Nxënësit më të rritur: Edhe njeriu i parë kishte një punë; Perëndia na krijoi të punojmë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Të gjithë nxënësit: Si e krijoi Perëndia gruan e parë? (Ai vuri Adamin në gjumë të thellë, i hoqi njërën nga brinjët dhe prej saj bëri Evën.)

Perëndia krijon martesën.

Lexo: Zanafilla 2:24-25

Përmbledhje: Këtu Perëndia krijon martesën. Plani i Perëndisë për martesën është i përsosur – një burrë dhe një grua, dhe Adami dhe Eva ishin të parët që u martuan. Perëndia e kishte krijuar Evën nga vetë trupi i Adamit për të qenë ndihma e tij, dhe tani, Ai i bashkoi për të qenë një çift i martuar, të cilët do të kishin fëmijë e do të mbushnin tokën.

Nxënësit më të rritur: Nxënës, a e dini që Satani ende përpiqet t'i hutojë njerëzit për martesën edhe sot? Ai do që njerëzit të mendojnë se divorci dhe martesa brenda së njëjtës gjini (burra që martohen me burra dhe gra që martohen me gra), është në rregull. Në këto vargje që sapo lexuam dhe në vargje të tjera, mund të shohim që Perëndia ka vendosur standarde për martesën në Bibël. Martesa duhet të jetë mes një burri dhe një gruaje, dhe duhet të zgjasë derisa njëri prej tyre të ndërrojë jetë.

Vargje shtesë për të lexuar: Mateu 19:6; 1 e Korintasve 7:12 dhe Efesianëve 5:22-33.

Përfundimi

Perëndia krijoi Adamin dhe Evën. Ai u dha atyre shtëpinë e përsosur dhe një punë për të bërë. Ai u dha atyre martesën, që të mund të jetonin së bashku sipas mënyrës së Tij. Ata jetuan me Perëndinë dhe gjithçka ishte 100% e përsosur! A mund ta imagjinosh të jetosh në një vend të përsosur?

Por Perëndia iu dha një urdhërim: mos hani nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Duket si një urdhërim i thjeshtë... apo ndoshta jo? Javën e ardhshme do të mësojmë se çfarë ndodhi me Adamin dhe Evën në Kopshtin e Edenit. Nuk do të doje ta humbisje!

Vepro si duhet dhe ndihu si duhet

Perëndia krijoi Adamin dhe Evën, por nuk u ndal aty. A e di që Perëndia të krijoi edhe ty? Ai të njeh aq mirë dhe të do aq shumë, saqë Ai di edhe numrin e flokëve në kokën tënde! *Referoju Kohës së Zbulimit.* Tek Efesianëve 2:10, Ai thotë se ne jemi vepra e Tij. Kjo do të thotë se secili prej nesh është një kryevepër! Ai e krijoi Adamin dhe Evën për të qenë me Të, dhe Ai të krijoi ty për të qenë me Të gjithashtu! Le t'i mbyllim sytë

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dhe të mendojmë për këtë varg. Ti je një kryevepër e Perëndisë, krijuar për një qëllim. Merr një minutë kohë për ta falënderuar Perëndinë që të krijoi.

Adami dhe Eva jetuan dhe ecën me Perëndinë. Si mundën ta bënin këtë? Për shkak se ende nuk kishin mëkatuar. Perëndia mund të ketë një marrëdhënie vetëm me njerëz që nuk kanë mëkatuar. Por... çfarë thotë Romakëve 3:23? *Kërkoju nxënësve ta recitojnë.*

Të gjithë kemi mëkatuar. Por për shkak se Perëndia të do kaq shumë, Ai bëri një rrugë që mëkati të falej, që ti të kishe një marrëdhënie me Të. Ai dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdiste në kryq për mëkatin tënd, dhe Perëndia e ngriti Jezusin nga vdekja, në mënyrë që të ecësh me Të çdo ditë! A do ta kishte bërë Perëndia këtë nëse nuk do të të donte? (Aspak!) Nëse nuk i ke besuar Jezusit për të të shpëtuar nga mëkati yt, mund ta bësh sot. *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes Librit pa fjalë dhe ftesë për shpëtim.*

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Si e krijoi Perëndia Adamin? (Ai e formoi nga pluhuri i tokës dhe hukati frymë jete mbi të.)
2. Çfarë shtëpie i dha Perëndia Adamit? (Kopshtin e Edenit.)
3. Çfarë pune i dha Perëndia Adamit? (Të punonte dhe të kujdesej për kopshtin e Edenit.)
4. Çfarë urdhërimi i dha Perëndia Adamit? (Mos ha frutin nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes.)
5. Çfarë tha Perëndia se do të ndodhte nëse Adami do të hante nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes? (Ai me siguri do të vdiste.)
6. Si e krijoi Perëndia Evën? (Ai e vuri Adamin në gjumë të thellë, mori një nga brinjët e tij dhe me të krijoi Evën.)
7. Kush e krijoi martesën? (Perëndia.)
8. Cili është plani i përsosur i Perëndisë për martesën? (Martesa duhet të jetë mes një burri dhe një gruaje.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

9. A beson se Perëndia të krijoi?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 3
Zanafilla 3

Kupto si duhet:	Mëkati hyn në botë.
Mendo si duhet:	"Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë." Romakëve 3:23 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të kuptoj se kam mëkatuar.
Ndihu si duhet:	Mund të ndihem falënderues, për shkak se Jezusi vdiq për mëkatin tim.

PËRGATITU!

Të kuptuarit e vërtetë të mëkatit dhe ndëshkimit të tij të përjetshëm ka humbur në brezin tonë. Si i ndihmojmë nxënësit të kenë një pikëpamje biblike, që të mund ta shohin mëkatin siç është në të vërtetë? Mund të rikthehemi te Zanafilla. Pavarësisht rolit tënd, studioje mësimin paraprakisht dhe lutu që ti dhe nxënësit e tu ta shihni mëkatin me sytë e Perëndisë, që të mund t'i përgjigjeni duke u kthyer te Jezusi për hirin dhe faljen e Tij.

Lutu: Lutu që nxënësit e tu të kuptojnë nevojën për një Shpëtimtar dhe të zgjedhin ta përqafojnë hirin dhe faljen që gjendet vetëm në Jezusin.
Mësuesi kryesor: Lutu që Perëndia të të japë një kuptim të qartë të Shkrimit ndërsa përgatitesh për mësimin.

Lexo: Zanafilla 3

Kupto si duhet: Mëkati hyn në botë
Pasi Perëndia krijoi Adamin dhe e vendosi në kopshtin e Edenit për të punuar dhe për t'u kujdesur për të, Ai i dha një urdhërim. Perëndia i tha Adamit të mos hante nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Perëndia i tha që, nëse Adami do të hante nga ajo pemë, do të vdiste. Megjithatë, në vend që ta dëgjonte Perëndinë dhe t'i bindej, Adami dëgjoi gruan e tij, Evën, e cila ishte mashtruar nga gjarpri i quajtur Satan. Kështu, edhe Adami edhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, dhe kryen mëkatin e parë, që solli vdekje dhe vuajtje në botë. Por mëkati i njeriut nuk përfundoi aty. Siç na tregon edhe Bibla, gjithsecili prej nesh, lindur nga Adami dhe Eva, kemi treguar mosbindje të marrë ndaj Perëndisë. Për këtë arsye, tani mund të kuptojmë se kemi mëkatuar!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Shpeshherë nxënësit pyesin: "Përse Perëndia e lejoi mëkatin që të hynte në botë?" Përgjigjja është që Ai na dha aftësinë për të bërë zgjedhjet tona. Ne nuk jemi robotë, por njerëz që mund të zgjedhim ta nderojmë Perëndinë ose të mos i bindemi.
- Për një shpjegim biblik të arsyes përse ne besojmë se gjarpri ishte Satani, lexo këtë artikull: http://www.answersingenesis.org/articles/2008/09/05/feedback-satan-lucifer-serpent
- Mëkati më i thjeshtë i një fëmije dhe mëkati më i lig i një të rrituri meritojnë të njëjtin ndëshkim: ndarje të përjetshme nga Perëndia. Të dyja situatat mëkatare kanë nevojë për të njëjtin Shpëtimtar, që është Jezu Krishti. Shpjegoje këtë mësim, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë realitetin e mëkatit dhe të faljes që mund të gjendet në Jezusin.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Vazhdo të përdorësh "Kopshtin e Edenit" në miniaturë nga dy javët e kaluara. Shto një pemë, një gjarpër (ose një krimb të vërtetë) dhe njerëz prej lodre.
2. Tregoje mësimin me figura dhe objekte: Adami, Eva, gjarpri, fruti, pema, kopshti.
3. Nxirr objekte nga një kuti: gjarpri, fruti, lule kopshti, gjethe, një karton që lexon "Mëkat!".
4. Krijo një dramë të heshtur: zgjidh dy nxënës të rritur që të jenë aktorë të heshtur (ose dy kukulla). Shto objektet përreth ndërsa jep mësimin. Shto frutin, një gjarpër dhe vendos një peshqir të errët mbi ta kur mëkatojnë.
5. Për nxënësit më të rritur: bëj një skicë të plotë të Adamit dhe të Evës në letër. Thekso sa të pastër janë Adami dhe Eva në fillim. Ndërkohë që shpjegon mësimin, shkruaj nëpër trupat e tyre mëkatet që kanë kryer. Me kalimin e kohës, fillo t'i sfidosh nxënësit për mëkatet e tyre. Kur të jetë mësimi drejt përfundimit, merr pak kohë për të parë "trupat" që dikur ishin të përsosur dhe që tani janë plot me mëkat. Thekso që këto janë mëkatet për të cilat Jezusi vdiq. Pyeti nxënësit se si mendojnë se do të dukej skica e tyre po të ishte në mur.
6. Ndërsa prezanton mëkatin, përdor një kavanoz me ujë të pastër dhe shto disa pika ngjyruesi të zi ushqimi, për të treguar se çfarë ndodhi kur mëkati hyri në botë.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Kuptoje!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të mësojnë përmendsh Romakëve 3:23.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Karton ku shkruhet vargu: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë. Romakëve 3:23" me shkronja të plota dhe të mëdha (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Bojëra dhjami/ngjyra
- Ngjitës i lëngshëm
- Xixa me ngjyrë të artë
- Kruajtëse veshësh ose furça për të shpërndarë ngjitësin (nëse përdor furça, merr një gotë me ujë që ta keni gati kur nxënësit të mbarojnë, kështu ngjitësi pastrohet më lehtë)
- Kuti të vogla apo tabaka të vogla (për të mbajtur xixat)
- Një shembull posteri të përfunduar
- Etiketat shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit për një garë. Nxënësi me posterin më të mirë do të fitojë pesë etiketa Shpërblyese.
2. Sfida është të ngjyroset posteri dhe të përdoren xixat e arta për të mbushur fjalët "lavdinë e Perëndisë" në varg. Çelësi është që ngjitësi të vendoset me kujdes te letra dhe xixat të hidhen sipër ngjitësit. (Këshillë: Vendosi kartonët në një kuti të vogël që të shpërndahen xixat lehtësisht dhe të mund të ripërdoren. Po, e dimë që do të bëhet pak rrëmujë, por do të jetë gjithashtu argëtuese!)
3. Ndërkohë që nxënësit punojnë, ndaloi vazhdimisht dhe sfidoji të recitojnë Romakëve 3:23 si grup.
4. Shpërble me pesë etiketa shpërblyese nxënësit me posterin fitues.

Me zgjedhje: Vare posterin që të thahet në galerinë e artit. Lejoji nxënësit t'i marrin në shtëpi kur të largohen.

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Akullore
- Tasa
- Lugë
- Shurup çokollate, krem pastiçerie, biskota të thërrmuara, qershi etj., për t'i vendos sipër akullores

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Peceta
- Në një rreth të bërë me karton, shënoni të gjithë përbërësit që keni marrë për të vendosur mbi akullore (kremi, shurupi etj.) dhe vendosni një shigjetë që nxënësit të mund ta rrotullojnë dhe të zgjedhin përbërësin që do të vendosin mbi akulloren e tyre (ose mund t'i shkruash përbërësit në fletë të ndryshme dhe nxënësit marrin nga një fletë)
- Posteri me vargun nga Romakëve 3:23 (burim i printueshëm); ose shkruajeni vargun në një karton apo tabelë (që nxënësit të përsërisin ndërsa përgatisin akulloren)

"...sepse të gjithë kanë MËKATUAR dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë."

Këshilla për Kohën e zbulimit: ndajeni paraprakisht akulloren në tasa, në mënyrë që të kurseni kohë. Sigurohuni t'i jepni nxënësve kohë të mjaftueshme për të shijuar akulloren.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Tregoju nxënësve se do të jenë pjesë e ngjarjes speciale të përgatitjes së akullores. Sa herë që të gjithë së bashku e recitojnë mirë Romakëve 3:23 me lëvizje, ata do të kenë mundësi të rrotullojnë shigjetën e përbërësve.
2. Mësoju atyre lëvizjet e Romakëve 3:23. Lejoju ta shohin posterin që t'i ndihmojë ta mësojnë vargun. (Pas disa raundesh, hiqi posterat dhe kërkoju ta recitojnë vargun përmendsh.)

   "Sepse të gjithë (hapen duart) **kanë mëkatuar** (dy gishtat e mëdhenj poshtë dhe fytyrë e trishtuar) **dhe nuk e arrijnë** (ulen poshtë) **lavdinë e Perëndisë** (ngrihen lart duke drejtuar dy gishtat tregues nga qielli)**." Romakëve 3:23**

3. Jepi secilit nxënës një tas akulloreje. Nxënësit mund të mos e hanë akulloren menjëherë. Pasi t'i kenë vënë përbërësit e tjerë sipër, mund ta hanë.
4. Drejtoji nxënësit në aktivitetin e mëposhtëm:
   a. Sfidoji të gjithë të recitojnë Romakëve 3:23 me veprime.
   b. Nëse e bëjnë me sukses, fto një nxënës të rrotullojë shigjetën e përbërësve (ose të zgjedhë një letër).
   c. Nxënësit mund ta hedhin këtë përbërës mbi akulloren e vet. (Nëse një nxënësi nuk i pëlqen, mund të thotë: "Jo, faleminderit.")
   d. Përsërite! Nëse shigjeta bie dy herë mbi të njëjtin përbërës, rrotullojeni sërish derisa të jenë marrë të gjithë përbërësit.
5. Shpërndaju nga një lugë dhe jepu kohë për ta shijuar.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Plastelinë me ngjyrë të errët (për të përfaqësuar mëkatin); (secila skuadër ka nevojë për 3-5 copa)
- Posteri me vargun nga Romakëve 3:23 (burim i printueshëm); ose shkruajeni vargun në një karton apo tabelë
- Etiketa shpërblyese
- **Me zgjedhje**: petëz (këshillë: kërkoju disa nxënësve ta përdorin petëzën për t'i dhënë plastelinës formën e shiritave të gjatë, ndërkohë që anëtarët e tjerë të skuadrës i përdorin ato shirita për të bërë format e shkronjave, në mënyrë që të formojnë vargun)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaje klasën në skuadra me katër ose pesë nxënës.
2. Jepi plastelinë secilës skuadër.
3. Sfidoji nxënësit të formojnë vargun e plotë nga Romakëve 3:23 si skuadër.
4. Skuadra e parë që formon saktë vargun do të marrë tri etiketa shpërblyese për çdo person.
5. Ndërkohë që nxënësit punojnë, bëj ndalesa të shpeshta dhe sfidoji skuadrat të recitojnë Romakëve 3:23.
6. **Me zgjedhje**: Disa minuta pas fillimit të sfidës, hiq posterat, në mënyrë që skuadrat ta formojnë vargun pa e parë diku.
7. Shpërble me tri etiketa shpërblyese çdo anëtar të skuadrës që përfundon e para formimin e vargut.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Sa mirë e njeh vargun nga Romakëve 3:23? Le ta praktikojmë edhe një herë tjetër! Kërkoju nxënësve të ngrihen dhe të recitojnë Romakëve 3:23 së bashku. Ky varg na ndihmon të kuptojmë se të gjithë kanë mëkatuar. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë, të cilat janë kundër Perëndisë. Sot do të mësojmë për mënyrën si hyri mëkati në botë, por gjithashtu do të mësojmë për planin e Perëndisë për të na shpëtuar nga mëkati.

Lutu: *Inkurajo një nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të luten në ambiente publike dhe të zhvillojnë aftësitë frymërore të udhëheqësisë. Sfidoji nxënësit të dëgjojnë dhe të luten në heshtje, bashkë me personin që po lutet. Nëse ata bien dakord me çfarë po thuhet, kërkoju të thonë "Amen" në fund.*

Zbuloje: A është Zanafilla në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (DH.V.) Le të hapim Biblën te libri i Zanafillës, kapitulli 3.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: *Kur të them tre, drejtoni gishtin te Zanafilla te Kronologjia. Shënim: Nëse e bëni këtë çdo javë, do të vëreni se nxënësit mësohen mirë me kronologjinë.* Le të rishikojmë lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës":

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Kemi mësuar se Perëndia e krijoi botën në gjashtë ditë, dhe në ditën e gjashtë Ai krijoi qeniet e para njerëzore, Adamin dhe Evën. Perëndia e vendosi Adamin dhe Evën në një shtëpi të përsosur, u dha një punë për të bërë dhe u dha një urdhërim: mos hani nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Perëndia i tha Adamit se nëse do të hante nga ajo pemë, me siguri do të vdiste. Sot do të mësojmë se si mëkati, vuajtjet dhe vdekja erdhën në botën tonë. Do të mësojmë gjithashtu më tepër mbi premtimin e Perëndisë për të dërguar Jezusin që të na shpëtonte nga mëkati dhe të na jepte fitore mbi vdekjen.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 3

Satani tundon Adamin dhe Evën

Lexo: Zanafilla 3:1
Përmbledhje: Kush ishte gjarpri për të cilin lexuam? (Satani.) Dinak do të thotë se Satani është gënjeshtar dhe ai dëshironte që të tjerët të mëkatonin. Çfarë po përpiqej të bënte Satani? (Ai dëshironte që Eva të pështjellohej për atë që Perëndia kishte thënë.)

A është Satani i vërtetë sot? (Po, por me shumë mundësi nuk do të shfaqet në formën e një gjarpri.) A dëshiron Satani që ti të pështjellohesh për atë që Perëndia thotë? (Po.) Si mund të sigurohesh që nuk je pështjelluar? (Kupto Fjalën e Perëndisë në Bibël.) Le të shohim nëse Eva u pështjellua.

Lexo: Zanafilla 3:2-3
Përmbledhje: Çfarë urdhërimi i kishte dhënë Perëndia Adamit? Më lejoni t'ua lexoj sërish.

Lexo: Zanafilla 2:16-17 *(nga mësimi i javës së kaluar)*
Përmbledhje: A kishte të drejtë Eva? A i kishte thënë Perëndia që nuk mund ta preknin frutin e pemës? (Jo, Ai kishte thënë të mos hanin nga pema.) Tani që Eva ishte pështjelluar, Satani ishte gati ta tundonte që të mos i bindej Perëndisë. Le të shohim si.

Lexo: Zanafilla 3:4-5

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Çfarë bëri Satani? (Satani gënjeu.) Ai e quajti Perëndinë gënjeshtar! A gënjen ndonjëherë Perëndia? (Jo!) Satani e mashtroi Evën. Ai donte që ajo të besonte se njohja e së mirës dhe së keqes, ishte gjë e mirë. Por çfarë donte Perëndia? (Perëndia donte që ata të njihnin vetëm të mirën.)

A përpiqet Satani të na mashtrojë edhe ne? (Po.) A dëshiron ai që ne të mendojmë se gjërat e këqija për ne janë të mira? (Po.) A përpiqet Satani të na gënjejë që të mos i bindemi Perëndisë? (Po.) Ky quhet tundim.

Kjo gjë na ndodh të gjithëve! Kur përballemi me zgjedhje, shpeshherë tundohemi të mëkatojmë, edhe pse e dimë çfarë është e drejtë. Na duhet fuqia e Jezusit për t'i thënë "Jo" mëkatit me bindje dhe për t'u larguar prej tij.

Po Eva? A e besoi Eva gënjeshtrën e Satanit? Le ta zbulojmë.

Adami dhe Eva kryejnë mëkatin e parë

Lexo: Zanafilla 3:6

Përmbledhje: A i bënë gjërat Adami dhe Eva sipas mënyrës së Perëndisë? (Jo.) Në vend që t'i bindeshin Perëndisë, ata i bënë gjërat në mënyrën e tyre. Çfarë quhet mosbindja ndaj Perëndisë? (Mëkat.)

Çfarë tha Perëndia se do të ndodhte po të mëkatonte Adami? (Perëndia tha se Adami me siguri do të vdiste.) Le të vazhdojmë të lexojmë për të parë se çfarë ndodhi.

Shënimi i mësuesit kryesor: Studiuesit kanë pyetje në lidhje me kuptimin e "burrit të saj që ishte me të". Disa përkthyes thonë "me të" dhe disa të tjerë nuk kanë asnjë formë të kësaj shprehjeje. Për shkak të kësaj pasigurie, nuk do ta trajtojmë idenë e pranisë së mundshme të Adamit. Ajo që është e qartë nga konteksti i plotë i Biblës është që si Adami, si Eva, mëkatuan.

Adami dhe Eva përpiqen të mbulojnë mëkatin e tyre dhe të fshihen nga Perëndia

Lexo: Zanafilla 3:7-10

Përmbledhje: Adami dhe Eva e dinin që nuk i ishin bindur Perëndisë. Ata ndien turp, bënë mbulesa për vete me gjethe fiku, e u fshehën nga Perëndia. A mund të fshihesh nga Perëndia në fakt? (Jo.) A mendon ndonjëherë që mëkati yt është fshehur nga Perëndia, apo ti e di se Ai sheh gjithçka që ti bën? Le të zbulojmë se çfarë tha Perëndia pasi Adami dhe Eva u fshehën.

Adami fajëson Evën

Lexo: Zanafilla 3:11-12

Përmbledhje: Çfarë bëri Adami? (Ai fajësoi Evën për mëkatin e tij.) A ishte faji i Evës që Adami mëkatoi apo ishte faji i Adamit? (Ishte faji i Adamit.)

A përpiqesh ndonjëherë të fajësosh të tjerët kur bën diçka gabim? Nuk duhet të fajësosh kurrë të tjerët! Nëse je i krishterë, çfarë duhet të bësh kur bën zgjedhjen e gabuar dhe mëkaton? (Të pranosh mëkatin tënd, ta rrëfesh para Perëndisë dhe të pendohesh – largohu nga mëkati dhe vendos të bësh çfarë është e drejtë.) Le të vazhdojmë të lexojmë.

Eva fajëson gjarprin

Lexo: Zanafilla 3:13

Përmbledhje: Eva fajësoi gjarprin, Satanin. A ishte faji i Satanit që Eva mëkatoi? (Jo!) Ishte faji i Evës.

A përpiqesh ndonjëherë të fajësosh Satanin për mëkatin tënd? Nëse je i krishterë, ti ke Frymën e Shenjtë që do të të ndihmojë të rezistosh kur Satani të tundon të mos i bindesh Perëndisë. Nuk mund të fajësosh Satanin për mëkatin tënd. Kujto! Ishte zgjedhja jote.

Perëndia jep pasojat e mëkatit dhe jep gjithashtu edhe Ungjillin

Parafrazim i Zanafillës 3:14-20

Gjarpri, Adami dhe Eva kishin vuajtur pasojat e mëkatit të tyre. Kështu hyri vuajtja dhe vdekja në botë. Këto gjëra ndodhën për shkak se Adami dhe Eva mëkatuan. Por megjithatë, Perëndia e donte Adamin dhe Evën. Ai u tha se kishte një plan që do të rregullonte situatën. Perëndia tha se një nga pasardhësit e Evës do të shtypte kokën e Satanit. Kjo do të thoshte se Perëndia do të dërgonte një Shpëtimtar, në mënyrë që t'i shpëtonte nga mëkati. Adami dhe Eva ishin njerëzit e parë që dëgjuan se Jezusi do të vinte! Jo vetëm kaq, por gjejeni pak se çfarë bëri tjetër Perëndia për Adamin dhe Evën.

Perëndia mbulon lakuriqësinë e Adamit dhe të Evës

Lexo: Zanafilla 3:21

Përmbledhje: Gjethet e fikut që përdorën Adami dhe Eva, nuk ishin mjaft të mira për t'i mbuluar, kështu që Perëndia u dha veshje të bëra nga lëkura e kafshëve.

Nxënësit më të rritur: Kjo do të thotë se një kafshë e pafajshme vdiq, në mënyrë që Adami dhe Eva të mund të kishin rrobat e duhura për t'u mbuluar. Kjo ishte hera e parë që derdhej gjak për të mbuluar një mëkat. A të kujton diçka kjo? Kujto pak vargun nga 12 vargjet kyç te Hebrenjve 9:22b: "... dhe pa

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

derdhur gjak nuk ka ndjesë.” A e mendon dot se si lidhet vdekja e kësaj kafshe të pafajshme me diçka që do të ndodhte në të ardhmen? (Jezusi derdhi gjakun e Tij të pafajshëm, që ne të mund të marrim falje.) Mbaje mend këtë, sepse do të shohim një pamje të ngjashme javën e ardhshme!

Të gjithë nxënësit: A kujton se çfarë tha Perëndia se do të ndodhte nëse Adami dhe Eva do të hanin frutin nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes? (Ata do të vdisnin.) A vdiqën ata? Le ta zbulojmë.

Vdekja vjen

Parafrazim i Zanafillës 3:22-24

Adami dhe Eva duhet të largoheshin nga kopshti i Edenit, ku kishin jetuar një jetë të përsosur me Perëndinë. Ata duhet të jetonin jashtë kopshtit, të bënin punë të rëndë dhe të vuanin në këtë botë derisa të vdisnin, duke u rikthyer në pluhur, nga kishin ardhur. Ky ishte fillimi i vuajtjes së njerëzve dhe vdekjes në botë.

Përfundimi

Pështjellimi i Adamit dhe Evës, si dhe mëkati i tyre, çuan në një botë të thyer. Ah sikur të kishin jetuar sipas mënyrës së Perëndisë dhe jo sipas mënyrës së tyre! Por kjo nuk e ndaloi planin e Perëndisë. Ai i tregoi Adamit dhe Evës për Shpëtimtarin e plotfuqishëm që do të vinte për t’i shpëtuar nga mëkati dhe për të mposhtur Satanin dhe vdekjen! Edhe pse ka vuajtje dhe vdekje në botën tonë për shkak të mëkatit, Jezusi do ta bëjë gjithçka të përsosur një ditë.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Është e lehtë të shohim Adamin dhe Evën dhe të mendojmë sesa të marrë ishin që hëngrën frutin nga pema, sidomos për faktin se kishin të gjitha pemët e tjera në kopsht! Ata nuk i besuan asaj që Perëndia iu tha dhe kjo i çoi në mëkat. Por të gjithë ne kemi të njëjtin problem. Unë kam mëkatuar dhe ti ke mëkatuar, ashtu si Adami dhe Eva. Vargu i sotëm nga *Mendo si duhet* na e tregon këtë. A mund ta recitosh? Recito Romakëve 3:23.

Mendo pak për faktin se si ti nuk i bën gjërat sipas mënyrës së Perëndisë, por sipas mënyrës tënde. Cilat janë disa nga mëkatet me të cilat përballesh? *Jepu mundësinë të japin përgjigje të ndryshme.* Mëkati na ndan nga Perëndia. Patjetër që është lajm i keq që jemi ndarë nga Perëndia i cili na bëri dhe na do, por a e kujton se çfarë i tha Perëndia Adamit dhe Evës? Ai do të dërgonte dikë për të na shpëtuar. Cili është i vetmi që mund të na shpëtojë? (Jezusi.) (Faqja e kuqe – Hebrenjve 9:22/Gjoni 14:6) Jezusi të ofron

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

dhuratën më të mirë – faljen dhe jetën e përjetshme. A e ke marrë këtë dhuratë? Nëse jo, a do të doje të mësoje më tepër për të? *Mundësi për të përsëritur Ungjillin përmes Librit pa fjalë dhe një ftesë për shpëtim.* Mund të zgjedhësh të flasësh me Jezusin sot dhe t'i tregosh se beson në Të, dhe dëshiron që Ai të jetë udhëheqësi i jetës tënde.

Për ata prej nesh që tashmë kanë besuar në Jezusin, le të lutemi në heshtje dhe të falënderojmë Perëndinë që dërgoi Jezusin si Shpëtimtarin tonë. Ndalo për një kohë të shkurtër në lutje personale dhe reflektim.

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Kush ishte gjarpri? (Satani.)
2. Çfarë bëri gjarpri? (Ai gënjeu Evën për Perëndinë.)
3. A e besoi Eva gënjeshtrën e Satanit? (Po.)
4. A mëkatuan si Adami ashtu edhe Eva, duke ngrënë nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes? (Po.)
5. Çfarë hyri në botë kur mëkatuan Adami dhe Eva? (Vuajtje dhe vdekje.)
6. Çfarë lajmi të mirë u dha Perëndia Adamit dhe Evës pasi mëkatuan? (Ai do të dërgonte një Shpëtimtar që ata të shpëtonin nga pasojat e mëkatit të tyre.)
7. Ku duhet të jetonin Adami dhe Eva pasi mëkatuan? (Jashtë kopshtit të Edenit.)
8. Cili nga 12 vargjet kyç na tregon se jemi të gjithë mëkatarë? (Romakëve 3:23.)
9. A i ke besuar Jezusit për shpëtim nga mëkati?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 4

Zanafilla 4:1-16, 4:25-26

Kupto si duhet:	Kaini mëkatoi kundër Abelit.
Mendo si duhet:	"... dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë." Hebrenjve 9:22b (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se Perëndia e urren mëkatin.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i dashur, sepse Jezusi mori ndëshkimin për mëkatin tim.

PËRGATITU!

Në botën ku jetojmë është më e thjeshtë se kurrë të besosh gënjeshtrën që thotë se çdo person duhet të bëjë atë që i duket e drejtë secilit. Por Fjala e Perëndisë është e qartë: e vetmja mënyrë për të shmangur pasojat e dhimbshme të mëkatit është të bëjmë atë që është e drejtë sipas Perëndisë. Këtë javë do të mësojmë për përhapjen e mëkatit dhe efektin tragjik që pati mbi familjen e parë. Kërkoji Perëndisë të të ndihmojë ty dhe nxënësit e tu për të parë mëkatin përmes syve të Tij, të largoheni prej tij dhe të përqafoni faljen e Tij në momentin kur rrëzoheni.

Lutu: Lutu që prindërit e nxënësve do ta bëjnë prioritet ardhjen në kishë, të mësuarit për Perëndinë dhe bërjen e bisedave frymërore. Kërkoji Perëndisë që prindërit të vënë re rritjen frymërore te fëmijët e tyre.

Lexo: Zanafilla 4:1-16; 4:25-26

Kupto si duhet: **Kalini mëkaton kundër Abelit**
Pasi Adami dhe Eva mëkatuan dhe u dëbuan nga kopshti i Edenit, Perëndia u dha një familje. Fatkeqësisht, të gjithë fëmijët lindën me natyrën mëkatare të prindërve të tyre. Djali i tyre, Kaini, u bë punues toke dhe djali tjetër, Abeli, u bë bari. Mënyra si e jetonin jetën shfaqte dallime të mëdha. Oferta e çmuar e Abelit me të parëlindurit e kopesë dhe yndyrën e tyre, tregonte se ai jetonte sipas mënyrës së Perëndisë, përmes besimit. Oferta jo e çmuar e Kainit ishin frutat e tokës dhe tregonte mënyrën si ai jetonte, pra, pa besim. Për shkak se Abeli jetonte sipas mënyrës së Perëndisë, me besim, ai u deklarua i drejtë dhe u bë pjesë e heronjve të besimit. Për shkak se Kaini jetoi pa besim, u ndëshkua për mëkatin e tij dhe duhej të endej nëpër tokë, në vend që të ishte punues i saj. Për shkak të kësaj, ne mund ta dimë me siguri se Perëndia e urren mëkatin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Përkufizimi që përdorim për mëkatin është: “Gjithçka që mendojmë, që themi apo që bëjmë, të cilat janë kundër Perëndisë.” Perëndia nuk mund të ketë lidhje me mëkatin. Ai e urren mëkatin, për shkak se na ndan nga një marrëdhënie me Të. Kur përdorim fjalën “kundër”, është e rëndësishme që toni i zërit të jetë serioz dhe nxënësit të kuptojnë se jemi kthyer kundër Perëndisë duke bërë diçka që Ai e urren kur zgjedhim të mëkatojmë.
- Nxënësit shpeshherë pyesin: “Përse lejon Perëndia që të ndodhin gjërat e këqija?” Përgjigjja gjendet në këtë mësim. E gjitha lidhet me rënien e njeriut kur mëkati hyri në botë.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Krijoni një mister vrasjeje në klasë. Vendos disa të dhëna në dysheme, krijo një skicë me shkumës apo me ngjitës. Ndërkohë që shpjegon, kërkoju nxënësve të zgjidhin misterin.
2. Përdor objekte të thjeshta për të ilustruar ndryshimet mes dy vëllezërve.
3. Vizatoje mësimin në një tabelë apo karton, ose letër të madhe. Etiketo figurat dhe shto fytyra që përputhen me emocionet.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Është mëkat!

Qëllimi: Të prezantohet dhe/ose të riforcohet përkufizimi i **mëkatit**, të kuptuarit e llojeve të ndryshme të **mëkatit** dhe besimit se **mëkati** është i gabuar.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Fletët e kopshtit të Edenit ku nxënësit mund të shtojnë hollësira të tjera (burim i printueshëm)
- Lapustilat
- Objekte argëtuese për punëdore si fletë me ngjyra, lule, lumenj dhe pemë prej letre
- Ngjitës
- Postera të bukur që mund t’i përdorin si ide (duhet të jenë me ngjyra)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Spraj me ngjyrë të zezë (për t'u përdorur te piktura shembull)
- Një aktor me kostumin e "personazhit të keq" (duhet të jetë e dukshme që është aktor, jo drejtues)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ftoji nxënësit të ngjyrosin dhe të dekorojnë pikturën e tyre të kopshtit të Edenit, bazuar në mësimin që u dha javën e kaluar.
2. Informoji se vepra e tyre e artit do të shfaqet në galerinë e artit, prandaj duhet të bëjnë më të mirën e tyre. Informoji se pastori i kishës apo një person tjetër i veçantë do të zgjedhë veprën më të mirë gjatë javës.
3. Koha për dramë: ndërkohë që nxënësit punojnë me artin e tyre shumëngjyrësh, një "personazh negativ" duhet të marrë një nga posterat shembuj (përballë të gjithëve) dhe të vizatojë një pikë të madhe të zezë në qendër duke përdorur sprajin. Pastaj vizitori duhet të pyesë nëse edhe dikush tjetër dëshiron pika të zeza në pikturë. Ti (drejtuesi i KZ-së) duhet të bërtasësh: "Stop! E shkatërrove!" Mësuesi kryesor duhet ta marrë pikturën dhe ta fshehë. Vare pikturën në një vend veçmas nga pjesa tjetër e pikturave.
4. Inkurajoi nxënësit të vazhdojnë punën dhe të bëjnë më të mirën e tyre, edhe pse boja e zezë e shkatërroi pikturën.

Shënim: Mësuesi kryesor do të bëjë lidhjen me mëkatin gjatë mësimit.

Aktiviteti 2: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Fletë të ngjitura në kuti ku shkruhet: "Fito" me gishtin e madh drejtuar lart, dhe "Mëkato" me gishtin e madh drejtuar poshtë (burim i printueshëm)
- Kuti, të mëdha ose me përmasa standarde – ngjit letrat me fjalën "Fito!" te këto kuti dhe përdori për të krijuar një bazë (ose përdor tavolina si bazë)
- Njëzet ose më shumë kuti të vogla ose standarde – ngjit fletët me fjalën "Mëkato!" te këto kuti dhe vendosi në dy ose tri rreshta mbi bazën
- Kone me ngjyra, të vendosura 3m larg kutive ku janë fjalët "**Mëkato**" (nga një për çdo skuadër; secila skuadër duhet të ketë ngjyrën e vet dalluese)
- Një objekt me të cilin do të godasin kutitë (është mirë që secila skuadër të ketë një objekt në ngjyrën e vet dhe objekti vendoset pranë konit)
- Një tabelë për të shënuar pikët
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Zgjidh një ose më tepër drejtues që të mbajnë pikët.
2. Ndaj klasën në skuadra (pothuajse pesë nxënës për çdo skuadër).

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

3. Caktoji çdo skuadre një ngjyrë (sipas koneve që keni).
4. Kërkoji nxënësve të secilës skuadër, të vendosen në radhë pas konit të tyre.
5. Sfidoji nxënësit të provojnë me radhë të godasin kutitë që kanë të shkruara fjalën **mëkato**.
6. Sa herë që rrëzohet një kuti me fjalën **mëkato**, skuadra fiton një pikë. Personat që mbajnë pikët duhet të ndihmohen edhe nga drejtuesit e tjerë.
7. Pasi ta kenë goditur kutinë me objektin e zgjedhur, nxënësit duhet të vrapojnë për ta marrë objektin dhe t'ia japin shokut të skuadrës.
8. Përsëriteni lojën në varësi të kohës që keni.
9. Skuadra me më shumë pikë në fund të Kohës së zbulimit, fiton.
10. Shpërbleji me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës fituese.

Me zgjedhje: Kërkoji nxënësve të përmendin një mëkat sa herë që godasin kutitë (për shembull: gënjeshtër, kopjim etj.)

Aktiviteti 3: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Letra apo kartonë të vegjël ku shkruhen veprime që janë mëkat, si për shembull: mosbindje ndaj prindërve, gënjeshtër, kopjim, vjedhje, thashetheme, tallje, xhelozi, krenari, përtaci, mosbesim në Perëndinë etj. (burim i printueshëm)
- Plastelinë (një ngjyrë për çdo skuadër)
- Forma shkronjash (një grup për çdo skuadër)
- Një tabelë ku të mbahen pikët
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga katër pjesëtarë.
2. Cakto një drejtues që të jetë arbitër për një ose dy skuadra.
3. Vendos format e të gjitha shkronjave përballë çdo skuadre.
4. Sfidoji skuadrat të punojnë së bashku dhe të garojnë me njëra-tjetrën për të formuar me plastelinë fjalën që ti do t'u tregosh. Para se ta formojnë fjalën, skuadrat duhet ta përgatisin plastelinën, pra, ta hapin dhe ta bëjnë gati për format pasi ti të thuash: "Nisu!"
5. Pasi të formojnë fjalën, duhet t'ia tregojnë arbitrit. Pasi arbitri të konfirmojë se e kanë formuar saktë fjalën, do të marrin dy pikë.
6. Pastaj arbitri do të thotë: "Shkatërrojeni!"
7. Të gjitha skuadrat do ta shkatërrojnë fjalën që përfaqëson mëkatin, por skuadra e parë që e shkatërron do të fitojë tre pikë!
8. Filloni garën.
9. Përsëriteni me fjalë të tjera që përfaqësojnë mëkatin.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

10. Shpërble me pesë etiketa shpërblyese anëtarët e skuadrës fituese.

Aktiviteti 4: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit gjendet në dosjen e kurikulës së vitit të 1-rë, të tremujorit të 1-rë.*

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Çfarë është mëkati? (Gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë, të cilat janë kundër Perëndisë.) Si të bën të ndihesh mëkati? *Lejoji nxënësit të përgjigjen.* Përse e urren Perëndia mëkatin? *Lejoji nxënësit të përgjigjen shkurtimisht.* Perëndia na do dhe dëshiron që ne të jemi me Të, por mëkati ynë na ndan nga Ai, për shkak se Perëndia është i shenjtë. Mëkati gjithashtu shkakton vuajtje në botën ku jetojmë dhe në jetën tonë.

Stacioni i artit: Në aktivitetin e KZ-së bëtë një poster për kopshtin e Edenit. Si u ndiet kur dikush hodhi bojë të zezë mbi pikturë? A u shkatërrua piktura? Si ju bëri të ndiheni? Mëkati sjell dhimbje dhe lëndim.

Stacioni i plastelinës: A ishte argëtuese të shkatërroje mëkatin gjatë aktivitetit të KZ-së? Perëndia dëshiron ta bëjë këtë në jetën tënde! Ai dëshiron që ti t'i besosh Jezusit për faljen e mëkatit dhe pastaj t'i kërkosh Atij ndihmë që të largohesh gjithnjë nga mëkati! Përse? Sepse Ai të krijoi, Ai e di çfarë është më e mira për ty dhe Ai të do.

Të gjithë nxënësit: Në mësimin tonë nga Bibla, do të shohim sesa shumë e urren Perëndia mëkatin.

Shënim: Nëse KZ-në e zhvilluat në stacionin e misionit, ju lutem theksoni se për shkak të mëkatit ka gjëra të trishtueshme dhe të vështira në këtë botë. Misionarët shkojnë te njerëzit e lënduar dhe të thyer për t'i ndihmuar dhe për t'u dhënë shpresën e gëzimin e Jezusit.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Inkurajoje të lutet me zë të lartë që ta dëgjojë e gjithë klasa.*

Zbuloje: A është Zanafilla në DH.V. apo në DH.R.? (DH.V.) Le t'i hapim Biblat te libri i parë, Zanafilla, dhe të gjejmë kapitullin 4. *Nxënësit e rinj mund të kenë nevojë për ndihmë.*

Kronologjia: Ku gjendet Zanafilla në kronologjinë tonë? *Rishikoni pamjet që lidhen me lëvizjet e duarve dhe mësimet që kemi marrë.* Le të rishikojmë lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës".

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam se si Adami dhe Eva kryen mëkatin e parë. Cili ishte mëkati i tyre? (Ata nuk iu bindën Perëndisë dhe hëngrën nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes.) Për shkak të mëkatit të tyre, dy gjëra hynë në botë: vuajtja dhe vdekja. Pra, nëse e pyet ndonjëherë veten se përse ndodhin gjërat e këqija në botë, mund të kujtosh që janë për shkak të mëkatit. Çfarë lajmi të mirë i dha Perëndia Adamit dhe Evës pasi mëkatuan? (Ai do të dërgonte një Shpëtimtar që t'i shpëtonte nga pasoja e mëkatit të tyre.) Kjo nënkuptonte se Shpëtimtari do të lindte një ditë. Ku jetuan Adami dhe Eva pasi mëkatuan? (Jashtë kopshtit të Edenit.) Sot do të mësojmë se çfarë ndodhi me Adamin dhe Evën pasi u larguan nga kopshti i Edenit. A jeni gati?

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 4:1-16; 4:25-26

Adami dhe Eva lindin fëmijë

Parafrazim i Zanafilla 4:1-2a:

Adami dhe Eva lindin fëmijën e parë dhe e quajnë Kain dhe pastaj fëmijën e dytë, të cilin e quajnë Abel.

Kaini dhe Abeli punojnë

Lexo: Zanafilla 4:2b

Përmbledhje: Diçka shumë të rëndësishme që duhet të kujtojmë është që Abeli ishte bari, pra ai kujdesej dhe ruante delet. Kaini ishte punues toke, ai mbillte dhe korrte bimë që prodhonin ushqim. Një shprehje për të kujtuar punën e Kainit është: "Kaini rriste grurin". Tani gjërat do bëhen interesante.

Kaini dhe Abeli sjellin oferta për Perëndinë

Lexo: Zanafilla 4:3-5

Përmbledhje: Përse mendoni se Kaini dhe Abeli po sillnin oferta për Perëndinë? (Ishte një mënyrë për të treguar se ata besonin në të vetmin Perëndi të vërtetë.)

Cila ishte oferta e Kainit për Perëndinë? (Disa nga të korrat që kishte mbjellë.) Cila ishte oferta e Abelit? (Të parëlindurit e kopesë së tij dhe yndyra e tyre.) Cila të duket si oferta më e mirë? (Oferta e Abelit.) Yndyra e të parëlindurve të kopesë ishte gjëja më e mirë që dikush mund të jepte. Perëndia ishte i kënaqur me Abelin dhe ofertën e tij, por nuk ishte i kënaqur me Kainin dhe ofertën që ai i dha. Përse? Cili ishte ndryshimi? Bibla na e jep një arsye.

Abeli i dha Perëndisë të parëlindurit dhe më të mirën e kopesë së tij, sepse kishte besim në Perëndinë. Perëndisë i pëlqen kur ne kemi besim në Të dhe i

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

japim Atij më të mirën tonë. Kaini nuk i dha Perëndisë të parën dhe më të mirën e të korrave, sepse nuk besonte në Perëndinë. (*Romakëve 14:23; Hebrenjve 11:4 dhe 6; 1 e Gjonit 3:12; Juda 11*)

Ja disa pyetje për ju:
Çfarë është besimi? Hebrenjve 11:1 na thotë: "Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen." Kjo do të thotë se ne i besojmë Perëndisë për gjithçka, edhe pse nuk e shohim me sytë tanë. Ne mund të shohim çfarë bën Ai dhe çfarë krijoi, por nuk mund ta shohim apo ta prekim Atë.

A mendon se je më tepër si Kaini apo si Abeli? A ke besim në Perëndinë dhe a ia beson gjithçka Atij? *Lejoji nxënësit të mendohen për një moment.*

Si u ndie Kaini kur Perëndia nuk e pëlqeu ofertën e tij? (I zemëruar.) *Referojuni posterit "Ndihu si duhet".* Le të dëgjojmë se çfarë i tha Perëndia Kainit!

Perëndia paralajmëron Kainin

Lexo: Zanafilla 4:6-7

Përmbledhje: Perëndia i tha Kainit se ai nuk bëri atë që ishte e drejtë. Është e qartë se Kaini kishte mëkatuar. Perëndia nuk donte që Kaini të vazhdonte të mëkatonte, prandaj e paralajmëroi të mos e lejonte mëkatin ta kontrollonte.

A mendon se Perëndia po i jepte Kainit një mundësi për të pranuar mëkatin e tij, për t'ia treguar Perëndisë dhe për tu penduar për të? (Po.) Çfarë kemi mësuar të bëjmë kur mëkatojmë? (Ta pranojmë mëkatin tonë, t'ia tregojmë Perëndisë dhe të pendohemi – të kthehemi dhe të bëjmë atë që është e drejtë) Kur ti mëkaton, a e pranon mëkatin, ia tregon Perëndisë dhe pendohesh? Shpresoj që po! A mendon se Kaini e bëri këtë gjë? Le të shohim.

Kaini vret Abelin

Lexo: Zanafilla 4:8-9

Përmbledhje: Çfarë??? Si mund të ndodhte kjo? Jemi thjesht në kapitullin e katërt të Biblës dhe ndodh një vrasje. Ky është një mëkat i madh, i tmerrshëm dhe shumë i keq, apo jo? Referoju KZ-së. Perëndia sapo e kishte paralajmëruar Kainin se mëkati donte ta kontrollonte. A u bë i vërtetë ky paralajmërim? (Po.) Kur nuk beson vërtet në Perëndinë dhe nuk ke besuar në Jezusin, mëkate si zemërimi, xhelozia apo egoizmi, mund të kontrollojnë jetën tënde.

Perëndia i bëri Kainit një pyetje edhe pse e dinte përgjigjen. Ai e pyeti: "Ku është vëllai yt?" Përse duhet ta bënte Perëndia këtë pyetje? (Për t'i dhënë atij

një mundësi për tu rrëfyer.) A tha Kaini të vërtetën apo gënjeu kur i tha Perëndisë se nuk e dinte ku ishte Abeli? (Ai gënjeu.)

Kaini duhet ta kishte pranuar mëkatin e tij, t'ia tregonte Perëndisë dhe të pendohej pasi të jepte ofertën. Por në vend të kësaj, ai vrau vëllain e vet! Po pastaj, a e pranoi Kaini mëkatin e tij, a ia tregoi Perëndisë dhe a u pendua që kishte vrarë vëllain e tij, Abelin? (Jo.) Kaini vazhdon të kontrollohet nga mëkati i tij! Çfarë mendon se do të ndodhë me Kainin? Le të lexojmë e të shohim.

Perëndia mallkon Kainin

Lexo: Zanafilla 4:10-14

Përmbledhje: Tashmë Kaini ishte i mallkuar! Ai nuk mund të ishte më punues toke. Tani do të endej nëpër tokë! Por mendo pak për këtë. A mendon se Kainit i vinte keq sepse kishte vrarë Abelin, apo thjesht i vinte keq sepse po ndëshkohej? (Atij i vinte keq sepse po ndëshkohej.) Po ti, a je ndonjëherë kështu? Kur mëkaton, a ndihesh vërtet keq për mëkatin apo thjesht të vjen keq sepse zbulohesh dhe ndëshkohesh? Perëndia është i mirë me ne, edhe kur ne nuk e meritojmë. Ky quhet hir. Le të shohim se çfarë bëri Perëndia kur Kaini kishte frikë se mos dikush e gjente dhe e vriste.

Perëndia mbron Kainin

Lexo: Zanafilla 4:15-16

Përmbledhje: Çfarë bëri Perëndia për Kainin? (Ai i vendosi një shenjë, në mënyrë që askush të mos e vriste.) Ai e bëri këtë edhe pse Kaini nuk e meritonte mbrojtjen e Perëndisë. Tani mendo për Adamin dhe Evën. Çfarë ndodhi me birin e tyre Abelin? (Kaini e vrau.) Çfarë ndodhi me Kainin? (Ai duhej të endej nëpër tokë, në vend që të ishte punues i saj.) Pra, tani Kaini dhe Abeli nuk ishin më. Le të shohim se çfarë bëri tjetër Perëndia.

Perëndia i jep Adamit dhe Evës një bir tjetër

Lexo: Zanafilla 4:25-26

Përmbledhje: Perëndia i jep Adamit dhe Evës një bir tjetër të quajtur Seth. Në atë kohë, njeriu filloi të thërriste emrin e Zotit. Kjo do të thotë se kishin besim në Perëndinë. A e gjen dot se kush do të vinte një ditë nga familja e Sethit? (Jezusi!) Le të mendojmë për çfarë mësuam.

Përfundimi

Kaini nuk i dha Perëndisë fitimin e parë dhe më të mirin, sepse nuk kishte besim në Perëndinë. Por Abeli i dha Perëndisë fitimin e parë dhe më të mirin, sepse kishte besim në Perëndisë. Kaini mund ta kishte pranuar mëkatin e tij, t'ia tregonte Perëndisë dhe të pendohej për të, por nuk e bëri. Në vend të kësaj, ai vrau vëllain e tij të pafajshëm, Abelin. A e sheh se çfarë ndodh kur mëkatojmë? Është e tmerrshme! Prandaj Perëndia

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

e urren mëkatin tonë dhe prandaj ka ndëshkim për të. Cila është e vetmja mënyrë për të pasur liri nga ndëshkimi për mëkatin tonë? (Duke besuar në atë që Jezusi bëri për ne në kryq.) Cili varg na tregon se Jezusi duhej të vdiste, në mënyrë që ne të merrnim falje? (Hebrenjve 9:22b.) Jezusi duhej të derdhte gjakun e Tij për mëkatet tona. Ai mori ndëshkimin për ne.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Secili prej nesh ka mëkatuar (*faqja e errët*). Mund të mos kemi vrarë njeri, por ndoshta kemi gënjyer, nuk u jemi bindur prindërve apo kemi parë diçka të keqe. Këto janë mëkate që na ndajnë nga Perëndia. Edhe pse Perëndia e urren mëkatin tonë, Ai na do kaq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë, duke derdhur gjakun e Tij në kryq (*faqja e kuqe*). Kur ke besim në Jezusin për faljen e mëkateve dhe e bën Atë udhëheqësin e jetës tënde, Perëndia të fal të gjitha mëkatet që Ai urren (*faqja e bardhë*). Për shkak të kësaj, mund të ndihesh vërtet i dashur nga Perëndia. Le të sigurohemi që e ke kuptuar vërtet. *Tregoje Ungjillin përmes Librit pa fjalë dhe bëj ftesë për shpëtim. Kalo pak kohë në heshtje. Lejoji nxënësit të luten në heshtje dhe të rrëfejnë mëkatet e tyre, ose inkurajoji ata që nuk janë të shpëtuar, të flasin me Perëndinë për herë të parë dhe të kërkojnë falje.*

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Cilët ishin dy fëmijët e parë të Adamit dhe Evës? (Kaini dhe Abeli.)
2. Çfarë pune bënin Kaini dhe Abeli? (Kaini punonte tokën, Abeli ishte bari.)
3. Çfarë ofertash i bënë Perëndisë Kaini dhe Abeli? (Kaini i dha disa nga të korrat dhe Abeli i dha të parëlindurit e kopesë dhe yndyrën e tyre.)
4. Cila ofertë i pëlqeu Perëndisë? (Oferta e Abelit.)
5. Përse i pëlqeu Perëndisë oferta e Abelit? (Abeli dha ofertën e parë dhe më të mirën, sepse besonte në Perëndinë.)
6. Përse nuk i pëlqeu Perëndisë oferta e Kainit? (Kaini nuk i dha të parën dhe më të mirën, sepse nuk kishte besim në Perëndinë.)
7. Çfarë është besimi? (Të besosh edhe kur nuk shikon. – Hebrenjve 11:1)
8. Si u ndie Kaini kur Perëndia nuk u kënaq me ofertën e tij? (I zemëruar.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

9. Çfarë bëri Kaini pasi u zemërua? (Ai vrau Abelin.)
10. Çfarë i dha Perëndia Adamit dhe Evës pasi humbën Kainin dhe Abelin ? (Një bir tjetër të quajtur Seth.)
11. Kush do të vinte më pas nga familja e Sethit? (Jezusi.)
12. A ke besim në Perëndinë? A ke besuar në Jezusin për faljen e mëkateve?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 5

Zanafilla 6:5-22

Kupto si duhet:	Noeu ndërton një arkë.
Mendo si duhet:	"Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme." Gjoni 3:16 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj se vetëm Jezusi mund të më shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit tim.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i shqetësuar, për shkak se njerëzit që nuk besojnë në Jezusin, do të ndëshkohen.

PËRGATITU!

"Shpëtuar" është një fjalë që përdoret shpesh në ambientet e kishës, por le të marrim një moment për të reflektuar se nga çfarë kemi shpëtuar: nga ndëshkimi i përjetshëm. Kur marrim kohë të kuptojmë se nga sa shumë na ka shpëtuar Perëndia, adhurimi ynë forcohet, veprimet tona do të reflektojnë Jezusin me çdo kusht dhe shpresa që kemi në Të do të shkëlqejë. Le të kalojmë kohë duke reflektuar rreth kësaj, teksa përgatitemi për të shërbyer, duke dhënë më të mirën tonë për Të, në shenjë mirënjohjeje për gjithçka që Ai ka bërë për ne.

Lutu: Lavdëroje Perëndinë, sepse Ai ka krijuar në mënyrë unike secilin prej nxënësve në klasën tënde. Lutu specifikisht që nxënësit e pashpëtuar do të duan një marrëdhënie personale me Jezu Krishtin, dhe që nxënësit e shpëtuar do ta kuptojnë më plotësisht se nga çfarë kanë shpëtuar.

Lexo: Zanafilla 6:5-22

Kupto si duhet: Noeu ndërton arkën
Familja e Adamit dhe Evës vazhdoi të rritej, dhe kështu patën një pasardhës të quajtur Noe. Në kohën e Noeut, Perëndia pa botën dhe lëngoi për shkak të ligësisë së madhe që pa. Fatmirësisht, Ai pa gjithashtu që Noeu besonte në Të, prandaj Ai ia shfaqi planin e Tij atij – një plan për të shkatërruar botën përmes një përmbytjeje. Perëndia i tha Noeut të ndërtonte një arkë që do të shpëtonte familjen e tij dhe dy nga çdo krijesë e gjallë. Noeu u bind dhe ndërtoi arkën – që ishte e vetmja mënyrë shpëtimi për të dhe familjen e tij. Arka është një shembull i mënyrës se si Jezusi mund të na shpëtojë nga ndëshkimi për mëkatin tonë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Ky mësim shpesh jepet si një mësim i lezetshëm nga Bibla, por në të vërtetë është një mësim serioz, me kuptim shumë të thellë: Perëndia shpëton njerëzit. Lutu dhe kërkoji Perëndisë të prekë zemrat e nxënësve në shërbesën tënde.
- Si i shpëtonte Perëndia njerëzit në Dhiatën e Vjetër? Ka qenë gjithmonë përmes besimit. Njerëzit e Dhiatës së Vjetër mezi prisnin Mesian dhe besonin se Ai do të vinte. Ne shohim të shkuarën dhe kemi besim në atë që Ai bëri në kryq.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Kjo është një ditë shumë e mirë për të përdorur objekte gjatë shpjegimit të mësimit. Për shembull, mund të përdorësh një model të arkës, ose versione miniaturë të njerëzve dhe kafshëve.
2. Formo një arkë me karton dhe bëj një derë në të. Printo figura kafshësh e njerëzish dhe priji.
3. Përdor mjete si: çekiç, gozhdë, dry, sharrë, për të treguar punën që duhet të bënte Noeu për të ndërtuar arkën.
4. Krijo përmbytje në një akuarium. Bëj gati skenën dhe në kohën e duhur, hidh ujë për të treguar shiun që mbush akuariumin.
5. **Nxënësit më të rritur**: Bëj një pyetësor të shpejtë për të zbuluar se sa shumë dinë nxënësit për Noeun dhe ndërtimin e arkës. Sigurohu të jetë pak i vështirë, në mënyrë që nxënësit ta çmojnë mësimin. Përfshi pikat nga *Kupto si duhet, Mendo si duhet, Vepro si duhet* dhe *Ndihu si duhet*, duke krijuar një ushtrim për plotësimin e hapësirave bosh. Jepu mundësinë që gjatë mësimit të korrigjojnë gabimet që mund të kenë bërë, në mënyrë që, deri në fund të mësimit ta kenë plotësuar 100% saktë.
6. Për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se si toka u mbush me njerëz, përdor një tabelë apo materiale të tjera krijuese, për të ilustruar një pemë familjeje në rritje, me figura që përfaqësojnë njerëzit. Përdor gjithashtu kronologjinë e Biblës për të treguar se kur filloi të ndodhte mbushja e tokës.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Koha e zbulimit: Çfarë shpëtimi!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të kuptojnë përmasën e punës që Perëndia i dha Noeut dhe gjithashtu t'i prezantojmë me konceptin e të qenët **të shpëtuar**.

Aktiviteti 1: Hapësirë e madhe jashtë (ose brenda nëse nuk keni hapësirë apo moti nuk është i mirë)

Mjetet:

- Shkumës për të vizatuar në tokë (për të vizatuar arkën)
- Një fushë e madhe apo hapësirë bosh brenda
- Një vullnetar që do të vizatojë arkën (arka supozohet të jetë në përmasat 450x75)
- Pika të kuqe që ngjiten
- Etiketa shpërblyese (nga dy për nxënës)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ji drejtuesi i lojës krijuese "Ndiq drejtuesin" dhe drejtoje klasën që të ecë vetëm në vijat e arkës së vizatuar. Sigurohuni të qëndroni vetëm brenda vijës dhe mos e përmend Noeun apo arkën.
2. Inkurajoji nxënësit të përqendrohen dhe të qëndrojnë brenda vizës. Nëse qëndrojnë brenda vizës do të fitojë secili nga dy etiketa shpërblyese.
3. Tregoji nxënësve që, nëse bien jashtë vizës, një "peshkaqen" do t'i hajë! Nëse Bariu dhe/ose mësuesi sheh që njëri prej nxënësve del nga viza, do t'i ngjisin një pikë të kuqe.
4. Kur ta kenë përfunduar ecjen rreth të gjithë vizatimit, kërkoji nxënësve të hamendësojnë se çfarë mund të jetë diçka aq e madhe sa vizatimi që përshkruan.
5. Jepi secilit nxënës që nuk doli nga viza dy etiketa shpërblyese.
6. Për ata që dolën nga viza dhe kanë pikën e kuqe, lajmëro se do t'i mbledhësh pikat dhe do t'i **shpëtosh**. Nëse do të t'i japin dy pikat e kuqe – pra, dikujt që nuk doli nga viza – jepu nga dy etiketa shpërblyese.

Aktiviteti 2: Stacioni i misionit – *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës së vitit të 1-rë, tremujori i 1-rë*

Aktiviteti 3: Hapësirë e madhe jashtë ose Stacioni i artit

Mjetet:

- Kone dhe/ose spraj (nëse merrni spraj, sigurohuni që të jetë nga ai që nuk lë shenjë)
- Metër

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit të punojnë së bashku si skuadër për të matur përmasat e arkës dhe për ta formuar me konet ose me spraj. Dimensionet e arkës 450 x 75 x 45 (3-katëshe).
2. Kërkoju nxënësve të përdorin metrin për të matur gjatësinë dhe gjerësinë.
3. Pasi të bëhen matjet dhe shenjat, pyeti nxënësit se përse mendojnë se arka ishte kaq e rëndësishme. Përgjigjja e tyre duhet të jetë që, ishte mënyra e vetme për të shpëtuar njerëzit dhe kafshët gjatë përmbytjes.

Me zgjedhje për aktivitet brenda: Nxënësit mund të formojnë arkën duke përdorur mjete si kartonë, fletë etj. (përmasat e zvogëluara do të ishin 22.5 x 3.75 x 2.25)

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin:
Hapësira e madhe: Kush të shpëtoi gjatë Kohës së zbulimit? Dikush u ofrua të të shpëtonte nga diçka e keqe. Si lidhet kjo me Noeun dhe arkën e tij, dhe përse mendon se duhet ta marrim këtë mësim sot? Dhe çfarë do Perëndia që ne të mësojmë prej tij? Shpresoj që do ta kuptoni deri të fund të mësimit!

Stacioni i Artit ose hapësira jashtë: Përse mendon se Perëndia dha udhëzime kaq të qarta për ndërtimin e arkës? Përse mendon se ishte kaq e rëndësishme që Noeu të bënte gjithçka sipas mënyrës së Perëndisë? Çfarë do të ndodhte nëse ai do të ndryshonte diçka? Sot do të mësojmë për një njeri që ishte i drejtë, edhe për në një botë ku pothuajse çdokush tjetër e kishte refuzuar Perëndinë.

Shënim: Nëse KZ-në e zhvilluat në Stacionin e misionit, ju lutem bëni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Lutu*: Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të luten në publik dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre frymërore drejtuese.*

Zbuloje: Ku e gjejmë Zanafillën, në Dhiatën e Vjetër apo të Re? (DH.V.) Le të shohim Zanafillën, kapitulli 6. Nëse po mëson të gjesh vargjet në Biblën tënde, kërko numrin e madh gjashtë në librin e parë të Biblës, Zanafilla.

Kronologjia: *Drejto gishtin te kronologjia dhe rishiko atë që nxënësit kanë mësuar gjatë këtij tremujori, gjithashtu përsërisni lëvizjet e mësuara të: Flasim rreth Zanafillës.*

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të mendojmë pak rreth njerëzve për të cilët kemi mësuar gjatë javëve të fundit. Dy njerëzit e parë që Perëndia krijoi ishin Adami dhe Eva. Perëndia i vendosi ata në kopshtin e Edenit, ku gjithçka ishte e përsosur, por pastaj Adami dhe Eva mëkatuan dhe duhej të largoheshin. Perëndia e ndihmoi Adamin dhe Evën, dhe ata lindën dy djemtë e parë, Kainin dhe Abelin, por Kaini e vrau Abelin dhe si dënim, u end nëpër tokë, në vend që ta punonte atë. Kaini u martua me gruan e tij dhe ata filluan të kishin fëmijë. Perëndia i dha Adamit dhe Evës birin e tretë, Sethin, që do të zinte vendin e Abelit. Sethi u rrit, u martua me gruan e tij, dhe pati fëmijët e vet, dhe fëmijët patën fëmijët e tyre. Kjo gjë vazhdoi të ndodhte për disa mijëra vite, derisa një ditë, lindi një njeri i quajtur Noe. Kur Noeu ishte 500 vjeç – njerëzit jetonin shumë gjatë atëherë – ai kishte tre djem. Tashmë kishte shumë njerëz në tokë. Dhe kishte telashe!

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 6:5-22

Mëkati i njerëzve trishton shumë Perëndinë

Lexo: Zanafilla 6:5-6

Përmbledhje: Në fakt, sa më shumë shtoheshin njerëzit, aq më shumë shtohej mëkati. Ai u përhap si një virus, dhe shumë njerëzve u pëlqente ta jetonin jetën siç u pëlqente atyre, jo siç i pëlqente Perëndisë – edhe nëse kjo lëndonte njerëz të tjerë. Na thuhet që Perëndia u brengos. Kjo do të thotë se Ai ishte shumë i trishtuar dhe i zemëruar. Përse mendon se Perëndia ishte aq i trishtuar dhe i zemëruar kur pa gjithë këtë? *Lejo disa nga nxënësit të përgjigjen.* Perëndia ishte i trishtuar dhe i zemëruar sepse Ai i krijoi njerëzit që t'i sillnin lavdi Atij dhe të jetonin me Të. Por njerëzit, me mëkatin e tyre, po e kthenin botën – të cilën Ai e krijoi – në një rrëmujë të madhe!

Nxënësit më të rritur: Çfarë na mësojnë këto vargje për Perëndinë? Si mendon se ndihet Perëndia kur ne mëkatojmë? Si mendon se ndihet Ai për gjërat e tmerrshme që gjenden në internet? Apo kur njerëzit keqtrajtojnë të tjerët, për shkak se janë ndryshe? Mëkati ynë e trishton dhe e zemëron Perëndinë, me të drejtë, sepse ato mëkate sjellin vuajtje dhe ndonjëherë edhe vdekje, dhe na ndajnë prej Tij. Por kujto, Perëndia e ka pasur gjithmonë një plan. Le të shohim hapin tjetër në planin e Tij.

Perëndia planifikon të shkatërrojë gjithçka që jeton

Lexo: Zanafilla 6:7

Përmbledhje: Uau! Plani i Perëndisë ishte të shkatërronte gjithçka që jetonte! A nuk duket e tmerrshme kjo? Por, e dini çfarë? Kishte ende shpresë! Dëgjoni këto vargje.

Noeu nderonte Perëndinë

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo: Zanafilla 6:8-10

Përmbledhje: Noeu ishte njeri i drejtë. Çfarë do të thotë fjala "i drejtë"? (Një person i drejtësuar para Perëndisë.) A do të thotë kjo se Noeu ishte i përsosur? (Jo.) A e kujton ndonjëri se çfarë thotë Romakëve 3:23? ("Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë".) Noeu ishte mëkatar gjithashtu. Pra, çfarë do të thotë fjala "i drejtë"? Do të thotë se Noeu nuk duhej të merrte fajin për mëkatin e tij. Pse? Sepse ai kishte besim në Perëndinë dhe në Shpëtimtarin që Perëndia do të dërgonte një ditë. Shikoni në Dhiatën e Vjetër, njerëzit atje besonin se Shpëtimtari do të vinte një ditë. Sot ne shohim pas dhe besojmë në Shpëtimtarin që erdhi! Ndërsa shpjegon këtë gjë, vizato një diagram në tabelë me kryqin në mes. *Shkruaj "Noeu" në të majtë dhe vizato një shigjetë që çon te kryqi në mes, pastaj shkruaj "Ti" në të djathtë dhe vizato një shigjetë që çon te kryqi në mes.* Perëndia e shpëtoi Noeun, sepse ai kishte besim në Shpëtimarin që do të vinte në të ardhmen! Kush është ai Shpëtimtar? (Jezusi.) Kjo është një pikë e rëndësishme që do të përsëritet në mësimin e javës së ardhshme.

Kujto se Noeu nuk ishte vetëm. Ai kishte një grua dhe tre djem të quajtur Sem, Kam dhe Jafet, dhe ata kishin gratë e tyre. Le të dëgjojmë se çfarë i tha Perëndia Noeut.

Perëndia i thotë Noeut të ndërtojë një arkë

Lexo: Zanafilla 6:11-16

Përmbledhje: Arka do të ishte gjigante! Ndërtimi i saj do të ishte një punë e vështirë dhe do të kërkonte shumë, shumë kohë.

Çfarë do të mendoje ti po të ishe në vendin e Noeut? *Kërkoju nxënësve të ndajnë mendimin e tyre.* Çfarë të kërkon Perëndia të bësh? A të ka kërkuar Perëndia të bësh diçka aq të vështirë sa ndërtimi i një arke gjigante? Nëse je i krishterë e i ke besuar Jezusit që të të shpëtojë nga mëkati dhe e ke bërë udhëheqësin e jetës tënde, Perëndia është gjithmonë me ty për të të ndihmuar të bësh çfarëdolloj gjëje që Ai dëshiron që ti të bësh. Por si? Perëndia të jep Frymën e Shenjtë për të të ndihmuar. Kush është Fryma e Shenjtë? Ai është Personi i Perëndisë që vjen të jetojë brenda atyre që besojnë në Jezusin. Ai është Ndihmuesi yt, prandaj, pavarësisht se çfarë të kërkon Perëndia të bësh, Ai do të të ndihmojë dhe ti do të mund ta arrish, edhe nëse është e vështirë. A nuk është fantastike kjo?

Noeu duhet të bënte një zgjedhje. Ai mund t'i besonte Perëndisë dhe t'i bindej Atij ose jo. Dëgjo se çfarë tha tjetër Perëndia.

Perëndia i jep Noeut planin e Tij

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo: Zanafilla 6:17-21

Përmbledhje: Imagjino se sa ligësi kishin dhe në sa mëkat duhet të kenë qenë njerëzit që Perëndia ta bënte këtë gjë. Perëndia do të shpëtonte Noeun, familjen e tij dhe dy nga çdo lloj kafshe dhe zogjsh, por çdokush dhe gjithçka tjetër do të ndëshkohej për mëkatin dhe do të vdiste. Por, çfarë duhet të bënte Noeu? (Ai duhet t'i bindej Perëndisë.) Me shumë mundësi e di se çfarë zgjedhje bëri Noeu, por le ta lexojmë nga Bibla.

Noeu i bindet Perëndisë

Lexo: Zanafilla 6:22

Përmbledhje: A nuk je mirënjohës që Noeu iu bind Perëndisë? Nuk e dimë ekzaktësisht se sa kohë iu desh Noeut për të ndërtuar arkën, por me shumë mundësi iu deshën rreth 100 vite. Është kohë e gjatë, apo jo? Çfarë mendon se bëri pjesa tjetër e njerëzve ndërsa Noeu ndërtonte arkën? A mendon se ata mund të jenë tallur me të dhe silleshin keq? Ndoshta i kanë vënë edhe pseudonime të ndryshme. Mendoje pak – të gjithë ata njerëz do të vdisnin dhe Noeu e dinte.

Përfundimi

A mendon se Noeu u shqetësua për njerëzit që do të ndëshkoheshin për mëkatin e tyre? A mendon se ai u përpoq t'i paralajmëronte gjatë kohës që po ndërtonte arkën, në mënyrë që ata të shpëtonin? (Me shumë mundësi po.) Pjetri thotë se Noeu ishte predikues i drejtësisë (2 e Pjetrit 2:5). Çfarëdo t'u ketë thënë Noeu, njerëzit e ligj nuk e dëgjuan kurrë e as nuk u kthyen për nga Perëndia. Bibla na thotë se ata vazhduan të jetonin në mëkat siç kishin bërë gjithmonë, dhe për shkak të kësaj, u ndëshkuan për mëkatin e tyre. Është shumë, shumë e trishtë. Kur të kthehemi javën e ardhshme, do të zbulojmë se çfarë ndodhi kur arka përfundoi.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Po ti? Nga çfarë duhet të shpëtosh? (Nga ndëshkimi për mëkatin tënd.) Cili është i vetmi që mund të të shpëtojë nga ndëshkimi i mëkatit? (Jezusi.) Çfarë duhet të bësh që të shpëtohesh? (Të pranosh që ke mëkatuar, të besosh vetëm në Jezusin për të shpëtuar nga mëkati dhe ta bësh Atë udhëheqësin e jetës sate.) A e ke bërë këtë? Nëse e ke bërë, atëherë je si Noeu, i shpëtuar. Le ta themi Gjonin 3:16 së bashku. Recitojeni atë. Çfarë na premton ky varg nëse besojmë në Të? (Që do të kemi jetën e përjetshme.)

Po të tjerët? Çfarë do të ndodhë me njerëzit që nuk besojnë te Jezusi? (Ata do të ndahen nga Perëndia dhe do të ndëshkohen për mëkatin e tyre përgjithmonë.) A duhet të ndihesh i shqetësuar për njerëzit që nuk besojnë në Jezusin? A duhet t'u tregosh Lajmin e Mirë dhe të lutesh për ta? (Patjetër!) Këtë u kërkon Perëndia të krishterëve.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ne duhet t'i ndihmojmë të tjerët të kuptojnë sesa shumë i do Perëndia, që ata të shpëtojnë nga ndëshkimi për mëkatin e tyre. Mendo për një person që ka nevojë të mësojë për Jezusin. Le të ndalojmë pak dhe të lutemi në heshtje për atë person tani, duke i kërkuar Perëndisë të të japë një mundësi për t'i treguar atij personi që Jezusi e do dhe për t'i treguar se si mund të shpëtojë nga mëkati.

Nëse nuk ke besuar kurrë në Jezusin për shpëtim nga mëkati, a do të doje ta bëje sot? Ne mund të të tregojmë si, ndërkohë që pjesa tjetër e nxënësve luajnë lojën e përsëritjes. *Mundësi për të shpallur Ungjillin përmes Librit pa fjalë, sidomos me nxënës që do të donin ta kuptonin më mirë Ungjillin dhe ndoshta të marrin një vendim për t'i besuar Krishtit.*

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë e trishtoi aq shumë Perëndinë gjatë kohës së Noeut në tokë? (Njerëzit ishin bërë shumë mëkatarë.)
2. Çfarë kishte në plan të bënte Perëndia? Përse? (Të shkatërronte këdo dhe gjithçka që jetonte, për shkak të mëkatit.)
3. A e nderonte dikush Perëndinë? Përse po ose jo? (Noeu e nderonte Perëndinë, sepse besonte në Të.)
4. Çfarë i kërkoi Perëndia Noeut të bënte? (Të ndërtonte një arkë gjigante për veten, familjen dhe për të paktën dy nga çdo krijesë e gjallë, që të shpëtonin nga përmbytja.)
5. Çfarë i tha tjetër Perëndia Noeut? (Ai do të dërgonte një përmbytje që do të shkatërronte gjithçka të gjallë.)
6. A iu bind Noeu Perëndisë? Përse po ose jo? (Noeu u bind sepse besonte në Perëndinë.)
7. A na jep Bibla ndonjë arsye për të menduar se Noeu i paralajmëroi njerëzit se Perëndia do të dërgonte një përmbytje dhe do t'i shkatërronte? (Po.) A u pendua ndokush? (Jo.)
8. A na e ka treguar Perëndia se kush mund të na shpëtojë nga mëkati? Kush? (Po, vetëm Jezusi.)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

9. A duhet të jesh i shqetësuar për njerëzit e tjerë që kanë nevojë të shpëtohen nga mëkati i tyre? Çfarë mund të bësh? (Po, t'i tregoj Lajmin e Mirë për Jezusin.)

Mësimi 6

Zanafilla 7:1 – 8:22, 9:8-16

Kupto si duhet:	Perëndia përmbyt botën.
Mendo si duhet:	"Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote." Veprat 16:31 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj në premtimin se Jezusi më ka shpëtuar nga mëkati im.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i sigurt se Jezusi më ka shpëtuar nga mëkati im.

PËRGATITU!

Si të krishterë, e dimë që jemi frymërisht të sigurt në Krishtin. Perëndia e ka premtuar këtë në Fjalën e Tij, për të gjithë ata që besojnë! Kur ne besojmë këtë premtim, mund të jetojmë si Noeu i cili u bind dhe ndoqi Perëndinë, edhe kur të tjerët e refuzuan Atë.

Lutu: Lutu që nxënësit e tu do të besojnë me gjithë zemër se Perëndia i mban premtimet e Tij, edhe kur përjetojnë zhgënjimet dhe vështirësitë e të jetuarit në një botë të rënë.

Lexo: Zanafilla 7:1-8:22; 9:8-16

Kupto si duhet: Perëndia përmbyt botën
Rreth 100 vite pasi Perëndia ia shfaqi planin e Tij Noeut, Ai dërgoi përmbytjen. Çifte nga të gjitha llojet e zogjve dhe kafshëve të tokës, si dhe Noeu e familja e tij, hipën në arkë. Pastaj Perëndia mbylli derën dhe ata ishin të sigurt dhe të mbrojtur nga përmbytja. Rreth një vit më vonë, Noeu, familja e tij dhe zogjtë e kafshët që kishin qenë në arkë, zbritën në tokë të thatë. Perëndia i bëri një premtim Noeut: Ai nuk do ta shkatërronte kurrë më tokën me përmbytje. Shenja e premtimit të Perëndisë ishte ylberi. Perëndia ishte besnik. Ai i shpëtoi ata që ishin në arkë nga përmbytja. Ashtu si ata, ne që kemi besuar në Jezusin jemi të sigurt dhe të shpëtuar nga shkatërrimi i mëkatit. Ngjarja e Noeut dhe e përmbytjes na mëson secilit prej nesh premtimin se Jezusi mund të na shpëtojë nga mëkati ynë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Inskenoni mësimin duke përdorur akuariumin, një varkë për arkën, kafshët, njerëz LEGO etj. Pastaj inskeno përmbytjen duke lëshuar ujë.
2. Kërkoju nxënësve të bëhen si Noeu, familja e tij, kafshët dhe zogjtë.
3. Krijo një simfoni tingujsh me pika uji, breshër, bubullima, zhurma kafshësh, tinguj qetësues, cicërima zogjsh etj.
4. **Nxënësit më të rritur**: përveç përdorimit të njërës prej ideve të mësipërme, filloje mësimin duke përdorur një pako *Skittles* (karamele). Hapeni pakon dhe filloni të hani ngjyrat e "ylberit" duke i përmendur ngjyrat ndërkohë që i hani. Kërkoju nxënësve të shpjegojnë kuptimin biblik të ylberit. Pasi të tregoni kuptimin, "kthehuni pas në kohë" dhe shpjego mësimin, duke treguar më pas si u shfaq ylberi i parë në qiell dhe përse është kaq i rëndësishëm!

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Asgjë nuk mund të na ndajë!

Qëllimi: Të prezantojmë dhe mësojmë konceptin e sigurisë së përjetshme, besimin se asgjë nuk mund ta **ndajë** një të krishterë nga shpëtimi.

Përkufizimi i "sigurisë së përjetshme". Besimi se kur Perëndia shpëton një njeri, këtij i jepet jeta e përjetshme (Gjoni 3:16) dhe si rrjedhojë bëhet anëtar i përhershëm i familjes së Perëndisë (Romakëve 8:38-39), dhe merr Frymën e Shenjtë si garanci për shpëtimin e tij (Efesianëve 1:13-14).

Aktiviteti 1: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Plastelinë e verdhë dhe e kuqe
- Etiketa shpërblyese
- Me zgjedhje: qese të vogla ushqimi (nëse fëmijët do ta marrin plastelinën në shtëpi)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

1. Sfidoji nxënësit të formojnë sa më shumë kafshë të munden me plastelinën e kuqe dhe të verdhë. Thuaju të jenë krijues!
2. Jepu nga një etiketë shpërblyese për çdo kafshë që krijojnë.
3. Kur koha të jetë drejt përfundimit, sfidoji nxënësit t'i bashkojnë dy ngjyrat e ndryshme të plastelinës dhe të formojnë një gjarpër të madh, të gjatë e ngjyrë portokalli.
4. Kur ta kenë përfunduar gjarprin thuaj: "Ky është një gjarpër portokalli fantastik! Për të fituar njëzet etiketa shpërblyese, a mund t'i ndani ngjyrat në të kuqe dhe të verdhë sërish?"
5. Inkurajoi të përpiqen sa më shumë të munden për ta ndarë plastelinën në ngjyrën e verdhë dhe të kuqe.
6. Pasi ta kenë provuar, thuaju: "Mendoj se kjo është e pamundur!"

Me zgjedhje: Ndaj gjarprin në copa dhe lejoji nxënësit të marrin një copë nga plastelina portokalli në shtëpi, si kujtesë, dhe/ose ta përdorin si një mjet mësimor për mësimin.

Aktiviteti 2: Stacioni i ujit

Mjetet:

- Kova të mëdha, të tejdukshme, të mbushura me ujë të pastër
- Kova të mëdha, të tejdukshme, të mbushura me ujë të ngjyrosur (përdor ngjyrues ushqimi)
- Gota të vogla plastike/kartoni (nga një për çdo skuadër me nga 5 nxënës)
- Kone (nga një për çdo skuadër me 5 nxënës; vendosini konet në një distancë të largët nga kovat e ujit)
- Kova të mëdha, të tejdukshme (nga një për çdo skuadër me 5 nxënës; vendos një tas pranë konit të çdo skuadre, që të jetë vendi ku skuadra mbledh ujin)
- Kullesa ose hinka (që do të përpiqen t'i përdorin për të ndarë ujin e pastër nga ai me ngjyrë)
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

Pjesa 1:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga pesë dhe caktoji secilës skuadër nga një kon.
2. Kërkoju nxënësve të ulen në rresht njëri pas tjetrit, pas konit të skuadrës.
3. Jepi një gotë nxënësit të parë nga secila skuadër.
4. Sfidoji skuadrat të garojnë. Vrapuesi i parë merr gotën, vrapon te uji, e mbush me ujë të pastër, kthehet te kova që ka skuadra, e derdh dhe ja jep gotën vrapuesit tjetër.
5. Vrapuesi tjetër përsërit të njëjtin veprim, por me ujin e ngjyrosur.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Të gjithë vrapuesit do të bëjnë të njëjtën gjë, duke marrë me radhë ujë të pastër e të ngjyrosur.
7. Vazhdojeni garën për pesë ose shtatë minuta. Sfidojini të vrapojnë shpejt.
8. Masni sasinë e ujit nëpër kova dhe jepuni anëtarëve të skuadrës që ka më shumë ujë nga tre etiketa shpërblyese për secilin.

Pjesa 2:

1. Thuaj: "Gara e dytë vlen 20 etiketa shpërblyese!" Nxënësit duhet të emocionohen. "Ja se çfarë duhet të bëni: secili person do të marrë një gotë, do ta mbushë me ujë nga kova e skuadrës dhe do të ndajë ujin e pastër nga uji i ngjyrosur, duke i kthyer prapë në kovat fillestare. Pra, duhet të **ndani** ujin e pastër nga ai i ngjyrosur. A jeni gati?"
2. Kërkoju nxënësve të përpiqen që të ndajnë ujin e ngjyrosur nga uji i pastër duke përdorur kullesat ose hinkat.
3. Pasi të ketë kaluar pak kohë, nxënësit do të jenë të hutuar, sepse uji i pastër dhe uji i ngjyrosur nuk mund të **ndahen** dot nga njëri-tjetri. Do të fillojnë të protestojnë duke thënë se është një detyrë e pamundur!
4. Pyeti: "A jeni të sigurt që nuk mund të **ndahen**?"
5. Kujtoju se sfida vlen 20 etiketa shpërblyese për çdo anëtar të skuadrës, nëse do të arrijnë t'i **ndajnë**!
6. Pasi nxënësit të ankohen se detyra është e pamundur, thuaju se sfida nuk po funksionon. Tunde kokën për të mohuar dhe thuaj: "Është e pamundur të **ndahet** uji i pastër nga ai me ngjyrë!"

Aktiviteti 3: Stacioni i artit

Mjetet:

- Letra të vogla me ngjyra
- Bojëra: të kuqe, të verdhë, jeshile dhe blu
- Furçë pikturash
- Gota uji
- Një shembull të posterit të përfunduar
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit të mendojnë për mësimin e javës së kaluar (Noeu ndërtoi arkën.). Pyeti se çfarë u vjen në mendje kur mendojnë për atë mësim.
2. Tani sfidoji në një konkurs arti, ku do të pikturojnë apo krijojnë art, duke u bazuar në ato mendime. Nxënësi që krijon prezantimin më të mirë të kuptimit të mësimit fiton dhjetë etiketa shpërblyese.
3. Ndërsa fillojnë të vizatojnë, inkurajoji të bashkojnë disa ngjyra, në mënyrë që të formojnë ngjyra të reja.
4. Tregojua si bëhet bashkimi i ngjyrave.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

5. Pas disa çastesh, pyeti nëse mund t'i ndajnë ngjyrat nga njëra-tjetra. Ata do të thonë se është e pamundur.
6. Inkurajoji të mendojnë për ngjyrat e bashkuara dhe se si mund t'i lidhin me fjalët "siguri e përjetshme".
7. Kur nxënësit të përfundojnë artin, shpërbleje fituesin me dhjetë etiketa shpërblyese.

Me zgjedhje: Vari posterat që të thahen në galerinë e artit. Jepua nxënësve me vete kur të largohen.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: A e beson dot që drejtuesi i KZ-së të kërkoi të ndaje _____ nga _____ pasi i bashkove? *Plotësojini hapësirat bosh me gjërat që bashkuat gjatë KZ-së.* Si u ndiet kur iu kërkua t'i ndanit? Ato u bashkuan përgjithmonë! Kur i kërkon Jezusit të heqë mëkatin dhe të bëhet udhëheqësi i jetës tënde, asgjë nuk mund të të ndajë nga Ai. (Romakëve 8:38-39) Ky është një premtim! Ai do të jetë gjithmonë aty për ty. Por si e di këtë gjë me siguri? A dyshon ndonjëherë që kur je i shpëtuar, je përgjithmonë i shpëtuar? Le të shohim Biblën dhe të zbulojmë çfarë thotë Perëndia për këtë.

Lutu: *Kujtoju nxënësve se kur lutemi, po flasim me Perëndinë e universit. Inkurajoje njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. A është e vështirë që nxënësit të luten me zë?*

1. *Thuajua përpara (ose edhe një javë para) dhe thuaju se ti i sheh si drejtues në klasë, dhe se do të doje që ata ta nisnin mësimin me një lutje.*
2. *Nxënësve më të rritur kërkoju të luten me një person tjetër. Mund të duket pak e çuditshme në fillim, por sa më shpesh ta bësh këtë, aq më e lehtë do të bëhet për ta. Pasi të luten me njëri-tjetrin, përfundoje mësimin me lutje.*

Zbuloje: A është Zanafilla në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re? (DH.V.) Hapini Biblat në librin e parë të Dhiatës së Vjetër, Zanafilla, kapitulli 7.

Kronologjia: Duke numëruar nga 1-3, kërkoju nxënësve të drejtojnë gishtin te Zanafilla te Kronologjia. Le të rishohim lëvizjet e *Flasim rreth Zanafillës* deri në këtë pikë.

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Javën e kaluar mësuam se Perëndia i kërkoi një njeriu të quajtur Noe të ndërtonte një arkë. Le të shohim nëse e mbani mend se çfarë kemi mësuar. Nëse ngrini dorën dhe më jepni një përgjigje të saktë, do të fitoni një etiketë shpërblyese! *Për nxënësit më të vegjël, kthejini pyetjet në "e vërtetë/e gabuar" ose në pyetje me alternativa.*

- Çfarë e trishtoi aq shumë Perëndinë gjatë kohës kur jetonte Noeu? (Njerëzit ishin bërë shumë mëkatarë.)
- Çfarë planifikoi të bënte Perëndia për shkak të mëkatit të njerëzve? (Të dërgonte një përmbytje që do të shkatërronte gjithkënd dhe gjithçka që jetonte mbi tokë.)
- Përse Perëndisë i pëlqente Noeu? (Sepse ai kishte besim në Perëndinë.)
- Cilët ishin ata që do të shpëtonin nga përmbytja duke u futur në arkë? (Noeu, familja e tij dhe të paktën dy nga çdo lloj krijese e gjallë.)
- A na jep Bibla arsye të besojmë se Noeu i paralajmëroi njerëzit që Perëndia do të dërgonte një përmbytje për t'i shkatërruar? (Po.)
- A u pendua ndokush? (Jo.)

Ju lumtë! Tani do të zbulojmë se çfarë ndodhi pas përfundimit të arkës.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 7:1 – 8:22, 9:8-16

Noeu është i drejtë

Lexo: Zanafilla 7:1

Përmbledhje: Perëndia tha se Noeu ishte i drejtë. Çfarë do të thotë i drejtë? (Një person i drejtësuar para Perëndisë.) A do të thotë kjo se Noeu nuk mëkatoi kurrë? (Jo!) A i kujtohet ndokujt se çfarë thotë Romakëve 3:23? ("Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë.") Edhe Noeu ishte mëkatar. Atëherë, çfarë do të thotë "i drejtë"? Do të thotë se Noeu nuk duhej të mbante fajin për mëkatin e vet. Përse? Për shkak se kishte besim në Perëndinë dhe Shpëtimtarin që Perëndia do të dërgonte një ditë. Në Dhiatën e Vjetër, njerëzit besonin në Shpëtimtarin që do të vinte një ditë. Ne shohim pas dhe besojmë në Shpëtimtarin që erdhi! *Ndërsa e shpjegon këtë, vizato një diagram me një kryq në mes. Shkruaj "Noeu" në të majtë dhe vizato një shigjetë që të çon te kryqi në mes, pastaj shkruaj "Ti" në të djathtë dhe vizato një shigjetë që të çon gjithashtu te kryqi në mes.* Perëndia e shpëtoi Noeun sepse ai kishte besim në Shpëtimtarin që do të vinte në të ardhmen! Kush është ai Shpëtimtar? (Jezusi!)

Shënim i mësuesit kryesor: Çështja e rëndësishme përsëritet qëllimisht nga mësimi i javës së kaluar.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mendo përsëri në lidhje me atë që lexuam. Cilët njerëz i tha Perëndia Noeut të merrte në arkë? (tetë njerëz – Noeu, gruaja e tij, tre djemtë e tij: Semin, Kamin dhe Jafetin, dhe gratë e tyre.) Le të vazhdojmë të lexojmë për të zbuluar se kë tjetër do të merrte në arkë Noeu.

Kafshët dhe zogjtë hyjnë në arkë

Lexo: Zanafilla 7:2-3

Përmbledhje: Sa nga secili lloj i kafshëve të pastra urdhëroi Perëndia të ishin në arkë? (Shtatë – mashkull dhe femër.) Çfarë është një kafshë e pastër? Këtu, kafshët e pastra ishin ato që Perëndia kishte thënë se mund të përdoreshin si sakrifica. Kafshët e papastra nuk duhej të përdoreshin si sakrifica. Më vonë në Bibël, izraelitët nuk duhet të hanin kafshët e papastra. Sa nga çdo lloj i kafshëve të papastra urdhëroi Perëndia të ishin në arkë? (Dy – mashkull dhe femër) A mendon se Noeu duhej të shkonte e t'i gjente të gjitha ato krijesa dhe t'i sillte në arkë? (Jo! Krijesat erdhën vetë te Noeu dhe tek arka! Zanafilla 7:15) Le të vazhdojmë të lexojmë.

Noeu bindet dhe Perëndia dërgon përmbytjen

Lexo: Zanafilla 7:4-12

Përmbledhje: Për sa ditë dhe net ra shi? (Dyzet.) Uji binte nga qielli lart dhe dilte nga toka poshtë, dhe nuk kishte rrugëdalje! Duhet të ketë qenë tmerruese për të gjithë njerëzit!

Nxënësit më të rritur: Po sikur ti të kishe qenë një prej atyre njerëzve? Si mendon se do të ishe ndier kur ujërat të ngriheshin dhe të mos kishte rrugëdalje? *Lejoji nxënësit të mendojnë pak dhe të përgjigjen shkurtimisht ndërsa shohin posterin e "Ndihu si duhet"*.

Parafrazim i Zanafilla 7:13-16a: Përmbytja filloi dhe Noeu, familja e tij, kafshët e tokës si dhe zogjtë u futën në arkë. Çfarë mendoni se ndodhi më vonë?

Lexo: Zanafilla 7:16b ("Pastaj ZOTI i mbylli brenda.")
Përmbledhje: Vetë Perëndia e mbylli derën! A mendon se të gjithë brenda në arkë ishin të sigurt tani? Patjetër që ishin!

Toka përmbytet për 150 ditë

Parafrazim i Zanafilla 7:17-24

Kishte kaq shumë ujë, saqë edhe malet u mbuluan me më shumë se gjashtë metra ujë dhe gjithçka që jetonte dhe merrte frymë mbi tokë, vdiq. Çdo kafshë e tokës, çdo shpend dhe çdo person vdiq, përveç Noeut, familjes së tij dhe kafshëve e shpendëve që ishin të sigurt dhe të mbrojtur në arkë. Toka u përmbyt për 150 ditë, por pastaj...

Perëndia kujtohet për ata që janë në arkë

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo: Zanafilla 8:1

Përmbledhje: Bibla na thotë se Perëndia u kujtua. A mendoni se Perëndia e kishte harruar Noeun dhe pjesën tjetër që ishte në arkë? (Jo!) Perëndia nuk i harron kurrë njerëzit që kanë besim tek Ai. 'U kujtua' do të thotë se Perëndia bëri diçka që të kujdesej për Noeun, familjen e tij dhe krijesat në arkë.

Kjo i përngjan aktivitetit në *Kohën e zbulimit*. Nëse i ke besuar Jezusit që të të falë mëkatin, ti je si plastelina/uji/ngjyrat. Ti je pjesë e familjes së Perëndisë përgjithmonë. Ai nuk do të ndahet kurrë nga ti!

Gjithçka në arkë është e sigurt

Parafrazim i Zanafilla 8:2-22

Më në fund, Noeu dërgoi një pëllumb jashtë arkës dhe pëllumbi u kthye me një degë ulliri. Noeu e dinte se tashmë nuk kishte më përmbytje. Pastaj, një ditë, Perëndia i thotë Noeut, familjes së tij dhe të gjitha krijesave në arkë të dilnin jashtë. Ata ishin të sigurt dhe të mbrojtur. Ata kishin shpëtuar nga përmbytja që shkatërroi çdo person, çdo kafshë të tokës dhe shpend të qiellit. Imagjinoni sa mirënjohës duhet të ketë qenë Noeu! Perëndia i dha Noeut një mënyrë për t'u shpëtuar dhe Noeu u bind. Ai ishte kaq mirënjohës saqë bëri një sakrificë për Perëndinë duke përdorur një nga kafshët e pastra. Kjo i pëlqeu Perëndisë dhe Ai bëri një premtim të veçantë të quajtur besëlidhje, që thoshte se nuk do t'i shkatërronte më kurrë qeniet e gjalla me përmbytje.

Perëndia jep ylberin mes reve si shenjë të premtimit të Tij

Parafrazim i Zanafilla 9:8-16

A e dini se cila është shenja e premtimit të veçantë të Perëndisë? (Ylberi mes reve.) Kur të shihni ylberin mes reve, mund të mendoni për premtimin e Perëndisë që nuk do t'i shkatërrojë më kurrë të gjitha qeniet e gjalla me përmbytje. Mund të mendoni për faktin se Perëndia kujtohet dhe i mban premtimet e Tij.

Përfundimi

A ju kujtohet çfarë tha Perëndia për botën, menjëherë pasi e krijoi? (Ishte shumë mirë.) Por, çfarë bënë njerëzit? (Ata zgjodhën mëkatin dhe bota u bë shumë e ligë.) Për shkak të kësaj ligësie, zemra e Perëndisë u brengos shumë (Zanafilla 6:6). Në mënyrë që të hiqte të keqen që kishte mbuluar gjithçka, Ai vendosi të shkatërrojë çdo qenie të gjallë (njerëzit, kafshët e tokës dhe shpendët) mbi tokë. Cila ishte mënyra e vetme për t'i shpëtuar përmbytjes? (Arka!)

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A e dini se Jezusi është "arka" jonë? Edhe pse ne i bëjmë gjërat siç na pëlqen ne dhe jo si i pëlqen Perëndisë. Ai ka dhënë Birin e Tij, Jezusin, që të na shpëtojë, ashtu si shpëtoi Noeun, familjen e tij dhe të gjitha krijesat në arkë nga përmbytja. Atëherë, a je ti në "arkë"? A i ke besuar Jezusit që të të shpëtojë nga mëkati yt dhe a e ke bërë udhëheqësin e jetës sate? Nëse po, atëherë mund të ndihesh i sigurt dhe i mbrojtur, duke e ditur se Jezusi nuk do të ndahet kurrë prej teje – ti je pjesë e familjes së Tij, tani dhe përgjithmonë. *Referoju përsëri aktivitetet të KZ-së.* Ti ke jetën e përjetshme dhe nuk do të ndëshkohesh për mëkatin tënd! A ju kujtohet vargu nga *Mendo si duhet*, Veprat 16:31? Le ta themi tani. *Kërkoju nxënësve ta recitojnë*. Po nëse nuk i ke besuar Jezusit? Çfarë do të ndodhë nëse ti vdes pa i besuar Atij? Atëherë nuk je i sigurt. Ti je si ata njerëzit që u shkatërruan në përmbytje. Do të ndahesh nga Perëndia përgjithmonë. Por mos u shqetëso; ka një rrugëdalje! Le të ndalemi pak! Ule kokën dhe mendo pak për Veprat 16:31. A je i shpëtuar? Nëse po, mund të lavdërosh Jezusin tani që të ka shpëtuar! Nëse jo, a do të doje të mësoje më shumë për mënyrën si mund të jesh i sigurt në Jezusin dhe të mos ndahesh kurrë nga Perëndia? *Mundësi për të ndarë Ungjillin përmes Librit pa fjalë dhe bëj një ftesë të qartë.*

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Përse tha Perëndia se Noeu ishte i drejtë? (Ai kishte besim në Perëndinë dhe në Shpëtimtarin që Perëndia do të dërgonte një ditë.)
2. Sa njerëz urdhëroi Perëndia të ishin në arkë? (Tetë- Noeu, gruaja e tij, tre djemtë e tij: Semi, Kami dhe Jafeti, dhe gratë e tyre.)
3. Sa nga secila kafshë dhe secili shpend urdhëroi Perëndia të ishin në arkë? (Shtatë nga çdo kafshë e pastër, mashkull dhe femër; dy nga çdo kafshë e papastër, mashkull dhe femër.)
4. Nga erdhi uji i përmbytjes? (Nga qielli lart dhe nga toka poshtë.)
5. Kush e mbylli derën pasi të gjithë hynë në arkë? (Perëndia.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Kur thuhet: “Perëndisë iu kujtua Noeu”, a do të thotë se Perëndia e kishte harruar Noeun? (Jo, Perëndia nuk i harron ata që kanë besim tek Ai.)
7. Cila ishte mënyra e vetme që Noeu, familja e tij dhe kafshët të shpëtonin nga përmbytja? (Arka.)
8. Cila ishte shenja që Perëndia dha për të treguar se nuk do ta shkatërronte më kurrë tokën përmes përmbytjes? (Ylberi.)
9. Kush është “arka” që na shpëton nga mëkati? (Jezusi.)

Mësimi 7

Zanafilla 11:1-9

Kupto si duhet:	Ndërtohet kulla e Babelit.
Mendo si duhet:	“Sepse, me anëtë hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, *por është* dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos mburret.” Efesianëve 2:8-9 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do t’i bëj gjërat siç i pëlqen Perëndisë, jo siç më pëlqen mua.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i përqendruar kur i bëj gjërat siç i pëlqen Perëndisë, jo siç më pëlqen mua.

PËRGATITU!

A e ke pyetur ndonjëherë veten se përse ka kaq shumë gjuhë të ndryshme në botë? Mendo për të gjitha problematikat e komunikimit që mund të ishin zgjidhur nëse e gjithë bota do të fliste të njëjtën gjuhë! Ndërsa lexon pasazhin nga Shkrimi dhe mësimin më poshtë, zbulo (ose rizbulo) burimin e barrierave gjuhësore, rëndësinë e bërjes së gjërave siç i pëlqen Perëndisë, dhe pasojat e paimagjinueshme që mund të kemi nëse nuk veprojmë ashtu.

Lutu: Lutu që Perëndia të zgjojë shpirtrat e nxënësve të tu dhe që ata ta dëshirojnë me ngulm Fjalën e Perëndisë.

Lexo: Zanafilla 11:1-9

Kupto si duhet: Ndërtohet kulla e Babelit
Noeu dhe familja e tij iu bindën Perëndisë duke bërë fëmijë që të mbushnin tokën. Megjithatë, shumë vite më vonë, pasardhësit e tyre vendosën ta jetonin jetën siç u

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

pëlqente atyre dhe jo siç i pëlqente Perëndisë. Ata ndërtuan një qytet, sepse donin të bënin emër dhe nuk donin të shpërndaheshin nëpër botë. Kështu ndërtuan një kullë të lartë në qytet, sepse donin të arrinin qiejt. Zgjidhja e Perëndisë për këtë mosbindje ishte ngatërrimi i gjuhëve të tyre dhe shpërndarja nëpër të gjithë botën. Nga ngjarja e kullës së Babelit mësojmë se duhet t'i bëjmë gjërat gjithmonë siç i pëlqen Perëndisë dhe jo siç na pëlqen neve.

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor: Edhe pse studimi i fjalës "Babel" është interesant, nuk do ta diskutojmë në këtë mësim.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Shpjegoje këtë mësim si një mister (ki parasysh kalimin nga KZ-ja). Lejo që pjesë të ndryshme nga Shkrimi, të jenë si "të dhëna" që shpjegojnë mësimin.
2. Shpjegoje mësimin dhe pastaj trego hartën e botës. Sfidoji nxënësit të mendojnë për mënyrën se si e ndryshoi kjo ngjarje historinë. Pyet se si qëndron Gjoni 3:16 në këtë ngjarje. Po 12 vargjet e tjera kyç?
3. Ndërsa shpjegon mësimin, krijo ilustrime duke përdorur figura ose lapustila.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Çfarë the?

Qëllimi: T'i prezantojmë nxënësit me **gjuhët e huaja**.

Aktiviteti 1: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Etiketa shpërblyese.
- Vullnetar i veçantë që flet një **gjuhë të huaj.**

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Qëllimi është që nxënësit të ndërtojnë kulla të larta me plastelinë, por një vullnetar i veçantë do t'u japë udhëzimet nxënësve në një gjuhë të huaj.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Thuaj: “Do të doja të mirëprisja _____ (*emri i vullnetarit*) në klasën tonë sot. Ai/ajo do të drejtojë aktivitetin e KZ-së sot. Sigurohuni ta dëgjoni dhe të bëni siç ju thotë!”
3. **Vullnetari i veçantë**: Thuaj në **gjuhë të huaj**: “Mirë se erdhët në *Kohën e Zbulimit*! Sot do të ndërtojmë kulla të larta me plastelinë. Jini shumë krijues ndërsa ndërtoni. Nëse përfundoni një kullë me plastelinë, do të merrni tri etiketa shpërblyese! A ka dikush ndonjë pyetje?”
4. Pjesa më e madhe e nxënësve do të jenë të hutuar.
5. **Vullnetari i veçantë**: Përsëriti udhëzimet dhe shto lëvizjet e duarve. Inkurajoji nxënësit të fillojnë me punën.
6. Në këtë pikë, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet të inkurajosh nxënësit të fillojnë punën. Kërkoji të hamendësojnë se çfarë tha vullnetari i veçantë dhe thuaju të fillojnë të bëjnë diçka me plastelinë. Mos i përkthe udhëzimet!
7. **Vullnetari i veçantë**: Ec vërdallë dhe vazhdo të japësh udhëzime në **gjuhën e huaj**. Qëllimi është që ata të vazhdojnë të jenë të hutuar.
8. Në fund të aktivitetit, prezantuesi mund t’u tregojë nxënësve se në çfarë gjuhe po flitej dhe si e kishte mësuar vullnetari. Pastaj jepi secilit prej nxënësve që ka përfunduar kullën me plastelinë, tri etiketa shpërblyese.

Aktiviteti 2: Stacioni i rërës

Mjetet:

- Ujë në kova të mëdha (rëra duhet të jetë e lagur, por gjithashtu fëmijët duhet të kenë ujë vetë).
- Lopata dhe kova.
- Etiketa shpërblyese.
- Vullnetar i veçantë që flet një gjuhë të huaj.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Qëllimi është që nxënësit të ndërtojnë kulla të larta me rërë, por një vullnetar i veçantë do t’u japë udhëzimet nxënësve në një **gjuhë të huaj**.
2. Thuaj: “Do të doja të mirëprisja _____ (*emri i vullnetarit*) në klasën tonë. Ai/ajo do të drejtojë aktivitetin e KZ-së sot. Sigurohuni ta dëgjoni dhe të bëni siç ju thotë!”
3. **Vullnetari i veçantë**: Thuaj në **gjuhë të huaj**: “Mirë se erdhët në *Kohën e zbulimit*! Sot do të ndërtojmë kulla të larta me rërë. Jini shumë krijues ndërsa ndërtoni. Nëse përfundoni një kullë me rërë, do të merrni tri etiketa shpërblyese! A ka dikush ndonjë pyetje?”
4. Pjesa më e madhe e nxënësve do të jenë të hutuar.
5. **Vullnetari i veçantë**: Përsëriti udhëzimet dhe shto lëvizjet e duarve. Inkurajoji nxënësit të fillojnë me punën.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Në këtë pikë, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet të inkurajosh nxënësit të fillojnë punën. Kërkoju të hamendësojnë se çfarë tha vullnetari i veçantë dhe thuaju të fillojnë të bëjnë diçka me rërën. Mos i përkthe udhëzimet!
7. **Vullnetari i veçantë**: Ec vërdallë dhe vazhdo të japësh udhëzime në **gjuhën e huaj**. Qëllimi është që ata të vazhdojnë të jenë të hutuar.
8. Në fund të aktivitetit, prezantuesi mund t'u tregojë nxënësve se në çfarë gjuhe po flitej dhe si e kishte mësuar vullnetari. Pastaj jepi secilit prej nxënësve që ka përfunduar kullën me rërë, tri etiketa shpërblyese.

Aktiviteti 3: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Kuti.
- Etiketa shpërblyese.
- Vullnetar i veçantë që flet një gjuhë të huaj.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Qëllimi është që nxënësit të ndërtojnë kulla të larta me kuti, por një **vullnetar i veçantë** do t'u japë udhëzimet nxënësve në një gjuhë të huaj.
3. Thuaj: "Do të doja të mirëprisja _____ (*emri i vullnetarit*) në klasën tonë. Ai/ajo do të drejtojë aktivitetin e KZ-së sot. Sigurohuni ta dëgjoni dhe të bëni siç ju thotë!"
4. **Vullnetari i veçantë**: Thuaj **në gjuhë të huaj**: "Mirë se erdhët në *Kohën e zbulimit*! Sot do të ndërtojmë kulla të larta me kuti. Skuadra që ndërton piramidën më të lartë do të marrë tri etiketa shpërblyese! A ka dikush ndonjë pyetje?"
5. Pjesa më e madhe e nxënësve do të jenë të hutuar.
6. **Vullnetari i veçantë**: Përsëriti udhëzimet dhe shto lëvizjet e duarve. Inkurajoji nxënësit të fillojnë me punën.
7. Në këtë pikë, ti (drejtuesi i KZ-së) duhet të inkurajosh nxënësit të fillojnë punën. Kërkoju të hamendësojnë se çfarë tha vullnetari i veçantë dhe thuaju të fillojnë të bëjnë diçka me kutitë. Mos i përkthe udhëzimet!
8. **Vullnetari i veçantë**: Ec vërdallë dhe vazhdo të japësh udhëzime në **gjuhën e huaj**. Qëllimi është që ata të vazhdojnë të jenë të hutuar.
9. Në fund të aktivitetit, prezantuesi mund t'u tregojë nxënësve se në çfarë gjuhe po flitej dhe si e kishte mësuar vullnetari. Pastaj jepi secilit prej nxënësve të skuadrës që ka bërë piramidën më të lartë me kuti, tri etiketa shpërblyese.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Si ishte aktiviteti i KZ-së sot? A ishte ndopak hutues? Përse? (Drejtuesi foli në një gjuhë tjetër.) A e dini se ka mbi 7 000 gjuhë në botë? A flisni ju ndonjë gjuhë të huaj? Kush i krijoi gjuhët e huaja dhe përse ekzistojnë ato? Sot do të zbulojmë se kush, çfarë, ku, kur dhe pse ndodhi ky mister kaq i madh!

Shënim: Nëse keni përdorur idenë krijuese 1 për të shpjeguar mësimin, mund të keni nevojë të rishikoni kalimin, ose lidhe KZ-në me mësimin pasi të jetë zgjidhur misteri.

Shënim: Nëse KZ-në e keni zhvilluar në Stacionin e misionit, ju lutemi zhvilloni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Lutu: *Pyeti nxënësit nëse ndonjëri prej tyre flet një gjuhë të huaj. Nëse po, kërkoji ta nisë mësimin me një lutje në gjuhën e huaj të cilën flet. Pasi të lutet, kërkoji të lutet në gjuhën tuaj.*

Zbuloje: A është Zanafilla në DH.V. apo në DH.R.? (DH.V.) Le t'i hapim Biblat te libri i Zanafillës, kapitulli 11.

Kronologjia: Javën e kaluar mësuam për përmbytjen. A mund ta gjeni përmbytjen te kronologjia? Le të rishikojmë lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës" deri tani.

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të marrim një moment për të parë se sa kujtojmë nga Noeu dhe përmbytja. Nëse ngrini dorën dhe më jepni përgjigjen e saktë, do të fitoni një etiketë shpërblyese. *Për nxënësit më të vegjël, pyetjet bëjini me "E vërtetë/E gabuar" ose me alternativa.*

- Përse Perëndia zgjodhi Noeun për të ndërtuar arkën? (Noeu kishte besim në Perëndinë dhe në Shpëtimtarin që Perëndia do të dërgonte një ditë.)
- Çfarë ndodhi me çdo person, kafshë të tokës dhe shpend që nuk ishte në arkë? (Ata u shkatërruan.)
- Menjëherë pas përmbytjes, sa njerëz mbetën të gjallë mbi tokë? (Tetë: Noeu, gruaja e tij, tre djemtë Semi, Kami dhe Jafeti, dhe tre gratë e tyre)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

A e di se çfarë i kërkoi Perëndia Noeut dhe familjeve të bijve të tij të bënin? Ai u tha: "Qofshi frytdhënës, shumëzohuni dhe mbusheni tokën." (Zanafilla 9:1). A e ke dëgjuar në ndonjë vend tjetër të njëjtin urdhërim? Kështu i tha Perëndia edhe Adamit dhe Evës! (Mësimi 1, Zanafilla 1:28) Nuk kishte njerëz të tjerë të gjallë në tokë, përveç familjes së Noeut. Ishte detyra e tyre të kishin fëmijë dhe të mbushnin tokën sërish me njerëz. Noeu dhe familja e tij iu bindën Perëndisë. Bijtë e Noeut, Semi, Kami dhe Jafeti, si dhe gratë e tyre, kishin familje. Familjet e tyre u shtuan, njerëzit filluan të shpërndaheshin dhe të jetonin në vende të tjera.

Tani dua të dëgjoni me kujdes, për të zbuluar se çfarë ndodhi më vonë!

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 11:1-9

Në fillim ka vetëm një gjuhë

Lexo: Zanafilla 11:1

Përmbledhje: A e dinit se nga koha që Perëndia krijoi botën deri në kohën pas përmbytjes, të gjithë flisnin të njëjtën gjuhë? *Trego tri figurat e para në kronologjinë e Biblës.* Mendo sa ndryshe është nga ditët e sotme. A e ke pyetur ndonjëherë veten se përse njerëzit flasin gjuhë të ndryshme? E po, Bibla na e tregon, kështu që le të vazhdojmë të lexojmë.

Njerëzit duan të ndërtojnë një qytet me një kullë

Lexo: Zanafilla 11:1-4

Përmbledhje: Çfarë donin të ndërtonin njerëzit? (Një qytet me një kullë që do të arrinte qiejt.) Cilat ishin dy arsyet përse ata ndërtuan një qytet dhe një kullë që do të arrinte qiejt? (Të krijonin një emër dhe të mos shpërndaheshin nëpër botë.)

Le të flasim për arsyen e parë – njerëzit donin të bënin emër. Njerëzit donin që emri i tyre të ishte i madh dhe të tjerët të mendonin se ata ishin të rëndësishëm. Por, a duhet të duan njerëzit të ngrenë lart emrin e tyre, apo duhet të duan të ngrenë lart emrin e Perëndisë? (Ata duhet të duan të ngrenë lart emrin e Perëndisë, jo emrin e tyre.)

Tani, le të mendojmë për shembuj se si njerëzit mund ta bëjnë këtë gjë sot. A njeh një mik që dëshiron të bëhet sportist me emër, apo këngëtar, artist, ose thjesht dëshiron notat më të mira, e gjëra të tilla? Ndoshta ti vetë je ashtu. Përse duan njerëzit të jenë më të mirët në diçka? Shumicën e rasteve e duam diçka të tillë, në mënyrë që të jemi të famshëm dhe që njerëzit të mendojnë se

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

jemi të veçantë. Duam që emri ynë të jetë i madh! Kjo quhet krenari dhe krenaria është mëkat. Në vend që thjesht të duam të jemi më të mirë se të tjerët në diçka, duhet të duam të bëjmë punë të mirë duke u treguar njerëzve për madhështinë e Perëndisë dhe për Lajmin e Mirë rreth Jezusit!

Le të flasim për arsyen e dytë përse njerëzit donin të ndërtonin një qytet – ata nuk donin të shpërndaheshin nëpër botë. A dëshironte Perëndia që njerëzit të qëndronin të gjithë së bashku në një qytet, apo donte që ata të shpërndaheshin dhe të jetonin nëpër të gjithë botën? (Ai donte që ata të jetonin nëpër të gjithë botën.)

Nxënësit më të rritur: Si do të kishte qenë jeta nëse nuk do të ishim shpërndarë nëpër të gjithë botën?

Kërkoju nxënësve të mendojnë për probleme të ndryshme që do të kishim; shtëpitë e mbipopulluara, ndotja, sëmundjet, krimi, uria etj. A e dinte Perëndia se cila ishte gjëja më e mirë? (Patjetër!)

Të gjithë nxënësit: Po ti? A dëshiron të veprosh siç të pëlqen ty apo dëshiron të bësh atë që Perëndia do? Mund të jetë bindja ndaj prindërve, mbarëvajtja me vëllezërit dhe motrat, të ndihmosh dikë ose t'i tregosh dikujt për Jezusin. Ndonjëherë është e vështirë të bësh atë që Perëndia do, por mënyra e Perëndisë është gjithmonë më e mirë se e jona.

Tani le të flasim për kullën. Përse donin njerëzit që kulla të ishte aq e lartë? (Për të arritur qiejt.) Si është mënyra e vetme për të arritur qiejt? (Duhet të kemi besim te Jezusi për të na shpëtuar nga mëkati dhe ta bëjmë Atë udhëheqësin e jetës sonë.)

A njeh shumë njerëz që mendojnë se mund të shkojnë në qiell duke bërë diçka tjetër përveç besimit në Jezusin? A është e drejtë kjo? (Jo.) Vargu ynë nga 'Mendo si duhet', e shpjegon këtë. Le t'i themi vargjet e Efesianëve 2:8-9 së bashku. *Recito Efesianëve 2:8-9.*

Është e qartë që njerëzit të cilët po ndërtonin qytetin, po e bënin siç po u pëlqente atyre, jo siç i pëlqente Perëndisë. Si quhet kur nuk i bëjmë gjërat siç i pëlqen Perëndisë? (Mëkat.) Çfarë mendoni se bëri Perëndia? Le ta zbulojmë.

Perëndia e di që njerëzit po i bëjnë gjërat siç u pëlqen atyre, jo siç i pëlqen Atij

Lexo: Zanafilla 11:5-6

Përmbledhje: Perëndia e dinte se njerëzit nuk po i bënin gjërat siç i pëlqente Atij dhe Ai e dinte se mëkati i tyre do të përkeqësohej. A ju kujtohet se cili ishte

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

plani i Perëndisë? (Të dërgonte Jezusin për t'i shpëtuar njerëzit nga mëkati i tyre.) A mund ta ndalonte Perëndinë ndonjëra nga gjërat që ata po bënin? (Jo!) Ja çfarë bëri Perëndia më pas...

Perëndia ngatërron gjuhët e tyre dhe i shpërndan

Lexo: Zanafilla 11:7-9

Përmbledhje: Gjëja e parë që bëri Perëndia me njerëzit që po ndërtonin qytetin ishte ngatërrimi i gjuhëve të tyre. Perëndia e bëri këtë që ata të mos e kuptonin dot njëri-tjetrin dhe pastaj, ata do të shpërndaheshin nëpër botë. Në cilin veprim i ndaloi kjo gjë njerëzit? (I ndaloi që të mos ndërtonin qytetin me kullën.) Në fund, gjërat u bënë siç i pëlqente Perëndisë apo siç u pëlqente njerëzve? (Siç i pëlqente Perëndisë.)

Kjo më kujton një fjalë shumë të rëndësishme: sovran. A e di se çfarë do të thotë fjala sovran? (Do të thotë se Perëndia ka të gjithë fuqinë.) Edhe pse njerëzit mund të mos i bëjnë gjërat siç i pëlqejnë Perëndisë, Perëndia e ka fuqinë të plotësojë planin e Tij. Çfarë mendimi i mrekullueshëm! Perëndia ynë është i mrekullueshëm!

Shënim për mësuesin kryesor: Nëse dikush të pyet se përse Perëndia thotë "ne" në vargun 7, tregoji që Ai po flet për Trinitetin: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë.

Përfundimi

A nuk do të ishte jeta shumë më e thjeshtë nëse njerëzit do të jetonin siç i pëlqen Perëndisë? Nëse njerëzit në atë kohë do t'i kishin bërë gjërat siç i pëlqente Perëndisë, ndoshta sot do të kishim vetëm një gjuhë! Tani mendo për këtë: kur njerëzit po ndërtonin kullën, ata po përpiqeshin të arrinin vetë në qiej. A e di që njerëzit vazhdojnë të përpiqen edhe sot? Shumë njerëz mendojnë se ata mund të arrijnë qiejt duke bërë gjëra të mira. A mund të përmendësh disa nga gjërat që njerëzit mendojnë se do t'i çojnë në qiell? *Kërkoju nxënësve të japin shembuj, p.sh., të thuash se je i krishterë, pagëzimi, të shkuarit në kishë, ndihma ndaj të tjerëve, bërja e gjërave të mira, të përpiqesh t'u bindesh dhjetë urdhërimeve etj.* A është e vërtetë kjo? (Jo.) A mund të të çojë në qiell ndonjëra prej këtyre gjërave? (Jo!) Çfarë na thotë vargu i sotëm nga 'Mendo si duhet' për faktin se nuk mund të shkojmë në qiell duke bërë atë që ne mendojmë se është e mirë? Kërkoju nxënësve të recitojnë Efesianëve 2:8-9.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kur i bëjmë gjërat siç i pëlqejnë Perëndisë, mund të ndihemi të fokusuar në atë që është më e rëndësishme. A po i bën gjërat siç të pëlqen ty apo siç i pëlqen Perëndisë?

Ose ndoshta je ulur këtu sot dhe e di si të bëhesh i krishterë, por nuk dëshiron ta marrësh këtë vendim. Ndoshta ende po përpiqesh të jesh mjaft i "mirë" që të arrish vetë në qiell. Le t'i themi edhe njëherë vargjet nga Efesianëve 2:8-9. *Kërkoju nxënësve të recitojnë Efesianëve 2:8-9.* Dhe, le të sigurohemi se e ke kuptuar se çfarë do të thotë të kesh besim në Jezusin. Shpalle Ungjillin me Librin pa fjalë. A do të dëshironte ndonjëri ta merrte vendimin për të pasur besim në Jezusin sot? Merri këta nxënës mënjanë ose jashtë klasës që të përsërisni fletushkën 'E beson apo jo', për t'u siguruar që e kuptojnë Ungjillin. Pastaj, drejtoji nxënësit që duan të ndjekin Krishtin, në një lutje, duke i kërkuar Jezusit të falë mëkatet e tyre dhe ta bëjnë Atë udhëheqësin e jetës së tyre.

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Sa gjuhë flisnin njerëzit nga koha e krijimit deri në kohën pas përmbytjes? (Një.)
2. Cilat janë dy arsyet përse njerëzit ndërtuan një qytet? (Të bënin emër dhe që të mos shpërndaheshin nëpër tokë.)
3. Emrin e kujt duhet të duam të lartësojmë? (Emrin e Perëndisë.)
4. Ku dëshironte Perëndia të jetonin njerëzit? (Nëpër të gjithë botën.)
5. Përse donin njerëzit të ndërtonin një kullë aq të lartë? (Për të arritur qiejt.)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Cila është mënyra e Perëndisë, mënyra e vetme, që njerëzit të shkojnë në qiell? (Duke pasur besim në Jezusin për të të shpëtuar nga mëkati dhe duke e bërë Atë udhëheqësin e jetës sate.)
7. Si i ndaloi Perëndia njerëzit që të mos ndërtonin qytetin dhe kullën e lartë? (Ai i bëri të flisnin gjuhë të ndryshme që të mos e kuptonin njëri-tjetrin, dhe i shpërndau nëpër të gjithë botën.)
8. Edhe pse njerëzit zgjodhën të jetonin siç u pëlqente atyre, a u plotësua gjithsesi plani i Perëndisë? (Po.)
9. Cila është fjala e veçantë që mësuam, e cila do të thotë se Perëndia e ka të gjithë fuqinë? (Sovran.)
10. A do të jetosh siç i pëlqen Perëndisë dhe jo siç të pëlqen ty?

Mësimi 8

Zanafilla 12:1-10, 13:1-18

Kupto si duhet:	Abrami dhe Loti ndajnë tokën.
Mendo si duhet:	"dhe: 'Duaje Zotin, Perëndinë tend, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde dhe me gjithë forcën tënde!' Ky *është* I pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: 'Duaje të afërmin tënd porsi vetveten'. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këto." Marku 12:30-31 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do ta dua Perëndinë dhe të tjerët.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i dashur kur dua Perëndinë dhe të tjerët.

PËRGATITU!

Në një botë të fiksuar me ndjenjat, është e rëndësishme që ne të kuptojmë se "të duash" nuk është thjesht një ndjenjë; është gjithashtu një folje – një folje vepruese. Kur ne zgjedhim të duam Perëndinë dhe të tjerët, mund të ndihemi të dashur. Ndërsa lexojmë pjesën nga Shkrimi për këtë javë dhe planin e mësimit, le të lutemi që do të gjejmë mënyra për të dashur Perëndinë dhe të tjerët, në mënyrë të qëllimshme dhe të vërtetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: Lutu që prindërit do të kuptojnë vlerën e faktit që fëmijët e tyre e njohin Fjalën e Perëndisë. Lutu gjithashtu që nxënësit tanë do të kuptojnë më thellë dashurinë e Perëndisë përmes këtij mësimi.

Lexo: Zanafilla 12:1-10; 13:1-18

Kupto si duhet: Abrami dhe Loti ndajnë tokën
Plani i Perëndisë vazhdoi me një njeri të quajtur Abram. Perëndia i tha Abramit të linte vendin e tij, popullin e tij dhe shtëpinë e babait të tij, e të shkonte në një vend që Perëndia do t'i tregonte. Perëndia i premtoi gjithashtu Abramit se do të ishte një bekim dhe se do të merrte bekime. Meqenëse Abrami kishte besim te Perëndia, ai iu bind dhe shkoi. Mori edhe gruan e tij, Sarain e nipin e tij, Lotin. Kur arritën në këtë vend të ri, të quajtur Kanaan, ndodhën telashe. Si Abrami, ashtu edhe Loti kishin tufa dhe kope të mëdha, të cilat shkaktuan konflikt midis barinjve të tyre. Toka nuk do t'i mbante të dy nëse do të jetonin së bashku, kështu që Abrami i dha Lotit të zgjidhte se cilën tokë të merrte. Loti zgjodhi me egoizëm atë që dukej si toka më e mirë dhe Abrami mori pa egoizëm atë që kishte mbetur. Altruizmi i Abramit tregoi dashurinë e tij për Perëndinë dhe për Lotin. Perëndia e bekoi Abramin duke i dhënë të gjithë vendin atij dhe familjes së tij përgjithmonë. Kjo tokë një ditë do të quhej Izrael. Shembulli i Abramit dhe besnikëria e Perëndisë na inkurajojnë ta duam Perëndinë dhe të tjerët.

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:
Besëlidhja e Perëndisë me Abramin, te Zanafilla 15, është fokusi i mësimit të javës që vjen. Këtë javë, duhet të theksosh premtimin e përgjithshëm të Perëndisë ndaj Abramit te Zanafilla 12:2-3 (më poshtë), në mënyrë që t'i përgatisësh nxënësit për javën e ardhshme. Për shkak të kësaj, sugjerojmë që të lexosh edhe nga mësimi i javës së ardhshme, në mënyrë që të përgatitesh më mirë për këtë javë.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:
1. Bëni një skicë të trupave të Abramit dhe Lotit në letër. Ngjiteni letrën në mur. Ndërsa jep mësimin, nxiti studentët të mendojnë për fjalët që i përshkruajnë të dy. Shkruaji fjalët në trupat e tyre ndërsa jep mësimin. Në fund të mësimit, pyeti nëse janë më shumë si Abrami apo si Loti.
2. Shtroni një fletë kafe dhe jeshile pranë njëra-tjetrës në klasë. Shto reliev duke krijuar kodra me gazeta të mbushura poshtë fletës. Përdor figura dhe dele plastike për të përfaqësuar Abramin, Lotin dhe familjet e tyre, dhe vendosi midis dy fletëve. Kjo duhet

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

të përfundohet paraprakisht, në mënyrë që nxënësit ta shohin ndërsa hyjnë në klasë. Nxiti nxënësit të hamendësojnë se për çfarë bëhet fjalë në mësim përpara se të filloni.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Faktori dashuri!

Qëllimi: T'i sfidojmë nxënësit të shqyrtojnë sesa shumë "**dashuri**" kanë për njëri-tjetrin.

Aktiviteti 1: Stacioni i misionit **-** *Mësimi i misionit mund të gjendet në dosjen e kurikulës të vitit të 1-rë, tremujori i 1-rë.*

Aktiviteti 2: Stacioni i artit

Mjetet:

- Kartonët e aktivitetit, të cilat kanë të shkruar me shkronja të mëdha vargun nga Marku 12:30 (nga një nxënës) (burim i printueshëm)
- Mjete zbukuruese (nuk duhet të ketë shumë, sepse nxënësit mund t'i ndajnë me njëri-tjetrin); si ide mund të jenë: – ngjitës i bardhë dhe ngjitës tub – xixa dhe zbukurime të tjera për t'i mbushur shkronjat – forma, apo letra me ngjyra dhe figura – bojëra dhjami dhe/ose lapustila
- Ventilator ose tharëse flokësh (për t'i tharë punimet më shpejt)
- Etiketa shpërblyese
- Posteri shembull

Shënimi i mësuesit kryesor: Është e rëndësishme që të vëzhgosh me kujdes nëse nxënësit po i ndajnë mjetet me njëri-tjetrin. Shkalla në të cilën ata ndajnë me njëri-tjetrin tregon "**faktorin e dashurisë**" mes tyre. Ky ilustrim do të bëjë lidhjen e përsosur me mësimin.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit të garojnë për të krijuar një projekt arti të shkëlqyer për galerinë e artit.
2. Tregoju se fituesi i konkursit të artit do të marrë dhjetë etiketa shpërblyese.
3. Shpjegoju se duhet t'i mbushin letrat dhe të zbukurojnë posterin e vargut nga Marku 12:30.
4. Inkurajoji nxënësit gjatë aktivitetit që t'i tregojnë **dashuri** njëri-tjetrit, duke ndarë gjërat me njëri-tjetrin.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

5. Gjykoni punimet dhe shpërble me dhjetë etiketa shpërblyese fituesin dhe gjithashtu jepi dhjetë etiketa shpërblyese nxënësit që tregohet më bujar dhe shfaq më shumë dashuri në sjellje.
6. Përdor ventilatorin ose tharësen e flokëve për të shpejtuar procesin e tharjes.
7. Pasi posteri të jetë tharë, vareni në galerinë e artit.
8. Lërini posterat aty për disa javë, pastaj jepuani me vete në shtëpi. (Sigurohu që emrat e nxënësve të jenë shkruar qartë te projektet.)

Aktiviteti 3: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Dezinfektues duarsh
- Biskota të mëdha (vendosur në pjata plastike; nga një biskotë e madhe për çdo grup me nga katër nxënës)
- Pjata të vogla plastike
- Peceta
- Krem pastiçerie
- Thika plastike
- Përbërës zbukurues

Shënim për mësuesin kryesor: Është e rëndësishme që të vëzhgosh me kujdes nëse nxënësit po tregojnë **dashuri** ndaj dikujt, edhe nëse nuk është i pranishëm. Shkalla në të cilën ata ndajnë me njëri-tjetrin tregon si është **"faktori i dashurisë"** mes nxënësve. Ky ilustrim do të bëjë lidhjen e përsosur me mësimin.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra me nga katër anëtarë.
2. Sigurohu që të gjithë nxënësit të lajnë apo dezinfektojnë duart mirë para se të filloni.
3. Jepi secilës skuadër një biskotë të madhe.
4. Informoji që do të garojnë në skuadra, ku do të shihet se cila skuadër mund të dekorojë më bukur biskotën e madhe, dhe ata duhet ta dekorojnë si skuadër. Skuadra fituese do të marrë pesë etiketa shpërblyese për secilin anëtar.
5. Pasi të gjykohet pamja e biskotave, kërkoju nxënësve ta ndajnë biskotën, që të marrin secili anëtar nga pak. Shiko me kujdes nëse do ta ndajnë në mënyrë të barabartë. Pasi të përfundojnë me ndarjen e biskotës, informoji se harrove t'i lajmërosh që biskotat duhet t'i ndanin me_____ (ndihmësit, fëmijët e grupit të parashkollorëve etj.)! Sigurohu më parë që mund t'i ndani biskotat me atë grup.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

6. Vështro me kujdes për të kuptuar nëse nxënësit janë të gatshëm ta ndajnë biskotën në përmasa të barabarta, apo nëse nuk janë të gatshëm.
7. Pasi të ndahet biskota në pjesë dhe të vendoset në një tabaka, nxënësit mund të hanë pjesën e mbetur të biskotave të tyre.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Gara e sotme ishte shumë argëtuese! Kush fitoi? A e dini se po ju shikoja ndërsa garonit, duke parë nëse kishte nxënës që i tregonin dashuri njëri-tjetrit? Nuk po flas thjesht për dhënien e përqafimeve dhe puthjeve. Unë po kërkoja nxënës që ishin të hapur për të ndarë, që kishin bashkëpunim të mirë, që kujdeseshin për të tjerët edhe ndërsa argëtoheshin duke garuar. *Mësues, ndihuni të lirë t'u shpërndani etiketa shpërblyese nxënësve që shfaqën "faktorin e dashurisë" gjatë aktivitetit të KZ-së.*

Shënim: Nëse KZ-në e keni zhvilluar në Stacionin e misionit, ju lutem zhvilloni një lidhje me mësimin nga Bibla.

Bibla na thotë të duam Perëndinë dhe të tjerët. Kjo nuk është gjithmonë e thjeshtë! Në mësimin e ditës së sotme, do të zbulojmë një person që e donte Perëndinë dhe të tjerët.

Lutu: Përse dikush do të donte të ngrihej dhe të drejtonte klasën në lutje? Sepse është një nder të drejtojmë klasën në lutje! Personi që lutet është si dirigjenti i një orkestre, i cili na mundëson të lutemi në një zë.

Zbuloje: A është Zanafilla në DH.V. apo në DH.R.? (DH.V.) Le t'i hapim Biblat te libri i Zanafillës, kapitulli 12.

Kronologjia: Javën e kaluar mësuam për kullën e Babelit. A mund ta gjeni kullën e Babelit te kronologjia?

Prezantimi me mësimin nga Bibla: Le të shohim edhe njëherë kronologjinë e Biblës për t'u kujtuar se çfarë kemi mësuar në studimin e Zanafillës. ***Shënim për Bariun****: Trego mësimin te kronologjia ndërsa nxënësit përsërisin lëvizjet e 'Flasim rreth Zanafillës' me mësuesin kryesor.*

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës

Këtë javë....

- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini

Argëtohuni duke garuar për të parë se kush i bën lëvizjet më shpejt!

Njerëzit që jetuan gjatë kësaj kohe ishin familjet e bijve të Noeut, Semit, Kamit dhe Jafetit. Familjet e tyre vazhduan të rriten. Ata ishin personat që donin të ndërtonin qytetin me një kullë. Çfarë bëri Perëndia për t'i ndaluar njerëzit të mos ndërtonin kullën e Babelit? (Ai i bëri të flisnin gjuhë të ndryshme dhe i shpërndau në të gjithë botën.)

Sot do të flasim për një njeri shumë të veçantë që vinte nga familja e Semit. Emri i tij ishte Abram, dhe ai lindi qindra vite pas përmbytjes. Ja çfarë ndodhi me Abramin kur ishte 75 vjeç.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 12:1-10; 13:1-18

Perëndia thërret Abramin

Lexo: Zanafilla 12:1

Përmbledhje: Perëndia i tha Abramit ta linte vendin e tij, popullin e tij dhe shtëpinë e babait të tij dhe të shkonte në një tokë të cilën Perëndia do t'ia tregonte. A të duket diçka e madhe kjo? Po sikur Perëndia të të thoshte ty të lije shtëpinë e prindërve, të lije pothuajse çdokënd që njihje dhe të shkoje në një vend që Ai do të ta tregonte, por të mos e dije se cili vend ishte ai? A duket tani si diçka e madhe? A do të kishe frikë t'i bindeshe Perëndisë? Mendoj se me shumë mundësi, po!

Dëgjo se çfarë i tha tjetër Perëndia Abramit.

Perëndia i premtoi Abramit se do të ishte bekim dhe do të merrte bekime

Lexo: Zanafilla 12:2-3

Përmbledhje: Çfarë i premtoi Perëndia Abramit se do të bënte prej tij? (Një komb.) Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se Abrami do të kishte një familje aq të madhe, saqë do të bëhej një komb i tërë! I bie të jetë vërtet e madhe!

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Dhe Perëndia tha se Ai do ta bekonte Abramin, dhe si do ta bënte emrin e Abramit? (Të madh.) Kjo do të thotë se Abrami do të ishte i veçantë dhe shumë njerëz do të dinin se kush ishte ai! Perëndia i tha Abramit se ai do të ishte një bekim për të gjithë njerëzit në tokë! Ai i tha gjithashtu se do të bekonte ata që bekonin Abramin dhe do të mallkonte ata që e mallkonin. Për ta përmbledhur, Perëndia i premtoi Abramit se ai do të ishte një bekim dhe se do të merrte bekime.

A e di se çfarë është një bekim? (Është një favor apo dhuratë nga Perëndia.) Çfarë mendoni se bëri Abrami?

Abrami i bindet Perëndisë

Parafrazim i Zanafilla 12:4-10:

Abrami mori gruan e tij Sarain, nipin e tij Lotin dhe gjithçka që ata kishin, dhe shkoi në tokën që Perëndia u kishte treguar në Kanaan. *Tregoje te harta e kohës biblike.*

A iu bind Abrami Perëndisë? (Po.) Bibla na thotë se ne e duam Perëndinë duke iu bindur urdhërimeve të Tij (1 e Gjonit 5:3). Le ta themi edhe njëherë vargun e 'Mendo si duhet'. *Recitoni Markun 12:30-31*. Pjesa e parë e vargut thotë se duhet të bëjmë çfarë? (Të duam Perëndinë.) A e donte Abrami Perëndinë? (Po.) Çfarë thotë pjesa e dytë e vargut? (Duaje të afërmin si vetveten.) Le të shohim nëse Abrami e bëri këtë!

Vendi nuk ishte në gjendje të mbante Abramin dhe Lotin

Parafrazim i Zanafilla 13:1-7:

Kujtoni që Abrami mori nipin e tij Lotin me vete kur u largua nga shtëpia. Abrami ishte bërë i pasur – kishte shumë ar dhe argjend, shërbëtorë, dele, bagëti, gomarë dhe deve. Edhe Loti kishte shumë kafshë. Kishin kaq shumë kafshë, saqë barinjtë që kujdeseshin për kafshët filluan të debatonin për tokën. Dëgjo se çfarë i tha Abrami Lotit.

Abrami lejon Lotin të zgjedhë se ku dëshiron të jetojë

Lexo: **Zanafilla 13:8-9**

Përmbledhje: Abrami nuk u tregua egoist dhe lejoi Lotin të zgjidhte se ku donte të jetonte. Abrami mundi të ishte aq altruist, sepse i besonte shumë Perëndisë. Altruizmi i Abramit tregoi se ai e donte Perëndinë dhe donte edhe Lotin. Cilën tokë mendoni se zgjodhi Loti?

Loti zgjedh tokën më të mirë për veten

Lexo: Zanafilla 13:10-12

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Cilën tokë zgjodhi Loti për vete? (Toka që dukej më e mirë për të.) A po tregohej Loti egoist apo altruist? (Egoist.) Veprimet e njerëzve shpeshherë tregojnë çfarë ka në zemrat e tyre. Kur Abrami lejoi Lotin të zgjidhte, ai po tregonte se i besonte Perëndisë se do të kujdesej për të, jo gjërave që zotëronte.

Shënimet e mësuesit kryesor: *2 e Pjetrit 2:7 e quan Lotin njeri të drejtë, i cili mundohej nga sjellja imorale e të çoroditurve, dhe ky varg na thotë se Loti kishte besim shpëtues, pavarësisht egoizmit që shfaq në mësimin e kësaj jave.*

Po ti? A je egoist apo jo? *Ndalu dhe referoju Kohës së zbulimit.* A përpiqesh të fitosh më të mirën për vete? A është mëkat të jesh egoist? (Po.) A të kujtohet një rast kur je treguar egoist? Po altruist? *Lejoji nxënësit të ndajnë shkurtimisht.*

Duket se Loti zgjodhi tokën më të mirë për të jetuar vetë, apo jo? Por kujto diçka – Abrami e donte Perëndinë dhe i bindej. Kur e do dhe i bindesh Perëndisë, Ai kujdeset gjithmonë për ty. Le të shohim se çfarë ndodhi me Abramin dhe Lotin.

Loti zgjedh një tokë ku njerëzit janë të këqij

Lexo: **Zanafilla 13:13**

Përmbledhje: Po tani, a ju duket e mirë toka që zgjodhi Loti? (Jo!) Përse? (Sepse ishte plot me njerëz që jetonin në ligësi.) Po toka në të cilën do të jetonte Abrami? Le të zbulojmë më shumë rreth saj.

Perëndia do t'i japë Abramit dhe familjes së tij tokën e Kanaanit

Lexo: **Zanafilla 13:14-18**

Përmbledhje: Perëndia do t'ia jepte gjithë këtë tokë Abramit. Kjo tokë do të quhej një ditë Izrael!

Përfundimi

Edhe pse duket sikur Loti zgjodhi tokën më të mirë për të jetuar, Perëndia premtoi se do ia jepte tokën e Kanaanit Abramit dhe familjes së tij. Bibla thotë se Kanaani ishte një tokë ku buronte qumësht dhe mjaltë. Ishte një tokë shumë e mirë. Abrami e donte Perëndinë dhe të tjerët, dhe Perëndia u kujdes për të. Jo vetëm kaq, por pastaj Loti humbi edhe tokën e tij kur Perëndia e shkatërroi për shkak se njerëzit që jetonin atje ishin kaq mëkatarë.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kur ne bëhemi egoistë dhe përpiqemi të marrim më të mirën për vete, nuk fitojmë kurrë. Por kur duam Perëndinë dhe të tjerët, Ai do të na japë atë që është më e mira për ne. A do të ndjekësh shembullin e Abramit duke dashur Perëndinë dhe të tjerët? Le të ndalemi dhe të mendojmë për mënyrat si mund ta vëmë këtë mësim në praktikë dhe se si mund të veprojmë si duhet, bazuar në ato që njohim dhe mendojmë.

Nëse vërtet dëshiron të duash Perëndinë dhe të tjerët, gjëja e parë që duhet të bësh është t'i besosh Birit të Tij, Jezusit, për faljen e mëkateve të tua dhe ta bësh Atë udhëheqësin e jetës sate. Kur beson në Jezusin për shpëtim nga mëkati, bëhesh pjesë e familjes së Perëndisë! Nëse nuk e ke marrë vendimin për t'i besuar Atij, mund ta bësh sot. Si beson në Jezusin? Do të ta tregoj. *Prezantoje Ungjillin duke përdorur Librin pa fjalë. A dëshiron ndonjëri prej jush të lutet, t'i kërkojë Jezusit falje për mëkatet dhe ta bëjë Atë Udhëheqësin e jetës së vet? Merrini këta nxënës në një vend të qetë, siç mund të jetë korridori, për t'u shpjeguar shpëtimin duke përdorur Librin pa fjalë ose fletushkën "E beson apo jo". Nëse zgjedhin, drejtojini në lutjen e shpëtimit.*

Të flasim rreth Zanafillës me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Çfarë i tha Perëndia Abramit të bënte? (Të linte vendin, popullin e tij dhe shtëpinë e babait të tij dhe të shkonte në një vend që Perëndia do t'ia tregonte.)
2. Çfarë i premtoi Perëndia Abramit? (Ai do të ishte një bekim dhe do të merrte bekime.)
3. A iu bind Abrami Perëndisë dhe a shkoi në tokën që Perëndia do t'i tregonte? (Po.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Përse duhet ta ndanin tokën Abrami dhe Loti? (Ata duhet ta ndanin sepse kishin shumë kafshë dhe barinjtë e tyre filluan të debatonin.)
5. Përse e la Abrami Lotin të zgjidhte tokën që donte? (Abrami i besoi Perëndisë dhe ai e donte edhe Perëndinë, edhe Lotin.)
6. Cilën tokë zgjodhi Loti? (Tokën që i dukej më e mira.)
7. Çfarë ndodhi me tokën e Abramit? (Perëndia e bekoi.)
8. Çfarë ndodhi me tokën e Lotit? (Ai e humbi kur Perëndia e shkatërroi për shkak se njerëzit ishin shumë mëkatarë.)
9. A do ta duash Perëndinë dhe të tjerët?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 9
Zanafilla 15:1-18

Kupto si duhet:	Perëndia bën një besëlidhje me Abramin.
Mendo si duhet:	"Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend." Gjoni 14:2 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të besoj premtimet e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i emocionuar për premtimet e Perëndisë.

PËRGATITU!

Fjala "premtim" e ka humbur rëndësinë e vet në kulturën tonë, sepse premtimet thyhen vazhdimisht. Por Perëndia është premtimmbajtësi i përjetshëm. Nuk duhet të dyshojmë kurrë që Ai do të bëjë atë që Ai thotë se do të bëjë. Ne mund ta vendosim besimin tonë tek Ai dhe të pushojmë në faktin se secili prej premtimeve të Tij do të plotësohet pa dyshim. Le të mendojmë rreth kësaj, ndërsa studiojmë pasazhin e Shkrimit dhe planin e mëposhtëm mësimor.

Lutu: Lutu që nxënësit të varen te Perëndia dhe t'i besojnë premtimeve të Tij në çdo stinë të jetës së tyre. Lutu gjithashtu që ata të kenë mençuri për të përdorur vargjet që kanë mësuar përmendsh në situatat e tanishme dhe në të ardhmen.

Lexo: Zanafilla 15:1-18

Kupto si duhet: Perëndia bën një besëlidhje me Abramin
Pasi Abrami arriti në Kanaan, Perëndia i foli përmes një vizioni dhe i shpjegoi më tepër rreth premtimit të Tij të veçantë, të quajtur besëlidhje. Edhe pse Abrami ishte i vjetër dhe nuk kishte fëmijë, Perëndia i premtoi se një bir do të vinte nga vetë trupi i tij. Ai i tha gjithashtu Abramit se do të kishte po aq pasardhës sa ka yje në qiell. Këtyre pasardhësve do t'u jepej toka e Kanaanit për të jetuar në të. Por, para kësaj, ata do të skllavëroheshin në një vend të huaj dhe do të keqtrajtoheshin për katërqind vite. Pas kësaj, ata do të largoheshin nga ai vend me të mira të shumta. Ashtu si Perëndia ia premtoi të gjitha këto Abramit, Ai u premton jetë të përjetshme edhe atyre që besojnë në Birin e Tij, Jezusin, për të na shpëtuar nga mëkati. Abrami besoi në atë që Perëndia i kishte premtuar. Besofshim edhe ne gjithmonë në premtimet e Perëndisë!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Përfshije drejtuesin e KZ-së ose Bariun, duke iu caktuar një pjesë të mësimit paraprakisht; kërkoju të lexojnë me një tonalitet specifik, merrni mjete specifike për mësimin ose vizatoni sipas nevojës.
- Këshillë për vizitorët: Nëse keni Bibla për vizitorët, shëno librin dhe kapitullin me një shënues libri. Kjo do të eliminojë ndjesinë e "të mos diturit", ndërkohë që nxënësit po hapin Biblat e tyre.
- Shumë prej nxënësve u janë bërë premtime dhe pastaj nuk janë përmbushur. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për t'iu treguar që, edhe pse në kulturën e sotme koncepti i "premtimit" nuk merret shumë seriozisht, Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij.
- Për më tepër informacion rreth Abrahamit, lexo Romakëve 4:1-25, Galatasve 3:1-25, Hebrenjve 6:13-20 dhe Hebrenjve 11:8-12.

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Ndërsa shpjegon, kërkoju nxënësve të ngrihen në këmbë, t'i bien një zileje ose të hidhen sa herë që thua fjalën "premtim".

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Gjuetia e zbuluesve të yjeve!

Qëllimi: T'u mësojmë nxënësve kuptimin e një premtimi.

Aktiviteti 1: Stacioni i LEGO-ve

Mjetet:

- Fusha jeshile e legove (nga një për çdo nxënës)
- Shembull i një fushe jeshile të mbushur me yje
- Etiketa shpërblyese

Udhëzimet e drejtuesit të KZ-së:

1. Jepi secilit nxënës nga një fushë jeshile legosh.
2. Sfidoji nxënësit të krijojnë sa më shumë yje të verdhë me legot në fushat e tyre, brenda kohës së lejuar.
3. Premto që personi i cili bën më shumë yje, do të fitojë dhjetë etiketa shpërblyese.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

4. Përgjatë aktivitetit, thekso fjalën “**premtim”**.
5. Në fund të aktivitetit, kërkoju nxënësve të numërojnë yjet dhe jepi dhjetë etiketa shpërblyese fituesit – siç kishe **premtuar**!
6. Ndërsa përmbyllni KZ-në, kërkoju nxënësve të hamendësojnë arsyen përse kanë bërë aq shumë yje sot.

Aktiviteti 2: Hapësirë e caktuar në klasën e fëmijëve

Mjetet:

- Një listë me yje të shënuar nga 1-shi te 7-ta, ku pranë secilit gjendet një kuti bosh (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Lapsa me gomë
- Shtatë yje të verdhë prej letre, secili prej tyre me kodet të shkruara mbi të: 1-e, 2-p, 3-t, 4-m, 5-i, 6-r, 7-m
- Një shembull të yjeve të verdhë prej letre (që t’u tregosh nxënësve se çfarë duhet të kërkojnë)
- Biskota të vogla në formën e yjeve ose të dekoruara me yje (nga një për çdo nxënës; të vendosura në një vend të caktuar)
- Muzikë

Udhëzime për ambientin: Caktoji paraprakisht zonat ku do të fshehësh yjet

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Shpërndaj listat me yjet dhe lapsa për të gjithë nxënësit.
2. Sfidoji nxënësit të gjejnë yjet e verdhë (jep shembuj) që janë fshehur në vende të caktuara.
3. Kur të gjejnë një yll të verdhë, duhet të shënojnë shkronjën që gjendet tek ylli, pranë numrit që i takon në fletë (shih kodin sipër – shkronjat formojnë fjalën “**premtim”**) U lejohet t’i krahasojnë letrat e tyre me njëri-tjetrin, në mënyrë që ta ndihmojnë njëri-tjetrin të mbarojnë më shpejt.
4. **Premtoju** nxënësve që nëse i plotësojnë saktë të gjitha hapësirat në fletët e tyre dhe formojnë saktë fjalën, mund të shkojnë te vendi i caktuar për biskotat, në mënyrë që të hanë një prej tyre.
5. Thuaj: “Nisuni!” për të filluar kërkimin e yjeve. Ndiz muzikën!
6. Kur të jeni afër fundit, drejtuesit mund të duhet t’i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë përgjigjen.
7. Në fund të zbulimit, ndalo muzikën dhe çoji të gjithë nxënësit që i kanë zbuluar fjalët te vendi i caktuar ku do të marrin biskotën.



Aktiviteti 3: Zonë e caktuar në hapësirën e fëmijëve

Mjetet:

- Copa letre boshe ose kartonë të vegjël (nga një për çdo nxënës)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Lapsa me gomë (nga një për çdo nxënës)
- Shtatë yje prej letre të bardhë, ku në secilin janë këto shkronja: P, R, E, M, T, I, M
- Një shembull i një ylli prej letre të bardhë (për t'u treguar nxënësve se çfarë të kërkojnë)
- Biskota të vogla në formë yjesh, ose të dekoruara me yje (nga një për çdo nxënës; të vendosura në një vend të caktuar)
- Muzikë

Udhëzim për ambientin: Caktoje paraprakisht zonën ku do të fshehësh yjet

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaju nxënësve letra dhe lapsa.
2. Sfidoji të gjejnë yjet e bardha (tregoju shembullin) që janë fshehur në zonat e caktuara.
3. Kur nxënësit të gjejnë një yll të bardhë, duhet të shënojnë shkronjën në letrat e tyre. Informoji që duhet të gjejnë të shtatë yjet me shkronjat përkatëse. Në fund të letrës së tyre do të formojnë një fjalë.
4. Tregoju nxënësve që nëse e gjejnë fjalën, mund të shkojnë te vendndodhja e caktuar për të ngrënë diçka në fund të kërkimit të tyre.
5. Thuaj "Nisu!" për të filluar kërkimin e yjeve. Ndiz muzikën!
6. Mos e thekso shumë fjalën "**premtim**" në fillim të kërkimit, sepse nxënësit mund ta kuptojnë kodin shumë shpejt. Nëse po u mbaron koha dhe nxënësit akoma nuk e kanë zbuluar fjalën, mund t'u kujtosh se u "**premtove**" një ushqim special.
7. Në fund të kërkimit të yjeve, ndalo muzikën dhe çoji të gjithë nxënësit që kanë zbuluar fjalën te vendi i caktuar ku do të marrin një biskotë.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin:
Stacioni i LEGO-ve: Sa yje formuat me legot? Kush e fitoi garën? *Pyet fituesin*: A t'i dha drejtuesi i KZ-së etiketat shpërblyese që të premtoi? Sa yje mendon se ka në univers? Ja një mister/gjëegjëzë: Çfarë kanë të përbashkët fjalët "yll" dhe "premtim"? Do ta zbuloni në mësimin nga Bibla!
Të gjitha stacionet e tjera: A i shijuat biskotat? Jam i gëzuar që drejtuesi i KZ-së e mbajti premtimin! Sa yje gjetët? Sa yje mendoni se ka në univers? Ja një mister/gjëegjëzë: Çfarë kanë të përbashkët fjalët "yll" dhe "premtim"? Do ta zbuloni në mësimin nga Bibla!

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lutu: A e dini se Perëndia i universit na dëgjon kur lutemi? Është e mrekullueshme që mund ta nisim mësimin duke folur me Perëndinë para se ta dëgjojmë, ndërsa studiojmë Fjalën e Tij. Kush do të donte të drejtonte klasën në lutje sot?

Zbuloje: Sot do të studiojmë kapitullin 15 në librin e Zanafillës. A është Zanafilla në DH.V. apo në DH.R.? (DH.V.) A mund t'i përmendë dikush librat e Dhiatës së Vjetër?

Kronologjia: Ku është Zanafilla në kronologjinë tonë? Le të rishikojmë lëvizjet e 'Flasim rreth Zanafillës' deri te mësimi i sotëm:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini

Prezantimi me mësimin nga Bibla: *Përdor kronologjinë e Biblës për të përforcuar pamjen e madhe të Zanafillës.* Le të rikujtojmë njerëzit për të cilët kemi mësuar që kur ka filluar tremujori. Dua të plotësoni vendet bosh. Nëse jepni një përgjigje të saktë, fitoni një etiketë shpërblyese.

1. Njeriu i parë që krijoi Perëndia quhej _____. (Adam.)
2. Dy bijtë e parë të Adamit dhe Evës quheshin_____ dhe _____. (Kain dhe Abel.)
3. Kaini vrau Abelin, prandaj Perëndia e largoi Kainin nga shtëpia e tij. Pas kësaj, Adami dhe Eva patën një djalë të quajtur _____. (Seth.)
4. Njeriu që ndërtoi arkën vinte nga familja e Sethit. Emri i tij ishte _____. (Noe.)
5. Tre djemtë e Noeut quheshin _____, _____ dhe _____. (Sem, Kam dhe Jafet.)
6. Njeriu për të cilin mësuam javën e kaluar ishte nga familja e Semit. Perëndia i kërkoi të linte vendin e tij, njerëzit edhe shtëpinë e atit të tij dhe të shkonte në një vend në të cilin Perëndia do ta dërgonte. Ai quhej _____. (Abram.)
7. A ju kujtohet premtimi që i bëri Perëndia Abramit? (Ai do të ishte një bekim dhe do të merrte bekime.)
8. Çfarë është një bekim? (Një favor apo dhuratë nga Perëndia.)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Do të shohim nga afër premtimin e veçantë që i bëri Perëndia Abramit. Pasi Abrami dhe Loti ndanë tokën, kishte luftë. Ushtarët e armikut zunë rob Lotin dhe familjen e tij, dhe Abrami e shpëtoi me trimëri.

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 15:1-18

Perëndia i bën Abramit një premtim të veçantë

Lexo: Zanafilla 15:1-3

Përmbledhje: Uau! A e imagjinon të të thotë Perëndia: "Unë jam mburoja jote, shpërblimi yt i madh"? Edhe pse Perëndia i tha këtë Abramit, Abrami nuk ishte shumë i duruar. Për shkak se nuk kishte fëmijë, Abrami mendoi se djali i shërbëtores së tij do të ishte trashëgimtari i tij. Trashëgimtari është personi që merr paratë dhe gjërat e tua, kur ti vdes.

Lexo: Zanafilla 15:4-5

Përmbledhje: Ky premtim që Perëndia i bëri Abramit ishte shumë i veçantë. Quhet besëlidhje. Çfarë i premtoi Perëndia Abramit? (Ai do të kishte një bir.) Sa njerëz do të lindnin nga familja e Abramit? (Aq sa ka yje ka në qiell.)

A e dije se astronomët kanë përllogaritur se ka mbi 100 miliard yje vetëm në galaksinë tonë? (*Shënim: Kush i krijoi të gjitha yjet? Zanafilla 1:1*) Si mund t'i numërojë dikush të gjitha yjet në qiell? Çfarë premtimi po i bënte Perëndia Abramit? Që, edhe pse Abrami ishte më tepër se 75 vjeç dhe nuk kishte ende fëmijë, familja e tij do të ishte e stërmadhe! A mendoni se Abrami i besonte Perëndisë? Le ta zbulojmë.

Abrami i beson Perëndisë

Lexo: Zanafilla 15:6

Përmbledhje: Abrami i besoi Perëndisë! Çfarë do të thotë kur thuhet se Perëndia ia llogariti Abramit për drejtësi? Do të thotë se Abrami ishte i drejtë para Perëndisë – mëkatet i ishin falur – për shkak se kishte besim në Perëndinë dhe në Shpëtimtarin që Perëndia do të dërgonte një ditë!

Por, nëse familja e Abramit do të ishte kaq e madhe, ku do të jetonin ata? Gjejeni pak se çfarë i premtoi tjetër Perëndia Abramit?

Perëndia premton gjithashtu se do t'i jepte Abramit dhe familjes së tij tokën e Kanaanit

Lexo: Zanafilla 15:7

Përmbledhje: Perëndia premtoi se do t'i jepte Abramit dhe familjes së tij tokën e Kanaanit.

***Shënim për mësuesin kryesor**: Pjesa tjetër e mësimit është për fëmijët më të rritur, nga klasa e 3-të e sipër, për shkak se është më e thellë. Nxënësit më të vegjël mund të kalojnë te përfundimi dhe te përsëritja e Ungjillit.*

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Por Abrami kishte një pyetje.

Abrami dëshiron të sigurohet se do ta marrë tokën

Lexo: Zanafilla 15:8

Përmbledhje: Çfarë i kërkoi Abrami Perëndisë? (Si mund ta di vërtet se do ta marr tokën?) Abrami mund të ketë menduar me vete: "E po, mirë, ti më largove nga Uri që familja ime të jetonte në këtë tokë, po sikur të mos e marr atë?" Kështu, Perëndia i jep Abramit një shenjë. A dëshironi të dini cila ishte shenja? Le ta zbulojmë.

Perëndia i tregon Abramit se çfarë do të ndodhë në të ardhmen

Lexo: Zanafilla 15:9-11

Përmbledhje: Duket e çuditshme, apo jo? Do të zbulojmë se përse e bëri Abrami këtë gjë. Le të vazhdojmë të lexojmë.

Lexo: Zanafilla 15:12-16

Përmbledhje: Perëndia i tha Abramit se çfarë do të ndodhte me familjen e tij të madhe në të ardhmen. A e gjen dot njeri se për çfarë po fliste Perëndia? A ju kujtohet kur izraelitët u skllavëruan në Egjipt? Pastaj Perëndia dërgoi Moisiun për t'i udhëhequr përmes Detit të Kuq. Më në fund, pas 40 vitesh endjeje në shkretëtirë, Jozueu i udhëhoqi për në Kanaan. Këtë i tha Perëndia Abramit.

Mendo pak, po sikur Perëndia të të thoshte ty se çfarë do t'i ndodhte familjes tënde shumë, shumë vite më vonë? A nuk do të ishte fantastike ta dije?

Por pastaj Perëndia bëri diçka tjetër. Kujtoni që Abrami donte të dinte se si mund të sigurohej se familja e tij do të merrte tokën. A të ka ndodhur që kur ke premtuar diçka me dikë i keni dhënë dorën njëri-tjetrit? *Tregoje me veprime nëse është e nevojshme*. Apo, kur prindërit blejnë diçka dhe përdorin kartën e kreditit, ata firmosin emrin e tyre për të treguar se i premtojnë kompanisë që do t'i marrë paratë?

E po, në kohën e Abramit, njerëzit dakordësonin për mbajtjen e premtimeve në një mënyrë tjetër. Ata ndanin kafshët në dysh, dhe njerëzit që premtonin do të ecnin përmes qendrës së dy gjysmave të kafshës. Ata po thoshin diçka të tillë: "Nëse nuk e mbaj premtimin, edhe unë qofsha prerë në dysh si këto kafshë!" Kjo tregonte se e kishin marrë shumë seriozisht premtimin dhe kjo vuloste marrëveshjen. Prandaj Perëndia i tha Abramit të sillte kafshët dhe t'i ndante në dysh. Por, dëgjo se si ia tregoi Perëndia Abramit që do ta mbante premtimin.

Perëndia garanton premtimin e Tij

Lexo: Zanafilla 15:17-18

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Përmbledhje: Furra që nxjerr tym dhe pishtari i zjarrtë ishin simbol i Perëndisë. Ato tregonin se Perëndia po ecte përmes gjysmave të kafshës së ngordhur. Perëndia po thoshte diçka të tillë: "Abram, nuk do të të takojë ty ta marrësh tokën për familjen. Do ta bëj unë për ty."

Përfundimi

Perëndia do ta mbante premtimin e Tij, pavarësisht gjithçkaje. Dhe kjo është diçka e mirë, sepse javën e ardhshme, do të mësojmë për diçka që bëri Abrami, diçka që nuk duhet ta bënte.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Çfarë do të thotë kjo për ne? Ka një kuptim shumë të rëndësishëm. Çfarë ka premtuar se do të na japë Perëndia kur besojmë në Jezusin për faljen e mëkateve? (Se do të jemi pjesë e familjes së Tij dhe do të kemi jetë të përjetshme me Të; Gjoni 14:2) Le të sigurohemi se të gjithë e kuptojmë çfarë do të thotë t'i besosh Jezusit për faljen e mëkateve. *Shpjego Ungjillin përmes Librit pa fjalë. Merr mënjanë nxënësit që duan për t'u shpjeguar shpëtimin duke përdorur Librin pa fjalë apo fletushkën "E beson apo jo". Drejtoji në lutje ata që vendosin.* Tani, pasi i besojmë Jezusit, a duhet të bëjmë diçka tjetër për të fituar jetën e përjetshme? (Jo!) Perëndia na e ka premtuar dhe Ai do të na e japë siç ka premtuar! Si na e tregon Perëndia se kemi jetën e përjetshme? Ai na jep Frymën e Tij të Shenjtë për të vulosur marrëveshjen! (Efesianëve 1:13) Le të themi edhe njëherë vargun e *Mendo si duhet*. *Recitoni Gjonin 14:2.* A do të besosh në premtimin e Perëndisë? A ndihesh i gëzuar sepse ke jetë të përjetshme në qiell? Duhet të ndihesh ashtu!

Si përsëritje argëtuese, kërkoju dy nxënësve të vijnë përpara dhe të provojnë se kush mund t'i bëjë më shpejt lëvizjet e 'Flasim rreth Zanafillës'.

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini
- **Besëlidhja e Perëndisë**: krijoni me gishta yje të shndritshëm mbi kokë

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Cili ishte problemi i Abramit? (Ai nuk kishte fëmijë.)
2. Çfarë premtoi Perëndia se do t'i jepte Abramit? (Një bir.)
3. Sa njerëz do të ishin në familjen e Abramit? (Aq sa ka yje në qiell.)
4. A besonte Abrami në Perëndinë? (Po.)
5. Ku do të jetonte familja e madhe e Abramit? (Në tokën e Kanaanit që Perëndia do t'u jepte.)
6. A do t'i besosh premtimit të Perëndisë për jetën e përjetshme për këdo që pranon Jezusin si Shpëtimtar?

Për fëmijët nga klasa e 2-të e më të vegjël:
Bëj pyetjet e përsëritjes së *Librit pa fjalë*.

Për klasën e 3-të e më të mëdhenj:
7. Çfarë i tha Perëndia Abramit se do të ndodhte me familjen e tij në të ardhmen? (Ata do të skllavëroheshin në Egjipt, dhe pas kësaj, më në fund do të jetonin në Kanaan.)
8. A u skllavërua familja e Abramit në Egjipt? (Po.)
9. Si ia tregoi Perëndia Abramit se do ta mbante premtimin e Tij, pavarësisht gjithçkaje? (Perëndia eci përmes gjysmave të kafshëve të vdekura.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 10
Zanafilla 16:1 – 18:15

Kupto si duhet:	Abrahami dhe Agari lindin Ismaelin.
Mendo si duhet:	"Ki besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua". Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të mbështetem me durim te Perëndia për gjithçka.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem në paqe kur mbështetem me durim te Perëndia për gjithçka.

PËRGATITU!

Si reagon kur përgjigjja e Perëndisë ndaj kërkesës tënde të lutjes është "Prit!"? A ke paqe kur e di se Ai po orkestron gjërat në prapaskenë për të mirën tënde dhe për lavdinë e Tij, apo tundohesh ta marrësh vetë situatën në kontroll? Është shumë ngushëlluese të kujtosh se Perëndia është në kontroll dhe mund t'i besojmë Atij në të gjitha kohët dhe të gjitha situatat. Konsidero jetën tënde – a të kujtohet ndonjë rast kur Perëndia të ka thënë "Prit", dhe pastaj kuptove se Ai thjesht po i bënte gjërat më të bukura? Ai gjithmonë kujdeset për ne! Le të përgatitemi këtë javë për të shërbyer me paqe, duke ditur se Perëndia po vepron për të mirën tonë ndërsa presim Atë me durim.

Lutu: Lutu që nxënësit të mund të presin me durim Perëndinë edhe në kohët e mira, edhe në kohët e vështira të jetës së tyre.

Lexo: Zanafilla 16:1 – 18:15

Kupto si duhet: Abrahami dhe Agari lindin Ismaelin
Abrami ishte 85 vjeç dhe ende nuk kishte fëmijë. Në vend që të priste me durim Perëndinë që të mbante premtimin e Tij, Sarai e bindi Abramin të kishte një djalë me shërbëtoren e saj egjiptase, Agarin. Agari lindi djalin e Abramit; ai u quajt Ismael. Sapo Agari mbeti shtatzënë, lindi konflikti mes saj dhe Sarait. Ky konflikt ishte pasojë e mungesës së durimit të Abramit dhe Sarait për t'u mbështetur te Perëndia. Perëndia i tha Abramit se Ismaeli nuk ishte biri i premtuar. Për shkak të kësaj, ne mësojmë të mbështetemi me durim te Perëndia për gjithçka.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Shpeshherë nxënësit zemërohen kur Perëndia nuk i përgjigjet menjëherë një kërkese lutjeje. A do të thotë kjo se Perëndia nuk është mjaftueshëm i fuqishëm, se Ai nuk kujdeset, apo se Ai është i zemëruar? Ndihmoji nxënësit të kuptojnë se Perëndia njeh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, dhe shpeshherë kur Ai thotë: "Prit". Ai po shëron, po mëson dhe po na modelon të bëhemi më tepër si Ai.
- Ky është një mësim i gjatë, përshtati pjesët në varësi të moshës dhe parafrazo vargjet sipas nevojës.
- Ky është një mësim me dy pjesë. Lexoji të dyja mësimet paraprakisht (atë të kësaj jave dhe atë të javës tjetër), që të kuptosh si lidhen me njëri-tjetrin.
- Ushqim i shpejtë, internet i shpejtë, e dua *tani*... kjo është kultura në të cilën jetojmë. Si lidhet kjo me mësimin tonë sot? Çfarë po na mëson Perëndia? Çfarë do t'u mësojë Perëndia nxënësve të tu këtë javë për kohën e Tij të përsosur?

Ide krijuese për mësimin nga Bibla: Vizato në disa shkopinj personazhet e listuar më poshtë. Ndërsa shpjegon, nxirr objektet që i përkasin secilit personazh. Ide për objektet:

- Abrami: orë, një fletë/karton ku shkruhet "Gëzuar ditëlindjen!", një objekt që nënkupton dasmë.
- Sarai: një fletë/karton ku shkruhet "Prit", fytyrë e vrenjtur
- Agari: një objekt që nënkupton dasmë, fytyrë e vrenjtur, peceta
- Ismaeli: një fletë/karton ku shkruhet: "Është djalë!"
- Engjëlli: elektrik dore
- Abrahami dhe Sara: etiketa për emrat

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Përse nxiton?

Qëllimi: T'u mësojmë nxënësve rëndësinë e **durimit**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 1: Stacioni i kutive

Mjetet:

- Kuti
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Sfidoji skuadrat që të ndërtojnë me **durim** kullën më të lartë me kuti. Nëse nxënësit nxitojnë, kulla do të bjerë.
3. Inkurajoji përgjatë KZ-së që të kenë **durim** ndërsa ndërtojnë kullat e tyre.
4. Kur të përfundojë koha, shpërbleje skuadrën fituese me nga tre etiketa shpërblyese për çdo anëtar.

Ide me zgjedhje: Ndaji nxënësit në skuadra me nga katër nxënës. Secila skuadër duhet të vërë blloqe, karta apo shkopinj mbi njëri-tjetrin për të ndërtuar kullën më të lartë.

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Lëpirëse me çamçakëz
- Gota me ujë
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Jepi çdo nxënësi një lëpirëse.
2. Sfidoji të jenë të parët që formojnë një flluskë me çamçakëzin, por pa e kafshuar lëpirësen, vetëm duke e lëpirë. Nëse dikush e kafshon lëpirësen, skualifikohet.
3. Mbush paraprakisht disa gota me ujë, në rast se ndonjëri do të ketë nevojë.
4. Vazhdo t'i inkurajosh ta konsumojnë me **durim** lëpirësen derisa të kenë arritur çamçakëzin. Mund t'u kërkosh edhe të numërojnë sa herë duhet ta lëpijnë për të arritur në qendër.
5. Ndërkohë që nxënësit konsumojnë lëpirësen, tregoju për raste kur duhet të jenë të **duruar**.
6. Kujtoju nxënësve që përfundojnë, se duhet të jenë të **duruar** dhe të presin të tjerët.
7. Shpërble fituesin me pesë etiketa shpërblyese.
8. Pas limitit 15-minutash, bëhuni gati për mësimin.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Aktiviteti 3: Stacioni i misionit (*vizita e dytë këtë tremujor*)

Mjetet:

- Foto të fëmijëve nga kisha juaj, të cilët janë fëmijë misionarësh - *Shënim: do të keni nevojë për email-et e prindërve të tyre ose informacionin e kontaktit të medias sociale (ose adresën postare)*
- Letër
- Lapsa
- Lapustila
- Telefon me kamera

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Tregoju nxënësve foto të fëmijëve të misionarëve dhe ndaj informacione jo konfidenciale që ke për ta (emri, mosha, ku jetojnë etj.).
2. Kërkoju të shkruajnë letra inkurajuese për fëmijët e misionarëve.
3. Pasi të plotësoni letrat, bëjuni një foto nxënësve me letrat në duar (individualisht ose në grupe të vogla) dhe dërgojani drejtpërdrejt familjes misionare. Ose postojini ato.
4. Pastaj kaloni kohë në grupe të vogla duke u lutur për këta fëmijë që janë në fushën e misionit.

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: A po nxitoje gjatë *Kohës së zbulimit* sot? A nxitove për shkak se doje të fitoje çmimin? Në botën ku jetojmë duket sikur jemi gjithmonë me nxitim, apo jo? I duam gjërat tani dhe i duam siç na pëlqen ne! Duam të fitojmë, të jemi të suksesshëm... por çfarë ndodh kur Perëndia thotë: "Ngadalëso... ki **durim**... mbështetu tek Unë"? A është kjo diçka e vështirë? Në mësimin e sotëm nga Bibla do të mësojmë për disa njerëz që duhet të ngadalësonin, të ishin të duruar dhe të mbështeteshin te Perëndia.

Shënim: Nëse KZ-në e kishit në stacionin e misionit, flisni për faktin se si fëmijët e misionarëve duhet të varen me durim te Perëndia çdo ditë.

Lutu: *Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje. Inkurajoje të lutet me zë të lartë, që të tjerët ta dëgjojnë dhe të luten me zemër, duke kujtuar se Perëndia është i pranishëm, po aq sa do të ishte po të mund ta shihnin fizikisht.*

Zbuloje: Jemi ende në librin e Zanafillës. A është Zanafilla në Dh.V. apo në Dh.R.? (Dh.V.) Hapini Biblat te Zanafilla, kapitulli 16.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kronologjia: Duke numëruar nga 1-3, kërkoju nxënësve të drejtojnë gishtin te Zanafilla te Kronologjia. Le të rishohim lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës" deri në këtë pikë.

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini
- **Besëlidhja e Perëndisë**: krijoni me gishta yje të shndritshëm mbi kokë

Prezantimi me mësimin nga Bibla: *Me zgjedhje: Shpërbleji nxënësit që përgjigjen saktë, me një etiketë shpërblyese.* Le të rikujtojmë pak çfarë kemi mësuar për Abramin gjatë javëve të fundit.

- Sa vjeç ishte Abrami kur Perëndia i tha se duhet të linte shtëpinë e tij dhe të shkonte në Kanaan? (75 vjeç; gruaja e tij, Sarai, ishte 65 vjeç.)
- A kishin ata fëmijë? (Jo.)
- Çfarë premtimi i dha Perëndia Abramit në lidhje me familjen? (Që ai do të kishte një djalë dhe një familje shumë të madhe.)
- Sa njerëz do të kishte familja e ardhshme e Abramit? (Aq sa ka yje në qiell.)

Tani, le të shpejtojmë historinë dhjetë vite më vonë dhe të shohim se çfarë ndodhi me Abramin, që tashmë ishte 85 vjeç, dhe Sarai, që tashmë ishte 75 vjeç! Perëndia i kishte premtuar Abramit se do të kishte një djalë, por mendo pak sa të vjetër ishin ai dhe Sarai. A lindin fëmijë njerëz aq të vjetër? (Jo!) Njerëzit në atë moshë janë zakonisht gjyshër ose madje edhe stërgjyshër. A do të mbështeteshin Abrami dhe Sarai te Perëndia? Si do ta mbante Perëndia premtimin e Tij? A je gati ta zbulosh?

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 16:1 – 18:15

Sarai bind Abramin të lindë fëmijë me Agarin

Parafrazimi i Zanafilla 16:1-4:

Perëndia premtoi se do t'i jepte Abramit një bir, por ende nuk kishte ndodhur. Ata pritën, e pritën, e pritën...

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Fatkeqësisht, Abrami dhe Sarai nuk pritën me durim dhe vendosën të gjenin vetë një zgjidhje për lindjen e djalit. Sarai i tha Abramit të kishte fëmijë me shërbëtoren e saj, Agarin. Në vend që të varej te Perëndia, Abrami dëgjoi Sarain. A duhej ta kishte dëgjuar Abrami Sarain? (Jo!) A duhej të përpiqej Abrami dhe Sarai të gjenin vetë një zgjidhje për të lindur fëmijën, në vend që të prisnin me durim Perëndinë? (Jo.)

A nxitohesh ndonjëherë në marrjen e vendimeve, në vend që të presësh Perëndinë? Ndoshta nuk ke një mik në shkollë dhe në vend që të presësh kohën e Perëndisë, zgjedh një mik i cili të shtyn të bësh gjëra të gabuara dhe jo çfarë është e drejtë. Këtë bënë Abrami dhe Sarai. Ata nuk ishin të duruar dhe nuk i besuan Perëndisë.

Sarai keqtrajton Agarin

Lexo: Zanafilla 16:5-6

Përmbledhje: Sapo Agari zbuloi se do të lindte një fëmijë, ajo filloi ta urrente Sarain. Kjo bëri që Sarai të keqtrajtonte Agarin dhe Agari ia mbathi.

A ka kuptim kjo që ndodhi? Sarai shkaktoi problemin dhe tani është e zemëruar me rezultatet e mëkatit të saj. Duket sikur një mëkat rritet dhe shkakton një tjetër. Ka gjithmonë pasoja për mëkatin. Disa pasoja ndodhin menjëherë dhe disa të tjera marrin më tepër kohë.

Ungjilli

Kur mëkatet e një personi nuk janë falur, pasoja përfundimtare është që ata nuk mund të kenë një marrëdhënie personale me Perëndinë. *Përfshij Librin pa fjalë/Ungjillin*. Le të vazhdojmë të lexojmë e të zbulojmë se çfarë ndodhi me Agarin.

Agari mëson se Perëndia kujdeset

Lexo: Zanafilla 16:7-16

Përmbledhje: Agari u përpoq të arratisej, por engjëlli i Perëndisë i tha të kthehej dhe të bënte atë që Sarai i kishte thënë. Perëndia ynë i njeh njerëzit e Vet dhe kujdeset për ta. Ai nuk e dërgoi aksidentalisht engjëllin. Ai e bëri sepse kujdesej për Agarin.

Shënim për mësuesin kryesor: *Thekso vargun 13: "Ti je Perëndia që më sheh..."* Agari u kthye, por gjeti më tepër probleme. Engjëlli i Perëndisë i tha Agarit se biri i saj do t'i sillte telashe!

Edhe njëherë, mund të shohësh se, kur përpiqemi të nxitojmë dhe të jetojmë siç na pëlqen ne, në vend që të mbështetemi me durim te Perëndia, ka pasoja.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Agari lindi një djalë dhe emri i tij ishte _____ (Ismael).

Abrami ishte 86 vjeç në atë kohë. A është ky fundi i mësimit, apo Perëndia vazhdoi të punonte në jetët e tyre, edhe pse ata i bënë gjërat siç u pëlqente atyre?

Perëndia i shpjegon edhe më tepër Abramit premtimin e tij

Parafrazimi i Zanafilla 17:1-8:

Kaluan trembëdhjetë vite...

Kur Abrami ishte 99 vjeç dhe Sarai 89, Perëndia i foli sërish. Perëndia i kujtoi Abramit premtimin që i kishte bërë për t'i dhënë një familje të madhe. Ai i dha Abramit gjithashtu një emër të ri. A e gjeni dot si ishte? (Abraham!) Le të zbulojmë se çfarë tjetër i tha Perëndia Abrahamit.

Për shkak të përmbajtjes, do ta kalojmë Zanafillën 17:9-14.

Ndryshimi i emrave dhe më tepër...

Lexo: Zanafilla 17:15-16

Përmbledhje: Perëndia i dha edhe Sarait një emër tjetër. Cili ishte? (Sara.) Perëndia i tha gjithashtu Abrahamit se ai dhe Sara do të kishin një djalë.

Nëse ti do të ishe njëqind vjeç dhe dikush do të të thoshte se do të bëheshe me fëmijë, çfarë do të bëje?

Lexo: Zanafilla 17:17

Përmbledhje: Abrahami qeshi! A do të qeshje ti?

Lexo: Zanafilla 17:18-22

Përmbledhje: Si u tha Perëndia Abrahamit dhe Sarës ta quanin birin e tyre të parë? (Isak.) Shumë kombe dhe mbretër do të vinin nga ky bir. Perëndia kishte një plan; çelësi ishte që Abrahami dhe Sara duhet t'i bënin gjërat siç i pëlqente Perëndisë – jo siç u pëlqente atyre.

Vërtet mund të mësojmë prej kësaj. Perëndia ka kontrollin e gjithçkaje dhe ne duhet të kujtojmë të mbështetemi me durim tek Ai, edhe kur nuk e kuptojmë planin e Tij.

Abrahami donte që Perëndia të bekonte birin e tij, Ismaelin. Perëndia premtoi se do ta bënte, por Ai i tha Abrahamit se premtimi i tij i veçantë ishte për Isakun. Edhe pse Abrahami kishte mëkatuar duke lindur një djalë me Agarin, në fund Abrahami i besoi Perëndisë dhe u mbështet tek Ai. (Hebrenjve 11:11-12)

Për shkak të përmbajtjes, do të shmangim Zanafillën 17:23-27.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Perëndia iu shfaq Abrahamit

***Parafrazimi i Zanafilla* 18:1-5**

Ndërkohë që Abrahami ishte i zënë pranë tendës së tij, iu shfaq Perëndia. Abrahami ishte shumë i kujdesshëm që të ishte i vëmendshëm gjatë kësaj vizite të rëndësishme. Le të zbulojmë se çfarë ndodhi.

Lexo: Zanafilla 18:6-15

Përmbledhje: Sara qeshi sepse mendoi se ishte e pamundur që ajo të kishte një fëmijë duke qenë aq e vjetër. Por Zoti i tha Abrahamit: "A është ndonjë gjë shumë e vështirë për Zotin? Do të kthehem tek ju në takimin e ardhshëm dhe Sara do të ketë një djalë." Uau! Asgjë nuk është e pamundur për Perëndinë!

Përfundimi

Çfarë do të ndodhë? A do të ketë Sara një foshnjë në moshën 90 vjeçare? A është e mundur kjo? Kthehuni javën e ardhshme dhe do ta zbulojmë.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Le të mendojmë për këtë mësim – Çfarë duhet të bëjmë me atë që mësuam sot?

Numri një: Nuk duhet të shqetësohemi për mënyrën se si Perëndia do të bëjë diçka që duket e pamundur. Duhet të mendojmë për ndonjë varg si Fjalët e Urta 3:5-6 dhe të besojmë se Perëndia është mjaft i fuqishëm për të bërë çfarëdo që ka thënë se do të bëjë.

Numri dy: Nuk duhet të mëkatojmë siç bëri Abrahami dhe Sara duke nxituar për t'i bërë gjërat. Ishte e gabuar që Abrahami të kishte një djalë me Agarin, sepse kjo tregonte se ata nuk besonin në planin e Perëndisë.

Cili do të ishte shembulli i diçkaje të tillë për dikë në moshën tënde? Po kur ndodh që dikush të jetë i pasjellshëm me ty? A sillesh edhe ti njësoj, apo pret me durim që Perëndia të të ndihmojë me problemin? A do të thotë se duhet t'i lejosh njerëzit të të ngacmojnë? Jo, por mund t'ia tregosh situatën me qetësi një të rrituri apo një mësuesi, të lutesh për atë person dhe të mbështetesh me durim te Perëndia për të të ndihmuar.

Po në rastin kur të duhet një notë e mirë në provim? A studion shumë dhe i kërkon Perëndisë të të ndihmojë të bësh më të mirën, apo kopjon për të marrë një notë të mirë?

Po kur tundohesh të gënjesh për diçka, në mënyrë që gjërat të bëhen siç do ti? A gënjen apo thua të vërtetën dhe i kërkon Perëndisë të të ndihmojë? Gënjeshtra është

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

shpeshherë një rrugë e shkurtër për të marrë shpejt atë që do, në vend që të mbështetesh me durim te Perëndia.

Numri tre: Ne duhet të bëjmë atë që Perëndia na thotë. Duhet ta lexojmë Biblën dhe t'i bindemi, të lutemi që Perëndia të na drejtojë, të flasim me të krishterë të tjerë të fortë për të marrë këshilla të mençura dhe të presim Perëndinë të bëjë atë që vetëm Ai mund të bëjë. Të bërët e këtyre gjërave do të na ndihmojë të ndihemi në paqe kur mbështetemi me durim te Perëndia për gjithçka!

Nëse nuk je i krishterë, të mbështeturit te Perëndia fillon kur beson te Jezusi për të të shpëtuar nga pasoja e mëkatit tënd dhe mbështetesh tek Ai për të qenë udhëheqësi i jetës tënde. Le të shohim *Librin pa fjalë* për t'u siguruar se të gjithë e kuptojmë se çfarë do të thotë të marrësh falje për mëkatet. *Merri mënjanë nxënësit që nuk e kanë marrë këtë vendim dhe shpjegoju shpëtimin duke përdorur Librin pa fjalë ose fletushkën "E beson apo jo". Ata që zgjedhin, drejtoji në lutjen e shpëtimit.*

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini
- **Besëlidhja e Perëndisë**: krijoni me gishta yje të shndritshëm mbi kokë

Javën e ardhshme do të shtohen dy lëvizje të reja.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Për çfarë e bindi Sarai Abramin të bënte? (Të kishte një fëmijë me shërbëtoren, Agarin.)
2. Si quhet djali i Abramit dhe Agarit? (Ismael.)
3. A ishte Ismaeli biri që Perëndia i kishte premtuar Abramit? (Jo.)
4. Si ua ndryshoi emrat Perëndia Abramit dhe Sarait? (Abraham dhe Sara.)

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

5. Kush do ta lindte birin e premtuar të Abrahamit? (Sara.)
6. Çfarë bëri Abrahami kur mësoi se Sara do të lindte një fëmijë? (Qeshi.)
7. Çfarë bëri Sara kur dëgjoi se do të lindte një fëmijë? (Qeshi.)
8. A beson vërtet se Perëndia mund të bëjë gjithçka?
9. Në një shkallë nga 1 te 10, sa i duruar je për të pritur kohën e përsosur të Perëndisë?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 11
Zanafilla 21:1-21

Kupto si duhet:	Abrahami dhe Sara lindin Isakun.
Mendo si duhet:	"Ki besim te Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua." Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të varem me durim te Perëndia për gjithçka.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem në paqe kur mbështetem me durim te Perëndia për gjithçka.

PËRGATITU!

Javën e kaluar filluam të mësojmë për mënyrën se si mund të varemi me durim te Perëndia për gjithçka. Abrahami dhe Sara vendosën t'i bënin gjërat siç u pëlqente atyre dhe pasojat ishin të dhimbshme. Megjithatë, pavarësisht mungesës së tyre të besimit, Perëndia zgjodhi të vazhdonte t'i mbante premtimet. Ndërsa studiojmë mësimin e kësaj jave, le të ndalemi për të lavdëruar Perëndinë për besnikërinë dhe mirësinë e Tij!

Lutu: Lutu që nxënësit e tu të kenë zemër dhe mendje të hapur këtë javë. Lutu specifikisht për fëmijët që vijnë nga familje në vështirësi.

Lexo: Zanafilla 21:1-21

Kupto si duhet: Abrahami dhe Sara lindin Isakun
Perëndia ua ndryshoi emrat në Abraham dhe Sara, dhe kur Abrahami ishte 100 vjeç dhe Sara 90, ajo lindi një djalë të quajtur Isak. Konflikti mes Agarit dhe Sarës u shtua, dhe Abrahamit iu desh të largonte Agarin dhe birin e tij të dashur Ismael – një tjetër pasojë tragjike e të mos priturit me durim në Perëndinë. Pavarësisht padurimit të Abrahamit dhe Sarës, Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe vazhdoi planin për të sjellë Jezusin që të na shpëtonte nga mëkati ynë. Saga e larmishme e familjes së Abrahamit fillon me ne, duke u mbështetur me durim te Perëndia për gjithçka.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Kjo është pjesë e një mësimi me dy pjesë. Lexo pasazhin e Shkrimit nga java e kaluar për të kuptuar si lidhen mësimet.
- Koha e Perëndisë, jo e imja – çfarë po të mëson Perëndia përmes këtyre mësimeve?

Ide krijuese për mësimin nga Bibla:

1. Para se nxënësit të hyjnë në klasë, vendos një kukull foshnjë në një krevat të vogël bebesh, fik dritat dhe vendos muzikë të lehtë për foshnjë. Kërkoju nxënësve të rrinë në qetësi ndërsa hyjnë dhe gjatë kohës që shpjegon mësimin për lindjen e foshnjës. Fto disa persona që të luajnë rolin e Sarës, Abrahamit, Ismaelit dhe Agarit.
2. Krijo njerëz me letër ose karton për të përfaqësuar Abrahamin, Sarën, Isakun, Agarin dhe Ismaelin.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Sfida e Fjalëve të Urta 3:5-6!

Qëllimi: T'u mësojmë nxënësve Fjalët e Urta 3:5-6.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Një deri në tre pankarta prej letre (në varësi të numrit të nxënësve):
  1. "Unë duhet...."
  2. "Të besoj në Zotin"
  3. "**Fjalët e Urta 3:5-6"**
- Bojëra dhe furçë (për të gjithë nxënësit)
- Gota me ujë
- Erashka (një për çdo nxënës)
- Një këngë që lidhet me të besuarit te Perëndia

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Udhëzimet e drejtuesit të KZ-së:

1. Nxënësit do të punojnë me njëri-tjetrin gjatë dhjetë minutave të para të *Kohës së zbulimit* për të pikturuar pankartat ndërsa dëgjojnë këngën.
2. Gjatë pesë minutave të fundit, kërkoju të përdorin me durim erashkat për të tharë pankartat.
3. Varini pankartat pasi të jenë tharë (këtë mund ta bëni edhe gjatë javës, në varësi të kohës që duhet për t'u tharë boja)

Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

Mjetet:

- Fletë punëdore ku vargu nga Fjalët e Urta 3:5 shkruhet në shkronja të mëdha, të cilat mund të dekorohen nga brenda (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Tasa të vegjël me drithëra me ngjyra (nga një për çdo nxënës)

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Sfidoji nxënësit t'i mbushin shkronjat e fletë punëdores me drithëra me ngjyra. Nuk duhet të hanë drithëra gjatë aktivitetit. Duhet të tregohen të duruar dhe të presin deri të fund për t'i ngrënë.
2. Ndërsa nxënësit merren me këtë, përsëriteni disa herë vargun së bashku.
3. Në fund të aktivitetit, përgëzoji nxënësit për pritjen e duruar që treguan dhe pastaj lejoji të shijojnë drithërat.

Aktiviteti 3: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Forma për të punuar me plastelinë (stampa plastike që formojnë shkronja në plastelinë; nga një grup për çdo skuadër)
- Plastelinë (secila skuadër ka nevojë për 3-5 shirita plasteline nga çdo ngjyrë)
- Një poster me vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6 (burim i printueshëm); ose shkruajeni vargun në një tabelë apo në një karton
- Etiketa shpërblyese

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndajini nxënësit në skuadra me nga katër ose pesë nxënës.
2. Jepi secilës skuadër nga një ngjyrë specifike plasteline dhe një grup me stampa shkronjash.
3. Nxënësit do të sfidohen të stampojnë vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6 si skuadër.
4. Nxënësit duhet të bashkëpunojnë si skuadër – të gjithë duhet të marrin pjesë.
5. Skuadra e parë që arrin objektivin fiton tri etiketa shpërblyese për secilin.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Kush mund të recitojë vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6? A është ky një varg i thjeshtë apo i vështirë për t'u zbatuar? Si do të lidhej ky varg me Abrahamin dhe Sarën? *Lëri nxënësit të mendojnë!*

Lutu: *Para se një nxënës të nisë një lutje, bëju këtë pyetje*: Nëse Jezusi do të vinte fizikisht përmes derës sot, çfarë do t'i thoshe? Nëse unë do t'ju kërkoja të zgjidhnit një përfaqësues që do të fliste me Jezusin ndërsa Ai do të hynte, kë do të zgjidhnit? Ne lutemi çdo javë së bashku. Do të pyes se kush ka dëshirë të lutet. Nëse do të dëshiroje të udhëhiqje në lutje, ngri dorën. Synimi ynë është që çdokush të ketë mundësinë të drejtojë në lutje. *Inkurajo njërin nga nxënësit të drejtojë klasën në lutje*.

Zbuloje: Sot jemi te libri I Zanafillës, kapitulli 21. A është Zanafilla në DH.V. apo në DH.R.? (DH.V.)

Kronologjia: A e di ndokush se ku kemi mbetur te kronologjia? Le të rishikojmë lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës" deri te mësimi i sotëm:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini
- **Besëlidhja e Perëndisë**: krijoni me gishta yje të shndritshëm mbi kokë

Prezantimi me mësimin nga Bibla:
Me zgjedhje: Shpërble me një etiketë shpërblyese çdo përgjigje të saktë.
Le të mendojmë për çfarë kemi mësuar për Abrahamin gjatë javëve të fundit.

- Kush ishte gruaja e Abrahamit? (Sara.)
- A kishin fëmijë Abrahami dhe Sara? (Jo.)
- Çfarë i premtoi Perëndia Abrahamit në lidhje me familjen? (Ai do të kishte një djalë dhe një familje shumë të madhe.)
- Sa njerëz do të kishte familja e ardhshme e Abrahamit? (Aq sa ka yje në qiell!)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Perëndia i kishte premtuar Abrahamit se do të kishte një djalë, por mendo pak se sa të vjetër ishin Abrahami dhe Sara! A kanë fëmijë njerëzit e asaj moshe? (Jo!) Njerëzit e asaj moshe janë zakonisht gjyshër, madje edhe stërgjyshër! A do të vareshin te Perëndia Abrahami dhe Sara? Si do ta mbante Perëndia premtimin e Tij? A je gati ta zbulosh?

Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 21:1-21

Perëndia e mban premtimin e Tij

Lexo: Zanafilla 21:1-2

Përmbledhje: A e imagjinon dot? Abrahami ishte 100 vjeç dhe Sara ishte 90, dhe ata u bënë me fëmijë, ashtu siç kishte premtuar Perëndia! Do të ishte njësoj sikur stër, stërgjyshja dhe stër, stërgjyshi yt të bëheshin me fëmijë! Perëndia e mbajti premtimin e Tij! Kjo ishte një mrekulli e jashtëzakonshme!

Kjo më kujton diçka që e kemi mësuar disa javë më parë rreth Perëndisë, kur po flisnim për kullën e Babelit. A ju kujtohet çfarë do të thotë fjala "sovran"? (Perëndia ka të gjithë fuqinë.) Edhe pse njerëzit mund të mos i bëjnë gjërat siç i pëlqejnë Perëndisë, Perëndia vazhdon të ketë fuqinë për ta realizuar planin e Tij, në kohën e Tij të përsosur. Po si do ta quanin ata këtë djalë të vogël?

Lexo: Zanafilla 21:3 dhe 5 (*Për shkak të përmbajtjes, do të shmangim vargun 4.)*
Përmbledhje: Ata e quajtën Isak. A e di kuptimin e emrit Isak? Le të lexojmë më tej.

Lexo: Zanafilla 21:6
Përmbledhje: Isak do të thotë qeshje!
Prezanto lëvizjen e re të "Flasim rreth Zanafillës":

- **Lind Isaku; ha, ha, ha:** lëkundni një fëmijë në krahë

Por, për shkak se Abrahami dhe Sara nuk ishin mbështetur te Perëndia, familjen e Abrahamit e prisnin telashe. Le të zbulojmë cili ishte telashi.

Për shkak të përmbajtjes do të shmangim Zanafillën 21:7

Ismaeli ngacmon Isakun

Lexo: Zanafilla 21:8-11

Përmbledhje: Ismaeli po ngacmonte Isakun, prandaj Sara dhe Abrahami larguan Agarin dhe Ismaelin. Kjo e mërziti shumë Abrahamin. Çfarë mendoni se ndodhi? Le të vazhdojmë të lexojmë.

Agari dhe Ismaeli duhet te largohen nga Abrahami

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo: Zanafilla 21:12-13
Përmbledhje: A e kuptoni se ky "komb" – familja e Ismaelit – jeton ende? Pjesa më e madhe e tyre ndjekin një fe të rreme të quajtur islam. Ndjekësit e islamit quhen myslimanë. Ata thonë se besojnë në Perëndinë e Biblës, por në vend që të studiojnë Biblën, ata studiojnë një libër të quajtur Kuran, që u mëson shumë gjëra të rreme për Perëndinë dhe mohon që Jezusi është Shpëtimtari i botës.

Lexo: Zanafilla 21:14-21
Përmbledhje: Si mendoni? A u kujdes Perëndia për Agarin dhe Ismaelin? A e mbajti Ai premtimin e Tij, edhe pse Abrahami dhe Sara mëkatuan dhe i prishën gjërat? (Po.) Perëndia është sovran. Edhe pse Abrahami dhe Sara nuk e bënë gjithçka siç duhej, Perëndia vazhdoi ta përmbushte planin e Tij në jetën e tyre. A e di ndonjëri se cili ishte plani?

Përfundimi

Përdor kronologjinë e Biblës për të folur rreth kësaj gjenealogjie. Ose mund të vizatoni një pemë familjeje me fytyra të qeshura në tabelë.

Plani i Perëndisë shkoi kështu: Abrahami lindi Isakun. Isaku Jakobin. Jakobi kishte dymbëdhjetë bij që u bënë dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Një nga bijtë quhej Juda. Mbreti David vinte nga familja e Judës. A e dini se kush vinte nga familja e mbretit David? (Jezusi!) Plani i Perëndisë ishte të dërgonte Jezusin për të na shpëtuar nga mëkati ynë!

Edhe pse u deshën mijëra vite dhe të gjithë bënë gjëra që nuk duhej t'i kishin bërë, Perëndia gjithsesi e përmbushi planin e Tij për të dërguar një Shpëtimtar që do të jetonte një jetë të përsosur dhe do të vdiste në kryq për të na shpëtuar nga pasoja e mëkatit tonë. Ai gjithashtu u kujdes për të gjithë ata njerëz që kishin besim në Të.

Vepro si duhet dhe Ndihu si duhet

Po ti? Nëse dikush do të shihte jetën tënde, a do të thoshin se ti mbështetesh te Perëndia dhe beson tek Ai? Apo fillon të ndihesh në panik kur gjërat nuk shkojnë siç do ti ose kur Perëndia të thotë "Jo" apo "Prit"? Kujto që, kur i kërkojmë diçka Perëndisë, Ai përgjigjet me "Po", "Jo" ose "Prit", dhe ne duhet të mbështetemi tek Ai që të na përgjigjet në mënyrën më të mirë për ne. Si mund ta shohin të tjerët se Fjalët e Urta 3:5-6 janë fjalë që ti i beson vërtet?

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:

- **Krijimi**: ngrini duart lart për të formuar botën
- **Adami dhe Eva**: ngrini nga një parakrah lart për secilin
- **Mëkati**: me parakrahët formoni një "X"
- **Kaini dhe Abeli**: ngrini dy gishtat e mëdhenj dhe filloni një luftë me ta
- **Noeu u bind**: mblidh grusht njërën dorë dhe me të godit pëllëmbën tjetër
- **Një përmbytje me një premtim**: hapini duart përpara si një përmbytje dhe filloni t'i ngrini lart derisa të formoni një ylber me to
- **Kulla e Babelit, e Babelit, e Babelit**: krijoni një kullë duke bashkuar gishtat sipër kokës
- **Abrami tha: "Le të shkojmë!"**: dora e djathtë e ngritur lart me lëvizje lart e poshtë
- **Toka e ndarë**: dy parakrahët e mbledhur përpara dhe pastaj ndajini
- **Besëlidhja e Perëndisë**: krijoni me gishta yje të shndritshëm mbi kokë
- **Lind Isaku; ha, ha, ha:** lëkundni një fëmijë në krahë
- **Agari, Ismaeli:** fshi një lot nga secili sy

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Sa vjeç ishin Abrahami dhe Sara kur u bënë me djalë? (Abrahami ishte 100 dhe Sara ishte 90 vjeç.)
2. Si u quajt djali i Abrahamit dhe Sarës? (Isak.)
3. Çfarë do të thotë emri Isak? (Qeshje.)
4. Çfarë iu desh të bënin Agari dhe Ismaeli? (Atyre iu desh të largoheshin nga Abrahami.)
5. Kush u kujdes për Agarin dhe Ismaelin pasi u larguan nga Abrahami? (Perëndia u kujdes për ta.)
6. A do të mbështetesh te Perëndia me durim për gjithçka?

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mësimi 12
Dita e përsëritjes

Kupto si duhet:	Mençuria e vërtetë vjen nga Perëndia.
Mendo si duhet:	"Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht." 2 e Pjetrit 3:18a (12 vargjet kyç)
Vepro si duhet:	Unë do të kujtoj Fjalën e Perëndisë.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i mençur kur kujtoj Fjalën e Perëndisë.

PËRGATITU!

Këtë tremujor, mundi yt në Zotin nuk ka qenë i kotë. Çdo orë që ke përkushtuar në lutje, çdo orë duke studiuar mësimin dhe duke e shpjeguar apo duke ndihmuar në klasë, do të sjellë ndryshim të përjetshëm në jetët e nxënësve të tu. Inkurajohu, Perëndia po vepron dhe Ai do t'i ndihmojë nxënësit e tu t'i rikujtojnë këto mësime gjatë viteve që do të vijnë!

Lutu: Ndërsa përsërisim mësimet këtë javë, lutu që nxënësit e tu do të kujtojnë atë që kanë mësuar dhe do të jenë të zellshëm për ta vënë në zbatim në jetën e tyre.

Lexo: Përsërit mësimet nga ky tremujor.

Kupto si duhet: Të rishikojmë çfarë kemi mësuar.
Ndërsa i afrohemi fundit të tremujorit, marrim një ditë për të kujtuar dhe festuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Tremujorin e ardhshëm do të rikthehemi te Dhiata e Re për të mësuar se si u bë realitet

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:

- Dita e përsëritjes mund të jetë e ngarkuar për vizitorët. Këshillat e mëposhtme do t'i ndihmojnë të ndihen të përfshirë në aktivitetin e përsëritjes:
  - Jepu një objekt specifik nga pjesa e kronologjisë që duhet ta vizatojnë.
  - Bëj dyshe një vizitor me një nxënës që ka aftësi të forta udhëheqësie dhe/ose vendosi në një grup me dy nxënës të tjerë, që grupi të ketë tre pjesëtarë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Mos prisni që vizitorët të flasin rreth pikturës; mësuesi ose partneri duhet të shpjegojnë.
- Vareni kronologjinë në mur, në mënyrë që prindërit të mund t'i shohin ndërsa marrin nxënësit. Ose ftojini prindërit në klasë për të parë kronologjinë e përfunduar.

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit

Shënim: Nuk do të ketë 'Kohë zbulimi' këtë javë. Adhurimi do të zgjasë 20 minuta. Përsëritini disa herë lëvizjet e "Flasim rreth Zanafillës".

Aktiviteti i përsëritjes

Mjetet/Ambienti:

- Tabakë të mëdhenj të ndarë në njëmbëdhjetë seksione si librat me figura; shkruaji titujt e mësimeve të këtij tremujori (sipas rendit) në fund të çdo seksioni, bashkë me referencat nga Shkrimi
- Tabela (të vendosura për të mbajtur tabakët e mëdhenj dhe hapësirë që nxënësit të qëndrojnë në këmbë ose të ulen ndërsa punojnë)
- Bojëra dhjami
- Lapustila të hollë dhe të trashë
- Ngjitës
- Një kopje të programit mësimor të tremujorit (prije seksionin për çdo mësim.)
- Me zgjedhje: Për klasat me më shumë nxënës, prije letrën në seksione dhe ngjiti pasi të përfundoni.
- Me zgjedhje: Përdor postera individualë për secilin çift të nxënësve, në vend që të përdorësh tabakët e mëdhenj

Udhëzimet e mësuesit kryesor:

1. Për të filluar përsëritjen, lexo titujt e mësimeve, në mënyrë që nxënësit të mund të përforcojnë përsëritjen e tremujorit. Me zgjedhje: Shkruaji titujt e mësimit në tabelë ose vizato një kronologji të thjeshtë të mësimeve në tabelë.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

2. Ndaji nxënësit në dyshe. Nëse keni shumë nxënës mund t'ju duhen dy ose tre kronologji për të caktuar secilën dyshe te një ngjarje. Kjo do të thotë se do të ketë vizatime që do të përsëriten dy ose tri herë. Ose mund t'i ndani nxënësit në grupe me nga tre.
3. Caktoji një katror mësimi secilës dyshe dhe jepu seksionin përkatës nga programi mësimor.
4. Sigurohu që të gjithë nxënësit të kenë një Bibël dhe ta hapin te referenca që u është caktuar. Disa nxënës mund të kenë nevojë për ndihmë këtu.
5. Sfidoji grupet të vizatojnë një pamje të mësimit në katrorin që iu caktua. Nëse do kenë pyetje, mund t'i referohen referencës nga Shkrimi te Biblat e tyre.
6. Nëse është e mundur, kërkoju të shkruajnë pikën e "Vepro si duhet" mbi vizatimin e tyre. Të gjithë drejtuesit duhet të jenë gati për të ndihmuar apo për të shkruar pikën e "Vepro si duhet" për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për ndihmë.
7. Lejoji nxënësit të punojnë me projektin pesëmbëdhjetë minuta.
8. Kërkoju të shkruajnë emrat e tyre me shkronja të vogla në fund të seksionit.
9. Pastaj ngjiteni kronologjinë në mur. Nëse bëhen disa, ngjisni njërën ose të gjitha në mur.
10. Kërkoju dysheve të nxënësve të ngrihen me radhë dhe të shpjegojnë çfarë ndodhi në mësimin e tyre dhe se çfarë u mësoi Perëndia. Kjo mund të jetë e vështirë për disa nxënës; ndihmoji dhe inkurajoji ata!
11. Kërkoju nxënësve të shohin kronologjinë dhe të kuptojnë pamjen e madhe të Fjalës së Perëndisë dhe çfarë na ka mësuar Ai.
12. Përmbylleni përsëritjen duke prezantuar Ungjillin me *Librin pa fjalë*.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Pasi të ketë përfunduar përsëritja, luani një lojë përsëritjeje gjatë kohës që prindërit vijnë për të marrë fëmijët.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

SHTOJCA

Harta e gjurmuesit

Mësim tematik: Njëri-tjetrin

Kupto si duhet:	Jezusi udhëzon ndjekësit e Tij të duan njëri-tjetrin.
Mendo si duhet:	"Po ju jap një urdhërim të ri; ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur ju, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin." Gjoni 13:34-35
Vepro si duhet:	Unë do t'i dua njerëzit në kishën time dhe do të kujdesem për ta.
Ndihu si duhet:	Unë mund të ndihem i afërt kur dua dhe kujdesem për njerëzit në kishën time.

PËRGATITU!

Kur Jezusi themeloi Kishën, na dha një dhuratë të jashtëzakonshme! Një nga mënyrat se si Perëndia siguron dhe kujdeset për fëmijët e Tij, është përmes njerëzve të Tij, Kishës! Kur besimtarët kujdesen, inkurajojnë dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin, reflektojnë dashurinë e Perëndisë te njëri-tjetri (dhe ia tregojnë botës dashurinë e Krishtit në veprim!). Ndërsa përgatitesh për këtë mësim, lutu që nxënësit e tu do të kuptojnë se si Perëndia do që anëtarët e familjes së kishës ta duan njëri-tjetrin.

Lutu: Duam që fëmijët të jenë të mirëpritur që në vegjëli në një komunitet të dashur e të sigurt në kishë. Lutu që nxënësit në klasë do të gjejnë siguri dhe dashuri në familjen e kishës ndërsa e kuptojnë se çfarë do të thotë "njëri-tjetrin".

Lexo: Gjoni 13:34-35; 1 e Gjonit 3:1; 1 e Gjonit 4:7, 21; Romakëve 12:10; 1 e Pjetrit 4:8-10; Efesianëve 4:32, 5:19-20, 6:18; Kolosianëve 3:12-17; Jakobi 5:16

Kupto si duhet: Jezusi i udhëzon ndjekësit e Tij ta duan njëri-tjetrin.

BËHU GATI!

Shënimet e mësuesit kryesor:



- Ndërsa përgatitesh, rishiko pjesën nga harta e gjurmuesit që titullohet "Kisha" (burim i printueshëm). Gjatë mësimit të kësaj jave shpresojmë të përforcohen disa nga të vërtetat e mbuluara në këtë pjesë të hartës së gjurmuesit.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- Në këtë mësim biblik do të zhvendoseni tek disa letra të Dhiatës së Re – letra në Bibël të shkruara nga apostujt për kishën e hershme. Nëse po mëson nxënësit më të rritur, ky mësim është një mundësi e shkëlqyer për t'i prezantuar me këtë zhaner në Dhiatën e Re.
- Ky mësim përfshin shumë libra nga Dhiata e Re. Për ta bërë mësimin më të kuptueshëm dhe për t'i ndihmuar nxënësit të përqendrohen, rekomandojmë:
    - Vendos paraprakisht letra me ngjitës në vargjet nga Bibla.
    - Kërkoju të gjithë nxënësve t'i mbajnë Biblat hapur te Gjoni 13:34-35 (në vend që nxënësit t'i hapin Biblat te çdo varg gjatë mësimit). Nëse po mëson nxënës më të rritur, zgjidh edhe 2-3 vargje shtesë që t'i gjejnë në Biblat e tyre gjatë mësimit.

Ide krijuese për mësimin biblik:



1. Përdor shenja dalluese për çdo rast që përmendet "njëri-tjetrin". Sa herë ta lexoni, shfaq shenjën përpara klasës (në tabelë ose në tavolinë). (burim i printueshëm)
2. Përgatit një skenë, një ilustrim të shkurtër, apo një aktivitet për secilin prej rasteve ku përmendet "njëri-tjetrin" (ndero, shërbe, fal, mëso dhe inkurajo, dhe lutu). Për shembull:
    - Nderim: unazë ari ose vazo shumë e bukur (diçka me vlerë)
    - Shërbe: një poster apo një karton për të bërë një listë me mënyrat se si mund t'i shërbeni familjes së kishës
    - Fal: karton i bardhë për të përfaqësuar fletën e bardhë në "Librin pa fjalë"
    - Mëso dhe inkurajo: kartolina me vargje nga Bibla
    - Lutu: ndani pika lutjeje me njëri-tjetrin si klasë apo në dyshe
3. Ndërsa shpjegon mësimin krijo një poster në lidhje me "njëri-tjetrin". Listoji të gjitha pikat që lidhen me këtë fjalë (ndero, shërbe, fal, mëso/inkurajo dhe lutu) me shkronja të mëdha. Pastaj shkruaj ose vizato ilustrime të mënyrave se si nxënësit mund t'i vënë ato koncepte në veprim. (Nëse po shpjegon mësimin për fëmijët e rritur, lejoji ata të shkruajnë apo të vizatojnë në poster.)
4. Për nxënësit më të rritur: Jepi secilit nxënës nga një copë letër në fund të mësimit, pastaj jepu pesë minuta për t'u mbledhur me nxënësit e tjerë dhe për të ndarë kërkesa lutjesh me njëri-tjetrin. Nxënësit duhet të shkruajnë emrat e shokëve të klasës dhe kërkesat e tyre të lutjes në fletën e tyre, pastaj ta marrin letrën me vete në shtëpi për t'u lutur gjatë javës së ardhshme.
5. Për nxënësit më të rritur: Jepu kohë në fund të mësimit të luten me një mik. Jepu disa sugjerime, pastaj inkurajoji të luten së bashku. Pas kësaj, diskutoni se si u ndien dhe përse është e rëndësishme dhe e vlefshme që ne të lutemi me besimtarë të tjerë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

NISU!

Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

Koha e zbulimit: Ndërtimi i kullës!

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit dhe drejtuesit ta njohin njëri-tjetrin më mirë.

Aktiviteti 1: Stacioni i artit

Mjetet:

- Fletë të mëdha kartoni ose tabakë
- Lapustila, lapsa me ngjyra ose bojëra dhjami
- Kohëmatës

Shënim: ky aktivitet mund të bëhet me nxënësit të ndarë në grupe më të vogla (siç shpjegohet) ose si një grup i madh.

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në grupe të vogla (rreth 4-6 nxënës për çdo grup).
2. Jepi secilit grup një karton apo tabak dhe mjete për ngjyrosje.
3. Shpjego që të gjithë grupet do të bashkëpunojnë për të krijuar një banderolë që përfaqëson interesat, pëlqimet, vargjet/pasazhet e preferuara biblike, familjet e tyre, etj. Sigurohu që nxënësit të përfshijnë emrat e tyre në banderolë.
4. Inkurajoji grupet të diskutojnë dhe të vendosin mbi një temë apo koncept për banderolën e tyre. Secili nxënës do të kontribuojë duke vizatuar ose duke shkruar diçka te posteri bazuar në temën e grupit. Grupet kanë 10 minuta kohë për të punuar me banderolat e tyre.
5. Kur të përfundojë koha, secili grup duhet ta prezantojë banderolën para klasës, duke shpjeguar rëndësinë e temës së zgjedhur.
6. Alternativë: vendosini banderolat në klasën e fëmijëve.

Aktiviteti 2: Stacioni i plastelinës

Mjetet:

- Plastelinë

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në dyshe ose në grupe.
2. Jepi secilit grup disa pako/kuti me plastelinë.
3. Udhëzoji nxënësit të punojnë së bashku për të krijuar skulptura me plastelinë që përfaqësojnë pjesëtarët e grupit. (Skulpturat duhet të jenë një përfaqësim fizik i

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

pjesëtarëve, por mund të përfshijnë gjithashtu interesat, pëlqimet, vargjet e preferuara apo familjet e nxënësve, etj.)
4. Inkurajoji të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë karakteristikat unike dhe detajet e pjesëtarëve të grupit ndërsa bëjnë skulpturat.
5. Kur të përfundojë koha, kërkoji secilit grup të prezantojë skulpturat e veta dhe të përshkruajnë se çfarë mësuan për njëri-tjetrin gjatë aktivitetit.

Aktiviteti 3: Hapësirë e madhe

Mjetet:

- Një dhomë e madhe ku katër cepat e saj caktohen 1, 2, 3 dhe 4
- Bilbil

Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Shpjegoju nxënësve se do të luajnë një lojë të quajtur "4 cepat" për të mësuar më shumë për shokët e klasës.
2. Do të shpallësh një kategori dhe ata do të zgjedhin një nga katër alternativat në bazë të preferencave, përvojave ose mendimeve personale (shikoji shembujt e kategorive më poshtë).
3. Pasi të lexosh secilën kategori dhe alternativat që u përkojnë, jepu nxënësve 10 sekonda kohë për të vendosur dhe pastaj të vrapojnë në cepin që ata mendojnë se përfaqëson zgjedhjen e tyre.
4. Kur të përfundojnë 10 sekondat, bjeri bilbilit dhe lejoji nxënësit të flasin me nxënësit e tjerë në cepin që zgjodhën. Mund të ndajnë arsyet e tyre se përse e zgjodhën atë cep, një histori që lidhet me të apo një përvojë personale. Pas disa çastesh, bjeri sërish bilbilit për të treguar përfundimin e kohës.
5. Përsërite me kategori të tjera.

Shembuj kategorish:

1. Ngjyra e preferuar: Cepi 1 – Blu, Cepi 2 – Jeshile, Cepi 3 – E kuqe, Cepi 4 – E verdhë
2. Kafsha e preferuar: Cepi 1 – Qen, Cepi 2 – Mace, Cepi 3 – Zog, Cepi 4 – Peshk
3. Aktiviteti i preferuar: Cepi 1 – Sportet, Cepi 2 – Arti, Cepi 3 – Muzika, Cepi 4 – Leximi
4. Lënda e preferuar: Cepi 1 – Matematika, Cepi 2 – Fizikë/Kimi, Cepi 3 – Gjuha, Cepi 4 – Fizkultura
5. Stina e preferuar: Cepi 1 – Pranvera, Cepi 2 – Vera, Cepi 3 – Vjeshta, Cepi 4 – Dimri
6. Vendi i ëndrrave për pushime: Cepi 1 – Plazh, Cepi 2 – Park lojërash, Cepi 3 – Qytete të mëdha, Cepi 4 – Kamping
7. Shija e preferuar e akullores: Cepi 1 – Çokollatë, Cepi 2 – Vanilje, Cepi 3 – Luleshtrydhe, Cepi 4 – Çokollatë me mente

Shënim: Përshtati kategoritë sipas kontekstit ose shto kategori të tjera nëse ke kohë (për shembull: nxënësit mund të zgjedhin skuadrën e preferuar të futbollit, restorantin e preferuar apo aktivitete në natyrë).

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Prezantimi i mësimit nga Bibla

Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin: Gjatë *Kohës së zbulimit,* sot mësuam shumë për njëri-tjetrin. Cilat janë disa gjëra që mësuat sot për shokët e klasës? Inkurajoji nxënësit të ndajnë. Sot po kuptojmë se si Jezusi na mëson të duam dhe të kujdesemi për njerëzit në familjen e kishës – kjo do të thotë se si ta duam dhe të kujdesemi për njëri-tjetrin në kishën _____ (vendos emrin e kishës tënde)! Ta njohim njëri-tjetrin më mirë është një pikënisje e mbarë, dhe sot do të mësojmë se çfarë tjetër duhet të bëjmë për të dashur njëri-tjetrin.

Lutu: Përpara se të fillojmë, le të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë ta kuptojmë urdhërimin e Tij për të dashur anëtarët e tjerë të familjes së kishës.

Zbuloje: Sot do të lexojmë shumë vargje në Dhiatën e Re, por vargu nga *Mendo si duhet* është Gjoni 13:34-35, prandaj Biblat do t'i hapim fillimisht aty.

Kronologjia: Gjoni 13:34 është një urdhërim që Jezusi u dha ndjekësve të Tij. Kjo do të thotë se po mësojmë për diçka që ndodhi ndërsa Jezusi po mësonte njerëzit në tokë. Ku gjendet kjo në kronologji? Nxënësit duhet të drejtohen nga kronologjia.

Prezantim me mësimin nga Bibla: Gjatë Darkës së Fundit, pasi lau këmbët e dishepujve, Jezusi u dha dishepujve të Tij disa udhëzime shumë të rëndësishme. Këto udhëzime vlejnë edhe për ne sot! Le t'i lexojmë.

Përvijimi i Shkrimit

Duajeni njëri-tjetrin

Lexo Gjoni 13:34-35

Përmbledhje: Me kë po fliste Jezusi? (me dishepujt – ndjekësit e Tij) Çfarë i urdhëroi të bënin? (Ta donin njëri-tjetrin) Çfarë do të ndodhte nëse dishepujt do të bindeshin? (Të gjithë do ta dinin se ata ishin dishepujt e Jezusit)

Jezusi po u fliste ndjekësve të Tij që ta donin njëri-tjetrin, dhe këto udhëzime nuk janë vetëm për dishepujt, por për të gjithë të krishterët! Nëse i ke kërkuar Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Udhëheqësi yt, kjo do të thotë se je ndjekës i Tij. Ai po na udhëzon ne t'i duam të krishterët e tjerë.

Familja e Perëndisë

Kur ne jemi të shpëtuar, bëhemi pjesë e familjes së Perëndisë!

Lexo 1 e Gjonit 3:1; 1 e Gjonit 4:7, 21

Përmbledhje: Perëndia na do aq shumë, saqë Ai jo thjesht na shpëton nga mëkati, por Ai na mirëpret në familjen e Tij! Kur ne shpëtohemi, bëhemi pjesë e familjes së Perëndisë! Si vëllezër dhe motra në Krishtin, jemi thirrur të duam dhe të kujdesemi për njëri-tjetrin.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Të reflektojmë dashurinë e Perëndisë

Kur e duam njëri-tjetrin, bota sheh në ne reflektimin e dashurisë së Perëndisë!

Lexo Gjoni 13:35

Përmbledhje: Si i drejton njerëzit te Perëndia dashuria që kemi për njëri-tjetrin? Inkurajoji nxënësit të përgjigjen, pastaj kalo te shpallja e Ungjillit duke përdorur "Librin pa fjalë".

Si e duam njëri-tjetrin?

Familja e Perëndisë përbëhet nga të gjithë njerëzit që duan dhe ndjekin Jezusin. Të krishterët janë të shpërndarë nëpër të gjithë botën, por mblidhemi në kisha të vogla, lokale. Perëndia do që ne ta duam dhe të kujdesemi për njerëzit në kishat tona.

Çfarë gjërash bëjmë nëse e duam njëri-tjetrin? Perëndia na jep disa shembuj në Bibël. Vargjet që do të lexojmë bashkë janë nga Dhiata e Re, nga letrat që dishepujt u shkruan kishave të para.

Për nxënësit më të rritur: Shumë nga librat e Dhiatës së Re janë në fakt letra të shkruara nga apostujt për kishat e hershme. Perëndia përdori dishepujt për të drejtuar dhe për të mësuar besimtarët e parë. Një nga mënyrat si dishepujt mësonin ishte përmes shkrimit të letrave drejtuar kishave. Kishat i lexonin këto letra së bashku dhe pastaj i ndanin me kishat e tjera rreth tyre. Këto letra i ndihmonin besimtarët të kuptonin se si ta ndiqnin Jezusin dhe si ta ndanin Ungjillin me njerëzit në qytetet e tyre.

Nderoni njëri-tjetrin

Lexo Romakëve 12:10

Përmbledhje: Si e duan të krishterët njëri-tjetrin në këtë varg? (duke e nderuar njëri-tjetrin) Kur ne nderojmë njëri-tjetrin, ne po i trajtojmë njerëzit si të ishin shumë të vlefshëm... sepse janë shumë të vlefshëm! Përse jemi të vlefshëm? Sepse Perëndia na krijoi, dhe Ai na bëri sipas shëmbëlltyrës së Tij. Kjo do të thotë se jemi si një pasqyrë; duhet të reflektojmë Perëndinë dhe se si Ai kujdeset për krijimin e Tij.

Një mënyrë se si mund t'i nderojmë njerëzit në familjen e kishës është duke dalluar e duke respektuar mënyrat se si Perëndia i ka bërë unikë. Për shembull, nëse disa njerëzve në kishë u pëlqen të përdorin muzikën për të adhuruar Perëndinë, ne mund t'i nderojmë ata duke u thënë se jemi mirënjohës që ata e përdorin talentin për të adhuruar Perëndinë.

Diskutim alternativ: A mund të më jepni ndonjë shembull tjetër të mënyrës se si mund t'a nderojmë dikë në familjen e kishës? Inkurajoji nxënësit të ndajnë; fëmijët më të vegjël ndihmoji sipas nevojës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shërbejini njëri-tjetrit

Lexo 1 e Pjetrit 4:8-10

Përmbledhje: Si e duan të krishterët njëri-tjetrin në këto vargje? (Duke i shërbyer njëri-tjetrit) Të krishterët mund ta duan njëri-tjetrin duke i shërbyer dhe duke u kujdesur për njëri-tjetrin. Kjo do të thotë se mund ta ndihmojmë dhe ta mbështesim njëri-tjetrin dhe gjithashtu mund të tregojmë mikpritje duke i përfshirë të tjerët.

Një nga mënyrat se si mund t'i shërbejmë dikujt në familjen e kishës është duke dalluar kur dikush mund të ketë nevojë për ndihmë – për shembull, mund t'i hapim derën dikujt që i ka duart e zëna.

Diskutim i mundshëm: A mund të më jepni një shembull tjetër se si fëmijët mund t'i shërbejnë dikujt në familjen e kishës? Inkurajoji nxënësit të japin ide; ndihmoji fëmijët e vegjël sipas nevojës.

Falni njëri-tjetrin

Lexo Efesianëve 4:32; Kolosianëve 3:12-14

Përmbledhje: Si e duan të krishterët njëri-tjetrin në këto vargje? (Duke falur njëri-tjetrin dhe duke i rrëfyer mëkatet njëri-tjetrit) Kur e duam njëri-tjetrin, e falim më shpejt njëri-tjetrin. Përse falim më shpejt? Inkurajoji nxënësit të shprehen. Ne mund të falim njëri-tjetrin për shkak se Jezusi na ka falur! Ai ka dhënë shembullin se si të falim, dhe ne e ndjekim Atë kur falim njëri-tjetrin. Ne gjithashtu i japim llogari njëri-tjetrit. Kjo do të thotë se e ndihmojmë njëri-tjetrin t'i rezistojmë tundimit, duke zgjedhur mënyrën e Perëndisë në vend të mëkatit.

Diskutim i mundshëm: A mund të më jepni një shembull të mënyrës se si fëmijët e krishterë mund të falin njëri-tjetrin? Inkurajoji nxënësit të japin ide.

Mësoni dhe inkurajoni njëri-tjetrin

Lexo Efesianëve 5:19-20; Kolosianëve 3:15-17

Përmbledhje: Si e duan të krishterët njëri-tjetrin në këto vargje? (Duke e mësuar dhe inkurajuar njëri-tjetrin) Të krishterët mund të përdorin Fjalën e Perëndisë për të inkurajuar njëri-tjetrin dhe për ta ndihmuar njëri-tjetrin që të adhurojmë dhe ndjekim Jezusin. Ne mund t'i kujtojmë njëri-tjetrit mënyra se si t'i bindemi Jezusit dhe mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin që të rritemi.

Për shembull, nëse dikush në familjen e kishës ndihet i dekurajuar, ne mund t'u kujtojmë Gjonin 3:16 dhe se sa shumë e do Perëndia.

Diskutim i mundshëm: Cilat janë disa mënyra të tjera që mund të mësojmë dhe të inkurajojmë njëri-tjetrin? Inkurajoji nxënësit të japin ide.

Lutuni për njëri-tjetrin

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lexo Jakobi 5:16; Efesianëve 6:18
Përmbledhje: Si e duan të krishterët njëri-tjetrin në këto vargje? (Duke u lutur për njëri-tjetrin). Është shumë e rëndësishme që të krishterët të luten për njëri-tjetrin dhe me njëri-tjetrin! A mund ta bëjnë fëmijët këtë? (Po!)

Diskutim i mundshëm: Si mund të lutemi për njëri-tjetrin? Inkurajoji nxënësit të japin ide.

Përfundimi

Kur shpëtohemi bëhemi pjesë e familjes së Perëndisë. Perëndia na ka dhënë udhëzime specifike se si mund të duam dhe të kujdesemi për vëllezërit dhe motrat në Krishtin. Kur të krishterët e duan njëri-tjetrin dhe u binden udhëzimeve të Perëndisë, e gjithë bota sheh që ne reflektojmë dashurinë e Perëndisë!

"Vepro si duhet" dhe "Ndihu si duhet"

Mendo për një kohë kur dikush në kishë të ka treguar dashuri. Si je ndier? Inkurajoji nxënësit të shprehen. A është gjithmonë e lehtë ta duam njëri-tjetrin? (Jo) Përse? (ndryshime në personalitet, konfliktet, keqkuptimet, veprime lënduese, etj.)

Nuk është gjithmonë e lehtë ta duam njëri-tjetrin, por është një urdhërim i Jezusit. Edhe kur përballemi me sfida, ne mund të zgjedhim të përgjigjemi me dashuri, falje dhe mirëkuptim. Duke bërë kështu, ne mund t'i tregojmë botës dashurinë e mrekullueshme të Perëndisë.

Para se të ikim, le të mendojmë secili një mënyrë se si mund ta duam dikë në familjen e kishës këtë javë. Jepu nxënësve disa çaste për t'u menduar pastaj inkurajoji të japin idetë e tyre. Mbylleni me lutje.

Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?

Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje.
Idetë për lojë gjenden te shtojca.

1. Kur Jezusi thotë "ta doni njëri-tjetrin", kujt po i drejtohet? (Ndjekësve të Tij)
2. Kur bëhesh pjesë e familjes së Perëndisë? (Kur i kërkon Jezusit të të falë mëkatin dhe të bëhet udhëheqësi i jetës sate)
3. Cilat janë disa nga mënyra që mund ta duam njëri-tjetrin? (Duke nderuar, shërbyer, falur, mësuar/inkurajuar dhe lutur për njëri-tjetrin)
4. Çfarë sheh bota kur të krishterët duan njëri-tjetrin? (Ata shohin tek ne reflektimin e dashurisë së Perëndisë)
5. Si mund të ndihesh kur i bindesh urdhërimit të Perëndisë për të dashur njëri-tjetrin? (I afërt)

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Lojërat e fundit të përsëritjes

Këshilla:

- *Zhvillo të njëjtën lojë disa javë rresht, që nxënësit të mësohen me rregullat, kështu nuk duhet të përqendrohesh shumë te udhëzimet.*
- *Printoji dhe ngjiti diku udhëzimet, që nxënësit t'i shohin.*

Garë quiz (mjetet: dy zilka apo diçka tjetër që shkakton zhurmë)

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Zgjidh dy nxënës (një nga secila skuadër) që të vijë përpara.
3. Bëj një pyetje nga përsëritja.
4. Nxënësi i parë që i bie ziles dhe përgjigjet saktë, fiton një pikë.
5. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton.

Variante argëtuese:

- **Hedhje e topit:** përgjigje e saktë = godit drejt koshit për të fituar një pikë shtesë
- **Hedhja e zarit:** përgjigje e saktë = hidh zarin (zaret) për të përcaktuar pikët e fituara
- **Tic Tac Toe:** përgjigje e saktë = vendos X ose O në tabelë
- **Rrotullo rrotën:** përgjigje e saktë = rrotullo për të fituar pikë, shpërblime ose etiketa shpërblyese
- **Zarfi i mistershëm:** përgjigje e saktë – zgjidh një zarf që ka pikë ose çmime
- **Këpucët:** përgjigje e saktë = tërhiqni në tokë këpucët e skuadrës; këpuca që arrin e para, fiton
- **Goditje "e vërtetë ose e gabuar"** (mjetet: dy vrasëse mizash): shkruaj "e vërtetë" dhe "e gabuar" në tabelë; nxënësi i parë që godet përgjigjen e saktë, fiton një pikë (ose shkruaj "A", "B" dhe "C" për pyetje me alternativa)

Mbytu ose noto

1. Ndaji nxënësit në dy skuadra.
2. Kërkoju të ngrihen të gjithë në këmbë.
3. Pyet njërin nga nxënësit që janë në këmbë.
4. Nëse përgjigjet saktë, ata mund të:
   a. "mbysin" dikë nga skuadra kundërshtare, pra, personi tjetër duhet të ulet dhe të presë që dikush ta "shpëtojë" – OSE –
   b. mund të "shpëtojnë" dikë nga skuadra e tyre që është "mbytur" nga dikush tjetër.
5. Skuadra e parë që i "mbyt" të gjithë anëtarët e skuadrës kundërshtare, fiton!

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shëno shumë pikë

1. Vendosu paraprakisht pyetjeve të përsëritjes vlerë në pikë, duke i dhënë më shumë pikë pyetjeve më të vështira (e vështirë = 20 pikë, mesatare = 15 pikë, e thjeshtë = 10).
2. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
3. Skuadrat duhet ta zgjedhin pyetjen e tyre në bazë të vlerës së pikëve.
4. Kur japin përgjigje të saktë, fitojnë pikë për skuadrën.
5. Skuadra e parë që mbledh 100 pikë fiton!

Vendosja në piramidë e gotave plastike (2 sete me gota plastike)

1. Ndaji nxënësit në skuadra.
2. Sa herë që nxënësit përgjigjen saktë, fitojnë një gotë, të cilën duhet ta vendosin te piramida e skuadrës. Piramida do të ndërtohet me çdo gotë që fitohet.
3. Skuadra e parë që i fiton të gjitha gotat dhe përfundon piramidën, fiton.

Gotë mirësie (mjetet: shkopinj druri të vendosur në një gotë me ngjyra; vendos paraprakisht vlerë në pikë te shkopinjtë; vendos pikë pozitive dhe negative, pastaj vendosi shkopinjtë me kokë poshtë që të mos dallohen pikët)

1. Ndaji nxënësit në dy ose më shumë skuadra.
2. Bëji njërit prej tyre një pyetje përsëritjeje.
3. Kur një nxënës të përgjigjet saktë, mund të zgjedhë njërin nga shkopinjtë dhe të fitojnë pikët e shënuara në të.
4. Skuadra me më shumë pikë në fund, fiton!

Gjejeni se kush...

1. Kërkoji njërit prej nxënësve të ulet përballë klasës dhe pas vetes të ketë një tabelë ose një copë letre.
2. Shkruaj emrin e personit për të cilin kanë mësuar javën e kaluar në tabelën që ndodhet pas nxënësit të ulur në karrige.
3. Kërkoju nxënësve të ngrenë dorën dhe ai që është ulur në karrige do të zgjedhë tre persona që do t'i japin ndihma.
4. Nëse e gjen personazhin, fiton një Etiketë shpërblyese.
5. Personi që jep të dhënën më ndihmuese, fiton vendin te "karrigia e të ftuarit" për raundin e ardhshëm.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Topi i plazhit (mjetet: top plazhi; shkruaj paraprakisht te topi një sërë pyetjesh që mund të aplikohen për çdo mësim, për shembull: Kush ishte personazhi kryesor në këtë mësim? Çfarë mësuam nga KZ-ja? Cili është vargu i ditës nga "Mendo si duhet"? Ku gjendet mësimi ynë në Bibël?)

1. Mos e ndaj klasën në skuadra.
2. Luaj muzikë ose kërkoji njërit nga drejtuesit të recitojë 2 nga 12 vargjet kyç ndërkohë që nxënësit e kalojnë topin te njëri-tjetri. Nxënësit duhet të qëndrojnë ulur.
3. Kur të ndalojë muzika ose të kenë përfunduar vargjet, kushdo që ka topin në dorë duhet t'i përgjigjet pyetjes në të cilën ka gishtin e madh.
4. Jepi një Etiketë shpërblyese nëse përgjigjet saktë.

Rreth botës

1. Mos e ndaj klasën në skuadra; kërkoju të gjithëve të ulen në rreth, në tokë ose me karrige.
2. Zgjidh dy nxënës që të qëndrojnë në mes të rrethit.
3. Bëj një pyetje përsëritjeje.
4. Dy nxënësit e parë që ngrihen dhe përgjigjen saktë, fitojnë raundin.
5. Fituesi qëndron në këmbë.
6. Nxënësi që e humbi vendin, ulet atje ku ishte ulur fituesi.
7. Tani fituesi garon kundër nxënësit tjetër që është ulur pranë tij (në kah orar).
8. Vazhdoje këtë proces deri sa të përfundojë rrethi.
9. Qëllimi është që nxënësit të qarkullojnë nëpër të gjithë rrethin derisa të kthehen në vendin fillestar.
10. Nëse një nxënës arrin të kthehet në karrigen fillestare, fiton lojën.
11. Nëse mbaron koha para se dikush të kthehet në vendin fillestar, atëherë fiton ai që ka ecur më shumë përpara.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

LIBRI PA FJALË

T'U PREZANTOJMË FËMIJËVE UNGJILLIN

Libri pa fjalë është mënyra kryesore se si e ndajmë Ungjillin me fëmijët në kurrikulën e Zbuluesit. Do të vini re se do t'i i referohemi çdo javë ndërsa prezantohet mesazhi i Ungjillit. Secila ngjyrë ka një kuptim të thjeshtë dhe një varg kyç që do t'i ndihmojë fëmijët të marrin kuptimin e vërtetë të dashurisë së Perëndisë dhe të mënyrës se si mund të kemi një marrëdhënie personale me Të, tani e në përjetësi.

Libri pa fjalë është një mjet që paraqet një mesazh të qartë të Ungjillit. Për fëmijët më të rritur, mund t'ju duket si një mjet shumë i përsëritur, por pasi rishikuam rezultatet e testit, mësuam se fëmijët më të rritur dinë fjalën kyç, ngjyrën dhe vargun, por shpesh nuk dinë ta përdorin si mjet për të ndarë apo mbrojtur besimin e tyre. Mbajeni në mendje ndërsa modeloni mesazhin e Ungjillit për fëmijët çdo javë.

Përpiquni që me raste ta përdorni prezantimin e Ungjillit pa iu referuar ngjyrave. Pasi të keni përfunduar, pyetini fëmijët se çfarë iu kujton. Ose, filloni ta ndani Ungjillin duke shprehur gëzimin që keni për shkak se jeni pastruar (shpëtuar) nga mëkati në jetën tuaj. Është e rëndësishme të përfshihet gëzimi i të qenët pjesë e familjes së Perëndisë. Kur bëhesh i krishterë, Perëndia është Ati yt Qiellor dhe ti u bashkohesh të gjithë të krishterëve si pjesë e familjes së kishës së Tij.

Përdorimi i Librit pa fjalë

Ngjyra e artë – Faqja e artë na kujton dashurinë e Perëndisë për ne dhe se si ne, si të krishterë, mund të kemi sigurinë se një ditë do të shkojmë në qiell. Gjoni 14:2 thotë: "Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t'ju thosha: Po shkoj t'ju përgatis një vend". Qielli është i vërtetë… dhe është një vend i përsosur e real. Do të jetë i mbushur me gëzim, lumturi, rrugë të arta, me praninë e vetë Perëndisë dhe do të jetë një familje e përsosur. Por diçka nuk është në qiell… dhe ajo është mëkati.

Ngjyra e errët – Faqja e errët përfaqëson mëkatin. Mëkati është gjithçka që mendojmë, themi ose bëjmë që është kundër Perëndisë. Shembuj të mëkatit janë kopjimi, vjedhja dhe thashethemet. Këto gjëra nuk do të jenë në qiell dhe janë gjëra që nuk e kënaqin Perëndinë. Romakëve 3:23 thotë: "Sepse të gjithë kanë mëkatuar dhe nuk e arrijnë lavdinë e Perëndisë". Ndëshkimi i mëkatit është vdekja e përjetshme, që do të thotë se nuk mund të shkojmë në qiell, por ka shpresë…

Ngjyra e kuqe – Faqja e kuqe na kujton Jezusin. Jezusi është Biri i vetëm i përsosur i Perëndisë, që erdhi në tokë të jetonte një jetë të përsosur. Për shkak të jetës së Tij të përsosur, vetëm Ai mund të merrte ndëshkimin për mëkatin tonë. Hebrenjve 9:22b thotë: "...dhe pa derdhur gjak, nuk ka ndjesë". Jezusi derdhi gjakun e Tij dhe për këtë shkak, Ai është e vetmja rrugë për në qiell. Jo përmes veprave të mira (Efesianëve 2:8-9), por vetëm përmes dhuratës së Jezusit. Pranimi i kësaj dhurate falas nga Jezusi është zgjedhje personale. Por prit, duhet të të tregoj diçka... Jezusi nuk qëndroi i vdekur, Ai u ngrit sërish dhe pati fitore mbi mëkatin!

Ngjyra e bardhë – Faqja e bardhë na kujton se, nëse besojmë këto të vërteta, marrim falje për mëkatin tonë. Veprat 16:31 thotë: "Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote". Beso dhe do të shpëtosh nga ndëshkimi i mëkatit tënd. Mëkati yt mund të falet dhe ti mund të pastrohesh. Por kjo është një zgjedhje që çdo individ duhet ta bëjë vetë.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Ngjyra e gjelbër – Faqja e gjelbër na kujton se, pasi i kërkon Jezusit të falë mëkatin tënd, Ai dëshiron që ti të afrohesh më tepër me Të. Është një *marrëdhënie*, jo një fe. Ai bëhet udhëheqësi i jetës sate. Për shkak se Ai është udhëheqësi yt, do të duash të rritesh… si bari në muajt e ngrohtë të verës (i gjelbër). 2 e Pjetrit 3:18a thotë: "Por rrituni në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht". Ne afrohemi me Të kur lexojmë Biblën, kur lutemi dhe kur i bindemi Fjalës së Tij.

Duket fantastike, apo jo? Pavarësisht sa vjeç je, kjo është një zgjedhje që duhet ta bësh vetë! Mund të zgjedhësh ta pranosh sot këtë të vërtetë të mrekullueshme. Nëse dëshiron të zgjedhësh t'i kërkosh Jezusit të jetë Shpëtimtari dhe Zoti yt, duhet të lutesh ose të flasësh me Perëndinë për këtë. Perëndia është real dhe mund të të dëgjojë kur lutesh.

Nëse do të doje ta merrje këtë vendim, mund të lutesh tani për këtë:

1. Pranoje që je mëkatar… tregoji për mëkatin që të mundon dhe se ti e di që ai mëkat nuk i pëlqen Perëndisë. (**ngjyra e errët**)
2. Tregoji se beson që Jezusi vdiq dhe mori ndëshkimin për mëkatin tënd. (**ngjyra e kuqe**)
3. Kërkoji personalisht Jezusit të falë mëkatin tënd dhe të bëhet udhëheqësi i jetës sate. (**ngjyra e bardhë**)
4. Falënderoje që të ka falur dhe që u bë udhëheqësi i ri i jetës sate.

Nëse vërtet i ke kërkuar Perëndisë të të shpëtojë dhe të bëhet udhëheqësi i jetës saee, duhet të dish që mëkati të është falur dhe ti je fëmijë i Perëndisë.

Këshilla shtesë

Për të ndihmuar në udhëzimin e fëmijëve drejt shpëtimit, programi i Zbuluesit siguron kartën *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*.

Për të ndihmuar me prezantimin e Ungjillit dhe për të filluar me dishepullimin e fëmijëve, programi i Zbuluesit ofron fletushkat *E beson apo jo?* dhe *Po tani, çfarë ndodh?* si dhe libër shënuesin *Unë besoj.*

Fletushka *E beson apo jo?* shpjegon Ungjillin duke përdorur Shkrimin, përkufizime të përshtatshme për fëmijët dhe kornizën e Librit pa fjalë. Është një mjet i shkëlqyer për t'i shpjeguar Ungjillin një fëmije të interesuar, dhe për t'ia dhënë me vete fëmijës që dëshiron të mendojë për ta pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij.

Nëse një nxënës zgjedh t'i besojë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar, fletushka *Po tani, çfarë ndodh?*, është një prezantim i mirë i çfarë do të thotë të jetosh jetën e krishterë. Mbulon shkurtimisht tema si: identiteti i tyre në Krishtin, disiplina frymërore, adhurimi dhe lutja, dhe të bërët pjesë e familjes së Perëndisë.

Pasi fëmija merr vendimin t'i besojë Krishtit si Shpëtimtar, libër shënuesi *Unë besoj* mund të plotësohet si kujtesë e këtij vendimi të rëndësishëm. Shënuesin e mban nxënësi dhe pjesa fundore e tij plotësohet dhe i dorëzohet drejtuesit, në mënyrë që të gëzohemi bashkë me nxënësin.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Mirënjohje dhe falënderime

Falënderime të sinqerta për Shawn Thornton, pastor i kishës Calvary Community Church në Westlake Village, Kaliforni, për përdorimin e konceptit “Mendo si duhet”, “Vepro si duhet” dhe “Ndihu si duhet”. Kjo ide, bashkë me “Kupto si duhet”, është bërë struktura e çdo mësimi të qendërzuar në Bibël në këtë kurikul. E vlerësojmë shumë që ka lejuar këtë ide të jetë pjesë e kësaj kurikule, që të tjerë të mund të pajisen për t’u mësuar fëmijëve të “Kuptojnë si duhet”, të “Mendojnë si duhet”, të “Veprojnë si duhet” dhe të “Ndihen si duhet”.

Jemi mirënjohës për bashkëpunimin e vyer që kemi me “Awana International” dhe që na kanë dhënë lejen t’i referohemi Awana-s brenda kurikulës dhe materialeve trajnuese të “Discovery Land”. Kemi parë se Perëndia e ka përdorur marrëdhënien mes kurikulës të së dielës dhe programit të mesjavës nga Awana që të ketë një ndikim të fortë te nxënësit tanë nëpër botë.

Awana është një markë e regjistruar e “Awana Clubs International”. Përdorur me leje. Appleton Alliance Association, Inc vepron në pavarësi nga “Awana Clubs International” dhe është përgjegjëse vetëm për përmbajtjet e kësaj kurikule.

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla, ABS 2009, përdorur me leje nga *Albanian Bible Society (A.B.S.).*

LEGO® është një markë tregtare e grupit të legove. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

 Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association